



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 313 Akti

Nr. 535 Vendimi
Tiranë, më 26.5.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë, znj. Elka Ermenkova dhe z. Ferdinando Buatier, në datën 28.3.2022, ora 10:00 dhe në datën 24.5.2022, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) dhe salla ovale, hyrja nga ish-KQZ-ja, Tiranë, zhvilloi seancat dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bledar Bejko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Bejko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj (Vokopola), Pamela Qirko dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 2.12.2019, të trupit gjyqësor, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Bledar Bejko, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjyqësor, komisioneren Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjyqësor deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 4.12.2019 subjekti iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjyqësor, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit, për të cilën subjekti i rivlerësimit, në datën 6.12.2019, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit, porse rezervonte të drejtën që në rast se do të konstatonte gjendje të konfliktit të interesit do ta parashtronte atë. Me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit, komisionerja Alma Faskaj është zëvendësuar nga komisioneri Olsi Komici, i cili deklaroi se nuk ka konflikt interesi me subjektin. Më tej, subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë zëvendësim dhe njëkohësisht iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit për anëtarin e ri të trupit gjyqësor. Në datën 23.4.2020 subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin zëvendësues të trupit gjyqësor.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka pasur kontakte të

papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në kuadër të kontrollit të pasurive/interesave privatë të subjektit të rivlerësimit, është konstatuar se: (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë; (c) ka mosdeklarim pasurie ndër vite; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

11. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

12. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se arrijnë nivelin e provueshmërisë, dhe me vendimin nr. 2, datë 2.3.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mbi të drejtat që gëzon sipas legjislacionit në fuqi.

14. Në vijim, në datën 7.3.2022, subjektit i rivlerësimit u njoftua në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ dhe analizën financiare të kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me të gjitha aktet e dosjes më 11.3.2022, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

15. Në datën 23.3.2022 subjekti i rivlerësimit paraqiti në formë elektronike dhe zyrtare shpjegime dhe prova, duke kërkuar administrimin e tyre.

16. Pas shqyrtimit në tërësi të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vendosi¹ të ftojë z. Bledar Bejko në seancë dëgjimore, në datën 28.3.2022, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

17. Trupi gjykues, për shkak të disa konstatimeve të konkluduara përgjatë diskutimeve të trupit gjykues për marrjen e vendimit përfundimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, me vendimin të ndërmjetëm² vendosi riçeljen e hetimit administrativ.

18. Më tej, pas riçeljes, trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 16.5.2022, vendosi: (i) mbylljen e hetimit administrativ; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shtesë, të cilat iu njoftuan subjektit po në datën 16.5.2022. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes shtesë, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

19. Pas ushtrimit nga subjekti të së drejtës mbi paraqitjen e parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, trupi gjykues, pasi administrimit të tyre, me vendimin nr. 6, datë 20.5.2022, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në datën 24.5.2020, ora 09:30, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCAT DËGJIMORE

20. Seancat dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datat 28.3.2022, ora 10:00 dhe 24.5.2022, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë dhe salla ovale, hyrja nga ish-KQZ-ja Tiranë, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë, znj. Elka Ermenkova dhe z.Ferdinando Buatier.

21. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancën e datës 28.3.2022, ndërsa në seancën e datës 24.5.2022, u paraqit edhe me përfaqësuesen ligjore, av. A.S, pajisur me nr. licence***, me deklaram në seancë, dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të procesit të kryer ndaj tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

22. Z. Bledar Bejko ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

¹Me vendimin e ndërmjetëm nr. 3, datë 23.3.2022.

²Me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 4.4.2022.

23.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

23.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

23.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23.4 Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

23.5 Por, referuar vendimit nr. 2/2017³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23.6 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI së bashku me provat e dorëzuara, në mbështetje të deklaratës *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja së bashku me provat në mbështetje të raportit; (c) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite nga subjekti; (ç) provat shpresore të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe ato të depozituara bashkë në seancën dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; si dhe (e) denoncimet e publikut.

A. VLERËSIMI I PASURISË

24. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, në bazë të ligjit nr. 9049/2003 u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të tyre.

24.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duke e krahasuar me deklarimet e interesave private dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në ILDKPKI, në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe

³“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

24.2Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në verifikimin e krijimit të pasurive, ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij si person i lidhur me të. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar përkatësisht këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

1.Pasuria e llojit “apartament” me sip. 100 m², rruga “***”, Tiranë. Vlera 1.450.000 lekë, fituar me ligjin e privatizimit të vitit 1992, në bashkëpronësi me prindërit, me kontratën nr. ***, datë 8.10.1997. Pjesa takuese: 33%.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar:*Deklarim i pasaktë i vlerës dhe sipërfaqes së apartamentit në rrugën “I.T”, Tiranë, përfitur nga privatizimi, në deklarinimin e interesave private ndër vite dhe deklaratën Vetting.*

1.2 Në deklarinimin e interesave private para fillimit në detyrë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi 3+1, me sip. 88 m², në vlerën 1.450.000 lekë, me burim nga shteti sipas ligjit për privatizimin. Pjesa takuese: 25%.*

1.3Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *Bashkëpronar në një apartament 98 m², vitit '96, rr. “I.T”, nr. ***, ***, Tiranë. Pjesa takuese: 1/3.*

1.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka deklaruar: *Apartament me sip. 100 m², rr. “I.T”, Tiranë, në vlerën 17.000 euro. Pjesa takuese: 30%. Apartamenti me sip. 88 m² në rr. “I. T” është i njëjti me atë të deklaruar në vitin 2003⁴, përfitur nga ligji i privatizimit. Subjekti sqaron se vlera 17.000 euro është vlera e tregut.*

1.5 Sipas kontratës së shitjes rezultoi se vlera e apartamentit ka qenë 1.247.694 lekë dhe nga kjo shumë është paguar 3.162 lekë, pasi pala blerëse ka dorëzuar apartamentin me vlerë 1.402.126⁵ lekë. Kjo e fundit ka qenë pasuria e përfitur nga privatizimi i banesave shtetërore në qytetin e Gjirokastrës pas dorëzimit të të cilës është marrë pasuria në qytetin e Tiranës, pra jemi para këmbimit të pasurive me EKB-në, të cilat kanë konsistuar thuajse në të njëjtën vlerë.

1.6 Komisioni e ka pyetur⁶ subjektin në lidhje me mospërputhjet e sipërfaqes së kësaj pasurie, si dhe për pjesën takuese. Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar: *“Apartamenti me adresë rr. ‘I.T’, Tiranë, në bazë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 8.10.1997, në të gjitha deklarinimet që kam bërë kanë të bëjnë me të njëjtin apartament ku jetojnë prindërit e mi. Pjesa takuese në emrin tim 33%. Në momentin e privatizimit, familja jonë përbëhej nga katër persona, prindërit, unë dhe vëllai. Në DPV-në e vitit 2003 kam menduar se pronar i apartamentit ka qenë edhe vëllai im, por pasi kam këqyrrur me kujdes kontratën e shitjes kam konstatuar se unë zotëroj 1/3 dhe jo 1/4 të apartamentit, pasi në momentin e privatizimit vëllai ka qenë më i vogël se 18 vjeç⁷. Në këtë apartament nuk është bërë asnjë ndryshim (si shtesa në sipërfaqe apo ndonjë ndryshim tjetër). Bazuar në kontratën e shitjes sipërfaqja e apartamentit është 86,98 m², pa sipërfaqet e*

⁴Këtë deklarinim subjekti e ka bërë edhe në procesverbalin e vitit 2007, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr.*** prot., datë 6.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵Sikurse ka deklaruar edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 27.4.2016, përcjellë nga kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020, provë e administruar në dosjen e hetimit administrativ, se pasuria e dorëzuar ka qenë në Gjirokastrë.

⁶Me pyetësorin nr. 2, datë 14.9.2021.

⁷I datëlindjes ***.

përbashkëta”. Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes së apartamentit lidhur me Entin Kombëtar të Banesave.

1.7 ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë⁸ dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. ***, z. k. ***, rruga “****”, për apartamentin me sip. 86.98 m², në emër të shtetasve Bledar Bejko, E.B dhe S.B, regjistruar në datën 8.3.2014, si dhe kontratën e shitjes së apartamentit nr. ***, datë 8.10.1997, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse shtetasit e sipërpërmendur. Apartament me sip. 86.98 m², në vlerën 3.162 lekë (21,8 USD).

1.8 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë sa i përket origjinës dhe mënyrës së përfitimit të saj, me përjashtim tëkonstatimit se dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* për sipërfaqen e kësaj pasurie, duke e deklaruar 100 m² në raport me dokumentacionin provues hipotekor, ku pasuria pasqyrohet me sipërfaqe 86.98m².

1.9 Mbi këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka sqaruar: *“Bashkëlidhur deklaratës Vetting kam dorëzuar edhe aktet e fitimit të pronësisë së këtij apartamenti, në të cilat përcaktohen edhe sipërfaqja e apartamentit. Ky apartament është në të njëjtën gjendje që ka qenë në momentin e privatizimit. Pra, pasaktësia në rastin konkret është formale dhe nuk ka asnjë qëllim të kundërligjshëm dhe, si e tillë, nuk mund të cilësohet në dëm të subjektit”*. Gjithashtu, subjekti citon edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelitimit në vendimin nr. ***, ku thuhet se në vlerësimin tërësor, pasaktësitë nuk janë në dëm të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk provohet se kjo situatë ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo qoftë edhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

1.10 Trupi gjykues, nga analizimi i deklarimeve dhe provave të administruara për këtë pasuri, vërejtë se aktet e pronësisë, si kontrata e shitjes ashtu edhe kartela e pasurisë pasqyrojnë saktë sipërfaqen e pronës, 86.98 m². Lidhur me pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri, e privatizuar sipas ligjit nr. 7652/1992, nga verifikimi i certifikatës së përbërjes familjare, vërejtë se vëllai i subjektit të rivlerësimit M.B ka qenë minor, pra nën 18 vjeç, në datën 23.12.1992, dhe për pasojë nuk mund të përfshihej në rrethin e përfituesve si bashkëpronarë të apartamentit. Për rrjedhojë, konkludohet se bashkëpronësia e pasurisë i përket subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, duke u ndarë kështu në pjesë takuese 1/3 ose 33%.

1.11 Në lidhje me vlerën e kësaj pasurie, trupi gjykues vërejtë se konvertimi i shumës takuese i apartamentit të dorëzuar për efekt të blerjes së pasurisë, objekt hetimi administrativ, nga EKB-ja, prej 1.450.000 lekësh, është përlllogaritur nga kjo e fundit proporcionalisht në këmbimin e pasurisë, që duket se nënkupton që shlyerjet mes palëve, shitës - institucioni shtetëror dhe blerës - individ, janë ezauruar pa kundërshti, duke u zhveshur kështu njëra palë (institucioni) nga pronësia dhe bërë pronar pala tjetër, subjekti i rivlerësimit së bashku me familjarët e tij, të cilët më pas e kanë hipotekuar pasurinë objekt hetimi.

Nën analizën e fakteve të mësipërme, trupi gjykues konkludon se nuk evidentohen problematika lidhur me origjinën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie.

1.12 Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni për ndonjë aplikim të mundshëm mbi ndërtim informal, ASHK-ja, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme, Njësia e Kadastrës⁹ dhe Hartografisë,

⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹Me shkresën nr. ***prot., datë 28.1.2020.

ka informuar se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

1.13 Lidhur me konstatimin *për deklarim të pasaktë të sipërfaqes së kësaj pasurie*, duke e deklaruar 100 m², në raport me dokumentacionin provues hipotekor të saj, ku pasuria pasqyrohet me sip. 86.98 m², trupi gjykues, nisur nga faktet se: (i) deklarimi i subjektit se *në këtë apartament nuk është bërë asnjë ndryshim (si shtesa në sipërfaqe apo ndonjë ndryshim tjetër... se ai në deklarim i referohej edhe sipërfaqeve të përbashkëta*, përputhej me hetimin e Komisionit, pasinuk rezultoi ndonjë e dhënë ndryshe apo fakt për ndonjë ndërtim/investim shtesë; (ii) nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja konfirmohet kjo pasuri e llojit “apartament” me sip. 86.98 m², me nr. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****”; (iii) nga të dhënat e dala nga hetimi rezultoi se ky apartament/pasuri e prindërve të tij është në të njëjtën gjendje që ka qenë në momentin e privatizimit, pra, sikurse u përmend më sipër, nuk ekziston asnjë shtesë informale; (iv) nga hetimi rezultoi se nisur nga koha e përfitimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë kontribut në këtë pasuri; (v) nga ana tjetër rezultoi se prindërit kanë pasur burime të ligjshme – çmon se pasaktësia që i takon sipërfaqes mbetet formale¹⁰ dhe nuk ka peshë që mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit.

2.Pasuria apartament, me sip. 96.5 m², ndodhur në *, ***, Tiranë**,për të cilënrezulton se subjekti e ka deklaruar të blerë në vlerën 87.000 euro, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 30.10.2008, me burim krijimi: *transferuar nëpërmjet “Tirana Bank” 47.000 euro nga prindërit e mi S.B, nga shitja e një apartamenti nr. ***, datë 6.11.2007, në shumën 90.000 euro (blerë 34.000 USD, nr. ***, datë 26.4.2004)*. Subjekti ka bashkëlidhur kontratat përkatëse. Ndërsa shuma 10.000 euro është transferuar nga llogaria e z. Bledar Bejko në “Tirana Bank”. Kjo shumë ka ardhur nga kredi konsumatore e marrë në emër të z. Bledar Bejko me kontratë kredie bankare nr. *** në shumën 4.000 euro dhe mbyllur para afatit në datën 7.8.2008 dhe kredi konsumatore në emër të znj. R.R me kontratë kredie konsumatore nr. *** në shumën 5.000 euro, shlyer para afatit në datën 7.8.2008. Këto dy kredi u shlyen nga fonde të familjes së shtetases R.R.B. Diferenca prej 30.000 euro është marrë kredi në “Tirana Bank” për blerje apartamenti. Mobilimi: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50%, pjesa tjetër e bashkëshortes. Subjekti, për këtë pasuri, i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës¹¹.

¹⁰Referuar edhe vendimit nr.***, të Kolegjit, e cila ka mbajtur qëndrimin: *“Në përfundim, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se paqartësitë lidhur me sipërfaqen totale të objektit vijnë si pasojë e faktit që ato nuk gjejnë pasqyrim të cilësuar në kartelën e pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Edhe pse trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimeve që i lindin nga procesi i rivlerësimit kalimtar, duhet të kishte bërë përpjekje për të identifikuar këtë të dhënë të kërkuar, në vlerësimin tërësor të rrethanave në të cilat kanë ndodhur faktet, kjo situatë nuk vlerësohet në dëm të subjektit të rivlerësimit, sa kohë nuk provohet se kjo situatë ka shërbyer si mjet për të fshehur pasurinë apo qoftë edhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj”*.

¹¹Kontratë shitjejeapartamenti nr. ***, datë 30.10.2008. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., palë blerëse Bledar Bejko; kontratë premtim shitblerjeje nr. ***, datë 6.11.2007, palë shitëse E.B, palë blerëse H.B. Apartament me sip.100 m², rr. “I.T”, në vlerën 90.000 euro, kundrejt një kapari prej 20.000 euro që pala blerëse i ka likuiduar me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa e mbetur prej 70.000 euro do të bëhet nëpërmjet një kredie bankare që blerësi do të marrë në një nga bankat e nivelit të dytë; vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 6.5.2004, në emër të znj. E.B; kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.4.2004, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse E.B. Apartament me sip. 100 m², rr. “I.T”, regjistruar në numrin hipotekor ***, datë 24.11.2003, pasuria nr. ***, z. k. ***. Vlera e shitjes 34.000 USD, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Vërtetim nga dokumentet hipotekor nr. ***, datë 24.11.2003; hartë treguese e regjistrimit; kontratë kredie bankare konsumatore nr. ***, kredimarrës Bledar Bejko, kredidhënës “Tirana Bank”. Shuma e kredisë 4.000 euro, me afat 5-vjeçar; kontratë kredie bankare konsumatore nr. ***, kredimarrës R.R, kredidhënës “Tirana Bank”. Shuma e kredisë 5.000 euro, me afat 5-vjeçar; kontratë kredie bankare për shtëpi nr. ***, kredimarrës R.R, Bledar Bejko, kredidhënës “Tirana Bank”. Shuma e kredisë 4.000.000 lekë, e cila do të përdoret për blerjen e një apartamenti, me afat 30-vjeçar. Pagesa e kësaj kredie do të sigurohet nga pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 18.2.2009, hipotekues Bledar Bejko, përfitues “Tirana Bank”. Për efekt garancie

2.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: *Deklarim i pasaktë i shumës së dhënë nga prindërit dhe mënyrës së marrjes së saj, përdorur për shlyerjen e vlerës së apartamentit në vitin 2008, pasi në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2008 deklarohet 57.000 euro paguar cash, ndërsa në deklaratën Vetting deklarohet 47.000 euro me transfera bankare; mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për marrëdhëniet juridike me prindërit e subjektit për marrjen prej tyre të shumës 47.000 euro. Burimi financiar i krijimit të shumës 34.000 USD nga nëna e subjektit në vitin 2004 është i paqartë dhe i panjohur; mosdeklarim i kredive konsumatore, marrë në vitin 2008 në “Tirana Bank” në shumën totale 9.000 euro, shlyer brenda vitit nga prindërit e bashkëshortes, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj të parë të apartamentit; mungon dokumentacioni justifikues ligjor ku të vërtetohet shlyerja e kredive nga familja e bashkëshortes si dhe dokumentacioni justifikues ligjor i burimit të krijimit të kësaj shume nga ana e tyre; mungesë dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me shpenzimet për mobilim në shumën 5.000 euro.*

Nga hetimi administrativ, Komisionit i kanë rezultuar faktet e mëposhtme:

2.2 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2008, me përshkrimin: *“Blerje apartament banimi me sip. 101 m², ndodhur në ***, blloku ‘***’ në vlerën totale 87.000 euro, nga të cilat 57.000 euro janë dhënë cash, kursime nga pasuria e prindërve të mi, nga shitja e një apartamenti 100 m² në rr. ‘I. T’ në dhjetor të vitit 2007 në vlerën 81.000 euro, diferenca kredi 30.000 euro në ‘Tirana Bank’ në shkurt të vitit 2009”.*

2.3 ASHK-ja, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tirana Rurale ¹² informon se në emër të Bledar S Bejko ka të regjistruar pasuri të paluajtshme me të dhënat: *pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “apartament”, z. k. ***.* Kjo drejtori, në praktikën e dërguar, ka bashkëlidhur kontratën e shitjes nr. ***, datë 30.10.2008, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Bledar Bejko. Vlera e apartamentit: 87.000 euro. Sipas kontratës pala blerëse likuidon në favor të palës shitëse shumën prej 57.000 euro jashtë zyrës noteriale ndërsa pjesa tjetër e likuidimit prej 30.000 euro do të bëhet me kredi bankare.

2.4 FSHU-ja¹³ informon se me gjeneralitetet Bledar Bejko, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një kontratë furnizimi nr. *** në instancën Tiranë.

2.5 UKT-ja¹⁴ bën me dije se z. Bledar S Bejko ka kontratën nr. *** për objektin me adresë: rruga “****”, Tiranë.

2.6 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

2.6.1 Subjekti deklaron në deklaratën Vetting se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer:

i) Shuma 47.000 euro transferuar nëpërmjet “Tirana Bank” nga prindërit (S.B), nga shitja e apartamentit me nr.***, datë 6.11.2007, në shumën 90.000 euro (blerë 34.000 USD, nr. ***, datë 26.4.2004).

të sigurimit të kthimit të kredisë, hipotekohet në bazë të certifikatës për vërtetim pasurie datë 15.12.2008, pasuria apartament me sip. 96.5 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të z. Bledar Bejko. Barrë mbi pasurinë: bllokohet për shumën 30.000 euro që do të likuidohet me kredi bankare. Bashkëlidhur; certifikatë për vërtetim pronësie + kartela e pasurisë së paluajtshme (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2020.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020.

ii) Shuma 10.000 euro transferuar nga llogaria e z. Bledar Bejko në “Tirana Bank”. Kjo shumë ka ardhur nga kredi konsumatore e marrë në emër të z. Bledar Bejko me kontratë kredie bankare konsumatore nr. ***, në shumën 4.000 euro dhe mbyllur para afatit në datën 7.8.2008 dhe kredi konsumatore në emër të znj. R.R me kontratë kredie konsumatore nr. *** në shumën 5.000 euro dhe shlyer para afatit në datën 7.8.2008. Këto dy kredi u shlyen nga fonde të familjes së znj. R.R.B.

iii) Shuma 30.000 euro është marrë kredi tek “Tirana Bank” për blerje apartamenti.

Ndërsa, në deklaratën periodike të vitit 2008 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie:

- shuma 57.000 euro është dhënë *cash*, kursime nga pasuria e prindërve nga shitja e një apartamenti 100 m² në rrugën “****” në dhjetor të vitit 2007 në vlerën 81.000 euro; dhe
- diferenca kredi në shumën 30.000 euro në “Tirana Bank” në shkurt të vitit 2009.

2.6.2 Komisioni e ka pyetur¹⁵ subjektin mbi mospërputhjet e vërejtura në deklarime në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, i cili ka sqaruar se: “Shuma 57.000 euro është transferuar në llogarinë e shitësit ‘***’:

- 47.000 euro janë kaluar nga llogaria e S.B (burimet për këto shuma kanë qenë kursime nga të ardhurat e përfituara nga prindërit e mi nga të gjitha burimet e tyre të ligjshme). Dua të sqaroj se unë kam jetuar me prindërit në një ekonomi të përbashkët familjare;
- 10.000 euro nga llogaria e Bledar Bejko (këto fonde janë me burim 9.000 euro kredi + 1.000 euro nga babai im);
- 30.000 euro është marrë me kredi në ‘Tirana Bank’ në emër të R.B (R) dhe Bledar Bejko.

Shuma 47.000 euro + 10.000 euro = 57.000 euro, përputhet plotësisht me deklarinimin e bërë nga ana ime në vitin 2008, ku kam deklaruar se 57.000 euro më janë dhuruar nga prindërit. Pra, prindërit në vitin 2008 më kanë dhuruar gjithsej 57.000 euro.

*Dua të sqaroj se në vitin 2008 ne paraprakisht kemi porositur një apartament tjetër, për të cilin paguam 20.000 euro, i cili kishte si burim 11.000 euro nga babai im dhe 9.000 euro kredi (5.000 +4.000). Meqenëse kontrata me shoqërinë *** u prish, kjo shoqëri na ktheu shumën 20.000 euro (10.000 euro në llogarinë e babait tim dhe 10.000 euro tek llogaria ime).*

*Kreditë e marra në ‘Tirana Bank’ nga unë dhe bashkëshortja u mbyllën përpara se të na kthehej pagesa nga ***. Kredia e marrë në shumat 4.000 euro dhe 5.000 euro u mbyll brenda vitit me burim nga prindërit e mi (interesat e fituara nga llogaritë e E.B nga bonot e thesarit).*

*Ndërkohë sqaroj gjithashtu se pagesa 47.000 euro u transferua nga llogaria e babait tim tek ***, pasi shoqëria *** kishte kthyer shumën 10.000 euro.*

Pra nga prindërit në vitin 2008 kemi marrë gjithsej 57.000 euro (47.000 +1.000 + 9.000)’.

2.7 Duke marrë në konsideratë deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2008, deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi të pasqyrojë në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij deri në finalizimin e kontratës së blerjes së pasurisë apartament, që e zotëron aktualisht. Kjo, për faktin se një pjesë e transaksioneve kanë lidhje me deklarinimet e tij dhe burimin e krijimit të pasurisë.

¹⁵Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij fillimisht kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes¹⁶ nr. ***, datë 24.4.2008, me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerjen e pasurisë apartament me sip. 103.22 m², në vlerën 85.000 euro, më adresë: rruga “****”. Sipas kësaj kontrate, kësti i parë është likuiduar nga porositësit në shumën 20.000 euro, në momentin e redaktimit të kësaj kontrate, pa pretendime nga palët.

2.7.i Lidhur me këtë pagesë, nga hetimi¹⁷ ka rezultuar se:

- Babai i subjektit të rivlerësimit S.B ka paguar nga llogaria e tij bankare në “Tirana Bank” shumën 8.000 euro në datën 7.4.2008, për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “kapar, garanci ap. 2+1 deri 30.4.008 ku do të kryhet kontrata”.

- Subjekti i rivlerësimit ka paguar nga llogaria e tij bankare në “Tirana Bank” shumën 9.000 euro në datën 24.4.2008, për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë blerje apartamenti kontratë sipërmarrje 30.4.2008”.

Vihet re se për pagesën prej 9.000 euro, subjekti së bashku me bashkëshorten¹⁸ e tij kanë marrë dy kredi në “Tirana Bank”, në datën 23.4.2008, përkatësisht 5.000 euro znj. R.R dhe 4.000 euro subjekti. Të dyja kreditë janë mbyllur në të njëjtën datë 7.8.2008, përpara afatit.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi se këto dy kredi u shlyen nga fondet e familjes së znj. R.R.B, ndërsa gjatë hetimit ka deklaruar se janë mbyllur brenda vitit, me burim nga prindërit e tij (interesat e fituara nga llogaritë e E.B nga bonot e thesarit). Ky deklaram (sqarim i dhënë gjatë hetimit) duket se përputhet me deklarinimin periodik të vitit 2008, ku subjekti ka deklaruar se prindërit e tij e kanë ndihmuar me shumën 57.000 euro për blerjen e apartamentit.

Rezultoi e provuar se kontrata e sipërmarrjes është revokuar me kontratën nr. ***, datë 10.10.2008, ku vërehet se palët kanë rënë dakord që të revokojnë kontratën e sipërmarrjes dhe se shoqëria “****” i ka kthyer z. Bledar Bejko dhe znj. R.R shumën e paguar prej 20.000 euro.

Nga hetimi rezultoi se kthimi i shumës është kryer në datën 3.10.2008, si më poshtë vijon:

- shuma 10.000 euro në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit¹⁹ në “Tirana Bank”;
- shuma 10.000 euro në llogarinë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit S.B, në “Tirana Bank”.

2.7.ii Pas revokimit të kontratës me shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti ka lidhur një kontratë të re për blerje apartamenti, konkretisht kontratën e shitjes nr. ***, datë 30.10.2008, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Bledar Bejko. Vlera e apartamentit: 87.000 euro.

2.7.iii Pagesat për këtë pasuri janë kryer si më poshtë vijon²⁰:

Tabela nr. 1

Pagesa nga llogaria bankare e z. S.B		
Data	Përshkrimi	Vlera në euro

¹⁶Depozituar nga subjekti me pyetësorin nr.3, datë 2.11.2021.

¹⁷Statement nga “Tirana Bank”, me shkresën nr.*** prot., datë 28.1.2020.

¹⁸Në atë kohë bashkëjetuesja e subjektit.

¹⁹Subjekti ka paguar vetëm 9.000 euro me kreditë e marra dhe i janë kthyer 10.000 euro. Në deklarinimin e tij të vitit 2008 ka përfshirë shumën 57.000 euro si ndihmë nga prindërit e tij për apartamentin e blerë nga shoqëria “****” si rezultat i transfertave të babait në vlerën 47.000 euro, 1.000 euro tepër nga kthimi i pagesave për kontratën e porosisë me *** dhe 9.000 euro për shlyerjen e kredive para kohe. Pra, në total 57.000 euro (47.000 + 1.000 + 9.000).

²⁰Sipas *statement*-it të “Tirana Bank”.

22.9.2008	Transfertë të “****”, këst blerje apartamenti 101 m ² kati 2, B. Bejko	26,000
26.9.2008	Transfertë të “****”, këst blerje apartamenti për Bledar Bejko	7,000
3.10.2008	Transfertë të “****”, këst blerje apartamenti për Bledar Bejko, 101 m ²	10,000
6.10.2008	Transfertë të “****”, blerje apartamenti për Bledar Bejko, 101 m ²	4,000
Pagesa nga llogaria bankare e z. Bledar Bejko		
3.10.2008	Transfertë të “****”, këst blerje apartamenti Bledar Bejko, 101 m ²	10,000
Pagesa nga llogaria bankare e znj. R.B		
25.2.2009	Transferim të “****”, shlyerje totale blerje apartamenti me kredi	30,000
Total		87,000

2.8 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 47.000 euro dhënë nga prindërit e subjektit dhepaguar prej babait të tij për llogari të shoqërisë “****”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë ka si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament në vitin 2007 në vlerën 90.000 euro nga prindërit e tij.

2.8.i Për këtë deklaram subjekti ka depozituar kontratë premtim shitblerjeje nr. ***, datë 6.11.2007, me palë shitëse E.B dhe palë blerëse H.B, për apartament me sip. 100 m², në rrugën “****”, në vlerën 90.000 euro, kundrejt një kapari prej 20.000 euro që pala blerëse i ka likuiduar me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa e mbetur prej 70.000 euro do të bëhet nëpërmjet një kredie bankare që blerësi do të marrë në një nga bankat e nivelit të dytë.

2.8.ii Komisioni hetoi lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie dhe i rezultoi se ASHK-ja, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tiranë Jug²¹, ka informuar për pasuri të transkriptuara në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit, duke depozituar gjithashtu edhe dokumentacionin përkatës. Nga dosja e administruar rezulton se nëna e subjektit E.B ka shitur apartamentin me sip. 100 m², të ndodhur në rrugën “****” nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 6.11.2007, në vlerën 38.000 USD. Kjo pasuri i është shitur shtetasit H.B, i cili e ka likuiduar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, rezulton se pasuria është regjistruar në emër të shtetasit H.B, i cili ka kryer edhe pagesën taksë hipoteke për blerje apartamenti me vlerë 38.000 USD, në “Raiffeisen Bank”. Ky shtetas ka paguar 380 USD ose 30.590 lekë (380 USD x 80.5), që sipas legjislacionit të kohës (ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”) paguhej 1% e çmimit të shitjes. Për çmim shitje +2.000.000 deri 4.000.000 lekë, tatimi i pagueshëm ishte 1% e çmimit të shitjes.

2.8.iii Meqenëse rezultonin dy vlera të ndryshme për çmimin e shitjes të kësaj pasurie, Komisioni ka pyetur subjektin për detaje të mëtejshme, i cili, në përgjigje, ka sqaruar se: “...në deklaratën Vetting kam deklaruar si burim krijimi transfertën e kryer nëpërmjet ‘Tirana Bank’ 47.000 euro nga prindërit. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 02 kam deklaruar se shuma 47.000 euro ka kaluar nga llogaria e S.B dhe burim për këtë vlerë kanë qenë kursime nga të ardhurat familjare të prindërve të mi nga të gjitha burimet e tyre të ligjshme, një nga të cilat ka qenë edhe shitja e apartamentit me nr. ***, datë 6.11.2007. Prindërit më kanë vënë në dispozicion kontratën me nr. ***, datë 6.11.2007, ku vlera e apartamentit të shitur nga ana e tyre është në shumën 90.000 euro.

²¹Shkresë nr. ***prot., datë 14.2.2020.

Blerësi i këtij apartamenti ka paguar pjesën më të madhe të çmimit të apartamentit me transfertë bankare, pasi i është disbursuar një kredi pranë 'Alpha Bank', ashtu siç është shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 02.

Megjithatë, ashtu siç kam deklaruar edhe në DPV-në vjetore dhe në deklaratën Vetting, si dhe në përgjigjet e mia gjatë hetimit administrativ, burim i shumës së dhuruar nga prindërit kanë qenë kursime nga të ardhurat familjare të prindërve të mi nga të gjitha burimet e tyre të ligjshme, përfshi edhe shitjen e apartamentit të sipërcituar”.

2.8.iv Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka depozituar²² kontratën e kredisë datë 5.12.2007, pranë “Alpha Bank”, të shtetasit H.B. Ky i fundit rezulton se ka marrë kredi shumë 63.000 euro për blerje apartamenti, duke vendosur edhe kolateral apartamentin e blerë nga nëna e subjektit. Gjithashtu, subjekti ka depozituar urdhërpagesën e datës 10.12.2007, ku shtetasi H.B i transferon nga “Alpha Bank” nënës së subjektit E.B vlerën 61.000 euro, me përshkrimin “kaluar nga H dhe E.B te E.B, pagesë përfundimtare për blerje apartamenti”.

2.8.v Nga korrespondenca e Komisionit me “Alpha Bank” kjo e fundit ka informuar²³ se pas kësaj transferte nëna e subjektit e ka tërhequr shumë 61.000 euro një ditë më pas (datë 11.12.2007).

Nga transaksionet e përshkruara më sipër duket se pasuria është shitur realisht në vlerën 90.000 euro, por në hipotekë është regjistruar në vlerën 38.000 USD. Në këto kushte, meqenëse për diferencën e çmimit nuk rezulton të jetë paguar tatim mbi fitimin e realizuar nga shitja, Komisioni ka përfshirë deri në këtë fazë të hetimit në analizën financiare vetëm shumë 38.000 USD si e ardhur me burim të ligjshëm. Për pasojë, dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm për shumë 2.333.098 lekë si diferencë e 47.000 euro²⁴ – 38.000 USD.

2.9 Sa i përket burimit tjetër të krijimit të pasurisë, me përshkrimin “10.000 euro janë transferuar nga llogaria e z. Bledar Bejko në ‘Tirana Bank’”, Komisioni, gjatë hetimit ka konstatuar faktet si vijon:

2.9.i Subjekti deklaron se kjo shumë ka ardhur nga kredi konsumatore e marrë në emër të Bledar Bejko me kontratë kredie bankare konsumatore nr. ***, në shumë 4.000 euro dhe mbyllur para afatit në datën 7.8.2008, dhe kredi konsumatore në emër të R.R me kontratë kredie konsumatore nr. ***, në shumë 5.000 euro dhe shlyer para afatit në datën 7.8.2008. Këto dy kredi u shlyen nga fondet e familjes së znj. R.R.B.

2.9.ii. Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2008, subjekti nuk ka deklaruar kredi konsumatore në shumë 9.000 euro (5.000 + 4.000 euro) dhe shlyerjen e tyre brenda vitit, sikurse deklaron nga prindërit e bashkëshortes. Ndërkohë, gjatë hetimit deklaron se këto dy kredi në shumë 9.000 euro janë mbyllur para afatit, me burim nga ndihma e prindërve të tij.

2.9.iii Këto dy kredi, ashtu siç u analizuan më sipër, u morën për shlyerjen e këstit të parë të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. Shuma e kthyer nga revokimi i kontratës u përdor si burim për kontratën e re. Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me marrjen e këtyre dy kredive.

²²Pyetësor nr.2, datë 14.9.2021.

²³ Me e-mail-in e datës 22.11.2021.

²⁴Konvertimi është kryer sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008.

2.9.iv Meqenëse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se këto kredi janë mbyllur nga prindërit e bashkëshortes, Komisioni e ka pyetur²⁵ subjektin për burimin e ligjshëm të krijimit të shumave 4.000 dhe 5.000 euro nga fondet e familjes së bashkëshortes R.R, si dhe i ka kërkuar të depozitohet dokumentacioni justifikues ligjor në mbështetje të deklaratimit. Subjekti, në përgjigjen e tij, i ka qëndruar deklaratimit se këto kredi janë mbyllur nga prindërit e tij.

2.10 Në lidhje me burimin e radhës, deklaruar “30.000 euro është marrë kredi në ‘Tirana Bank’ për blerje apartamenti”, Komisioni, gjatë hetimit ka konstatuar faktet si vijon:

2.10.i Ka rezultuar se subjekti rivlerësimi dhe bashkëshortja e tij kanë marrë një kredi në “Tirana Bank”, e cila konfirmohet me kontratën²⁶ e kredisë nr. ***, datë 18.2.2009. Sipas kontratës, subjekti i rivlerësimi dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar kredinë në shumën 4.000.000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti.

2.10.ii Sipas kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 18.2.2009, rezultoi se kolateral për këtë kredi është vënë pikërisht apartamenti me sip. 96.5 m² për të cilën po merrej kredia. Sipas kartelës së pasurisë së kësaj pasurie rezultoi se pasuria është bllokuar në favor të “Tirana Bank” për shumën 4.000.000 lekë.

2.10.iii Nga verifikimi i dokumentacionit bankar²⁷ rezultoi se kredia është disbursuar në datën 25.2.2009 në llogarinë e bashkëshortes. Kjo shumë, brenda të njëjtës ditë, është konvertuar në monedhën euro dhe i është kaluar shoqërisë “***” vlera 30.000 euro, si kështu i fundit për blerjen e apartamentit.

2.10.iv Komisioni nuk vëren problematika për këtë burim krijimi të pasurisë. Rezultoi se kredia e konfirmuar e disbursuar është transferuar menjëherë për likuidimin e pasurisë.

2.11 Komisioni, deri në këtë fazë të hetimit, vlerësoi të kryeje përlllogaritjet duke qëndruar vetëm tek të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisëapartament,me kontratën nr. ***, datë 6.11.2007, duke përlllogaritur në analizë financiare vetëm shumën 38. 000 USD, për të cilat rezultoi se ishin paguar detyrimet tatimore dhe në tërësi për këtë pasuri i kaloi subjektit të rivlerësimi barrën e provës për konstatimet se, dukej se: (i) subjekti gjendet në pamundësi financiare në shumën 2.893.370 lekë për të investuar në blerjen e apartamentit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare për vitet 2008 - 2009. Nga kjo shumë, pamundësia financiare prej 2.333.098 lekësh, vjen si rezultat i mospagimit të tatimit mbi fitimin e realizuar nga prindërit e subjektit nga shitja e pasurisë së tyre apartament, në vlerën 90.000 euro dhe jo 38.000 USD; (ii) subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë lidhur me shumën e dhënë nga prindërit e tij dhe mënyrën e marrjes së saj, e përdorur për shlyerjen e vlerës së apartamentit në vitin 2008, pasi në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2008 deklarohet 57.000 euro paguar *cash*, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarohet 47.000 euro me transfera bankare; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 dy kredite konsumatore të marra në “Tirana Bank”, në shumën totale 9.000 euro, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësteve të apartamentit; (iv) subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë për burimin e përdorur për shlyerjet e dy kredive në shumën 9.000 euro, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se janë shlyer brenda vitit, me burim nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, ndërsa gjatë hetimit deklaroi me burim nga kursimet e prindërve të tij; si dhe (v) mungon dokumentacioni justifikues nga prindërit e bashkëshortes së subjektit për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së përdorur për mbylljen e dy kredive.

²⁵Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

²⁶Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁷Statement nga “Tirana Bank”, me shkresën nr.***prot., datë 28.1.2020.

2.12 Në lidhje me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2008. Sipas udhëzimit rezultojnë se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2008, për qytetin e Tiranës, është 81.875 lekë/m². Në këtë vit qyteti i Tiranës rezultoi i ndarë me zonë. Apartamenti i përket zonës 2/5 dhe çmimi shitjes së apartamenteve në këtë zonë në vitin 2008 ka qenë 80.000 lekë/m². Apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit është me sipërfaqe 96.5 m². Duke u bazuar në çmimet referuese rezultojnë se vlera e apartamentit është 7.720.000 lekë. Kjo vlerë është më e ulët se çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 87.000 euro. Në të tilla kushte, Komisioni nuk konstatoi ndonjë trajtim të mundshëm preferencial nga të tretë në përfitimin e kësaj pasurie.

2.13 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në përgjigjet²⁸ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shoqëria “***” sh.p.k. apo shtetasi T.Ç (administrator i shoqërisë), duke mos konstatuar ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet në pikën 2.11

2.14 Në vijim të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, subjekti, në parashtimet e tij lidhur me deklaratimet e shumës së dhuruar, ka parashtuar në mënyrë të përsëritur se: *“Prindërit në vitin 2008 i kanë dhuruar shumën 57.000 euro, shumë e cila është deklaruar rregullisht në DPV-në e këtij viti. Vlera 47.000 euro (e cila përbën pjesën më të madhe të shumës së dhuruar) është transferuar nga llogaria e babait tim në llogarinë e shoqërisë ndërtuese (e cila më shiti apartamentin) me transfertë bankare. Shuma 9.000 euro më është dhënë cash prej tij dhe kjo shumë ka shërbyer për shlyerjen e dy kredive (përkatësisht 4.000 dhe 5.000 euro) të cilat i kemi mbyllur brenda vitit. Ndërsa 1.000 euro (nga shuma 11.000 euro që babai kishte paguar në llogarinë e shoqërisë ‘***’) kaluan në llogarinë time me transfertë bankare. Pra, në shoqërinë ‘***’ u paguan në vitin 2008, 20.000 euro (11.000 euro nga babai im dhe 9.000 euro nga unë) dhe kur kontrata u revokua shoqëria kaloi në llogarinë e secilit prej nesh nga 10.000 euro (pra, kaloi në llogarinë time 1.000 euro më shumë dhe në llogarinë e babait 1.000 euro më pak nga sa ne kishim paguar respektivisht). Shuma 47.000 euro + 10.000 euro = 57.000 euro, përputhet plotësisht me deklarinë e bërë nga ana ime në vitin 2008”.*

2.15 Sipas subjektit, vlera 47.000 euro u transferua nga llogaria e babait tek shoqëria “***” sh.p.k., me disa transfertë bankare, ndërsa pjesa tjetër prej 9.000 euro i është dhënë cash nga babai. Në vitin 2008, sipas subjektit, është lapsus deklarimi vetëm i fjalës cash për mënyrën e marrjes së shumës së dhuruar. Pra, në vend të shënohet 57.000 euro janë dhënë cash dhe transfertë bankare është shënuar vetëm togfjalëshi 57.000 euro janë dhënë cash. Ashtu siç rezultojnë qartësisht nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, vlera 47.000 euro nga shuma e dhuruar është kaluar me transfertë bankare, e provuar nga dokumentet bankare. Mosdeklarimi i kësaj mënyre të marrjes së një pjese të dhurimit (pra me transfertë bankare) në vitin 2008, është pasaktësi e karakterit formal, dukshëm pa ndonjë qëllim fshehjeje, e provuar tej çdo dyshimi me dokumente bankare dhe, si e tillë, pa pasoja në procesin administrativ.

2.16 Subjekti, në DPV-në e vitit 2008, ka deklaruar se *shuma e dhuruar nga babai ka si burim kursime nga pasuria e prindërve të mi (pra në mënyrë të përgjithshme nga të gjitha pasuritë) dhe*

²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

pas presjes në këtë fjali ka specifikuar kontratën nr. ***, datë 6.11.2007 (një prej këtyre burimeve). Subjekti vazhdon me parashtrimet se: *“Veprimet për shitjen e pasurisë janë kryer nga nëna ime, e cila më ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes”*. Siç vërtetohet gjatë hetimit administrativ, vlera reale e pasurisë së shitur në vitin 2008 është 90.000 euro. Sipas subjektit deklarata periodike vjetore e vitit 2008 është më afërt në aspektin kohor në lidhje me burimet që kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhuruar dhe, për këtë arsye, duhet të vlerësojë DPV-në e vitit 2008 si provë, sipas përcaktimeve të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, duke referuar edhe vendime²⁹ të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2.17 Subjekti ka shpjeguar se është një lapsus nga ana e tij, dhënë në deklaratën *Vetting*, fjalia që *“kredia u shlye nga fondet të familjes së R.R.B”*, dhe se ai gabimisht ka shënuar që është shlyer nga prindërit e bashkëshortes, ndërkohë që, ashtu siç deklarohet në DPV-në e vitit 2008, shuma e dhuruar është 57.000 euro, sipas përkrahimit të bërë më sipër. Pra, saktësia aritmetike (57.000 = 47.000 + 1000 + 9000) është një e dhënë që duhet të bindë trupin gjykues, si për vlerën totale të shumës së dhuruar, ashtu edhe për faktin se shlyerja e dy kredive në vlerën 9.000 euro ka si burim shumën e kaluar me dhurim nga babai i subjektit. Sipas subjektit, lapsusi në deklaratën *Vetting* është vetëm një pakujdesi pa asnjë qëllim të kundërligjshëm.

2.18 Subjekti, në vijim, ka parashtruar se prindërit e tij kanë realizuar të ardhura shumë të mira me burime të ligjshme, duke depozituar vërtetimet përkatëse prej vitit 1994 e në vazhdim për çdo të ardhur të përfituar prej prindërve të tij, si: nga punësimi, pensioni, shitja e pasurive dhe interesave bankare (depozita dhe bono thesari), nga qiratë duke paraqitur një analizë financiare për të vlerësuar burimin e ligjshëm të dhurimit (apo mundësinë financiare të prindërve të tij për t'i dhuruar shumën 57.000 euro në vitin 2008) për të ardhurat e realizuara prej tyre vetëm nga data 1.1.2000 deri në tetor të vitit 2008, periudhë në të cilën i është kaluar shuma 57.000 euro e dhuruar.

2.19 Subjekti ka pretenduar se nga analiza e kryer prej tij rezulton qartësisht se vetëm me të ardhurat e realizuara nga prindërit e të tij pas vitit 2000 (pa përfshirë të ardhurat e tyre përpara kësaj periudhe, si dhe pa përfshirë të ardhurat e tij dhe të të vëllait gjatë periudhës që kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët me ta) ata kanë pasur mundësi që t'i dhurojnë shumën 57.000 euro të kursyer nga burimet e tyre të ligjshme. Në këtë drejtim, subjekti ka pretenduar se edhe sikur Komisioni të kryejë përllogaritje vetëm për shumën 47.000 euro e cila i ka kaluar me transfertë bankare, analiza financiare për blerjen e apartamentit paraqitet me balancë negative në vlerën (371.634 lekë), diferencë kjo që sipas subjektit vjen për shkak të faktit se prej vitit 2005 ka bashkëjetuar me znj. R, dhe se bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003 ajo nuk ka qenë subjekt deklarues. Subjekti ka shpjeguar se znj. R fillimisht ka punuar ne ICB Bank për periudhën 1.10.2000 – 30.6.2001, për të cilat nuk kanë mundur të sigurojmë dokumentacion për të ardhurat e realizuara (por theksojnë se Komisioni ka marrë të dhëna për këto të ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore). Nga data 2.7.2001 e në vazhdim, znj. R ka punuar në “Tirana

²⁹Vendim nr.***, në të cilin Kolegji shprehet: *“Në vlerësim të trupit gjykues, deklarata e subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, përfaqëson deklarinimin më të afërt në aspektin kohor lidhur me momentin kur është krijuar pasuria objekt kontrolli, në drejtim të identifikimit të burimeve të përdorura për kryerjen e investimit fillestar për ndërtimin e pikës së karburantit. ...Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se Komisioni vlerësimin e deklaratës së pasurisë *Vetting*, sa i takon përcaktimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, duhet ta kishte kryer të lidhur me deklaratën periodike të vitit 2003, në përputhje edhe me parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016”*.

Vendimnr. ***, datë 17.12.2020, i Kolegjit, ku ndër të tjera, arsyetohet se: *“Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit vlerëson se pavarësisht se është e vërtetë që objekti i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës *Vetting* (ex nunc), deklarinimet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe në këtë mënyrë edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë”*.

Bank”. Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe vërtetohen sipas vërtetimit të datës 16.1.2017, të lëshuara nga kjo bankë, të depozituar gjatë hetimit administrativ. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se nga viti 2001³⁰ deri në dhjetor të vitit 2007 ajo ka realizuar të ardhura në total në shumën 5.855.229 lekë. Në këtë periudhë kohore nuk rezultoi të ketë kryer ndonjë investim apo të ketë kryer ndonjë shpenzim të evidentueshëm, për këtë arsye, në periudhën 1.10.2000 – 31.12.2007 mundësia e saj e kursimit është e lartë, në shumën³¹4.519.011 lekë. Gjendja *cash* e disponuar nga znj. R, sipas subjektit, ka shërbyer për të mbuluar disa nga shpenzimet e kryera gjatë këtij viti. Në këto kushte, analiza financiare e vitit 2008, në secilin prej varianteve të sipërcituara, rezultoi pozitive. I njëjti arsyetim vlen edhe për analizën e vitit 2009.

2.20 Subjekti i ka kërkuar Komisionit që të ketë parasysh edhe faktin që nga analiza financiare e kryer për vitet 2004 - 2007³² balancat në fund të vitit janë pozitive, në shuma relativisht të larta. Gjithashtu, një fakt tjetër që tregon mundësinë e disponimit të gjendjes *cash* në mënyrë të pavarur nga ana e bashkëjetueses, sipas subjektit, janë edhe lëvizjet e saj në llogarinë bankare (depozitime dhe tërheqje të cilat i kryente me qëllim realizimin e disa objektivave që i viheshin si target nga banka). Përveç argumenteve të sipërcituara, Komisioni, edhe sikur të mos marrë parasysh argumentet për gjendjen *cash* të znj. R (e cila bashkëjetonte me subjektin në atë kohë) në lidhje me diferencat negative të vogla (-371.634 dhe -188.638 leke) duhet të zbatojë parimin e proporcionalitetit, tashmë të konsoliduar në praktikën vendimmarrëse të Komisionit dhe të Kolegjit³³.

2.21 Lidhur me mosdeklarimin e dy kredive në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka parashtruar se bazuar në legjislacionin e kohës, në deklaratat periodike vjetore deklaroheshin vetëm detyrimet financiare të mbetura në fund të vitit. Duke qenë se dy kreditë konsumatore u morën dhe u shlyen brenda vitit, nuk ka pasur detyrim në vitin 2008 të deklarohet marrjen e këtyre kredive, për shkak se në fund të vitit nuk ka pasur detyrim ndaj bankës.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

2.22 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, por edhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

2.23 Në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se deklaratimet e subjektit duhet të vlerësohen nën zbatimin e parashikimit të bërë në nenin 30³⁴ të ligjit nr. 84/2016, ku vlerësimi dhe kuptimi i qartë i deklaratimit të subjektit në deklaratën *Vetting* çmohet përmes verifikimit të vërtetësisë së këtij deklarimi, përmes të gjitha fakteve që burojnë të evidentuara nga burimet e njohura të provës, sipas përkufizimeve të ligjit

³⁰Pa përfshirë të ardhurat në ICB.

³¹Subjekti ka paraqitur në formë tabelare përlllogaritjet e kryera referuar parashtrimeve të tij.

³²Analizë ku është përfshirë edhe paga e bashkëshortes.

³³Vendim nr. ***, datë 6.12.2021, ku ndër të tjera, në pikën 25.13.4 arsyetohet se: “[...] Për sa më sipër, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të kryer në Kolegj lidhur me përcaktimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme shumën 9.000 euro, që ka shërbyer për pagesën e kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 68.8 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimor, në përfundim Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagimin e kështit të parë prej 9.000 eurosh, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68.8 m², në rrugën ‘{***}’, Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa ‘b’ e ligjit nr. 84/2016, por e cila u konkludua nga trupi gjykues se nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

³⁴Sipas së të cilit, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

nr. 84/2016, posaçërisht parashikimit të neneve 32/5 dhe 49 të tij, si dhe qëndrueshmërisë së deklarimeve përgjatë procesit të tij të rivlerësimit.

2.24 Në lidhje me deklarinimin e kësaj pasurie, ka rezultuar se subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka bërë një përshkrim të detajuar të veprimeve për blerjen e kësaj pasurie: *transferuar nëpërmjet "Tirana Bank" 47.000 euro nga prindërit e tij, nga shitja e një apartamenti nr. ***, datë 6.11.2007, në shumën 90.000 euro (blerë 34.000 USD, nr. ***, datë 26.4.2004), si dhe shuma 10.000 euro është transferuar nga llogaria e subjektit po pranë "Tirana Bank" dhe 30.000 euro është marrë kredi tek "Tirana Bank" për blerje apartamenti.*

2.25 Trupi gjykues ka vërejtur se ky deklarinim i subjektit në raport me deklarinimin e tij në DPV-në e vitit 2008, *57.000 euro janë dhënë cash, kursime nga pasuria e prindërve nga shitja e një apartamenti 100 m² në rr. "I. i" në dhjetor të vitit 2007 në vlerën 81.000 euro*, pavarësisht moscilësimit prej tij të "transfertes bankare", ka vlerën e provës, sipas përcaktimeve të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, pasi e gjen në harmoni me deklarinimin në deklaratën *Vetting*, sa i takon deklarinimit të kësaj transferte bankare, si dhe me të dhënat/veprimet bankare të konfirmuara nga hetimi administrativ, pasi nga ky i fundit u provua se:

2.26 Vlera 47.000 euro (e cila përbën pjesën më të madhe të shumës së dhuruar) është transferuar nga llogaria e babait të subjektit në llogarinë e shoqërisë ndërtuese dhe se shuma 10.000 euro është rezultat i disa veprimeve të ndërsjella midis subjektit dhe prindërve të tij, nga revokimi i një marrëdhënieje tjetër kontraktore brenda vitit, me shoqërinë "****" sh.p.k.

2.27 Lidhur me deklarinimin e burimit të ligjshëm të shumës së dhuruar nga prindërit, duke cituar vetëm një pasuri të prindërve të tij apo mënyrës së si pretendohet nga subjekti për kuptueshmërinë e deklarinimit të tij në DPV-në e vitit 2008 (kursime nga pasuria e prindërve të tij, pra në mënyrë të përgjithshme nga të gjitha pasuritë) ku edhe pas presjes së përdorur, ai ka specifikuar kontratën nr. ***, datë 6.11.2007, si një prej këtyre burimeve, trupi gjykues, përveç analizimit të deklarimeve në deklaratën *Vetting* dhe në DPV, ka konstatuar se subjekti, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në prapësime, i qëndron deklarinimit se burimi i krijimit të shumës së dhënë nga prindërit janë të gjitha kursimet e tyre nga të gjitha të ardhurat, ato të përfituara nga shitja e pasurisë, interesat e përfituara nga investimi në bono thesari, interesat nga depozitat, si dhe të ardhurat nga punësimi. Ka rezultuar se subjekti këtë qëndrim ka mbajtur gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, që në pikënisje me plotësimin e pyetësorit nr. 2, pra, jo pas dërgimit të rezultatit, fakt që përjashton qëllimin e subjektit për të mbuluar një situatë të caktuar në disfavor të pozitës së tij.

2.28 Trupi gjykues, përveç arsyesimit të bërë mbi deklarinimet sa më sipër, në kushtet kur:

i) Rezultoi se prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekt deklarues në vitin 2008 dhe as në një certifikatë familjare me subjektin që prej vitit 1999 dhe, për pasojë, nuk kanë pasur detyrimin të deklaruar të ardhurat e kursyera si dhe burimet e tyre.

ii) Pasuria e shitur ka qenë në pronësi të nënës së subjektit të rivlerësimit dhe, po ashtu, veprimet për shitblerje, negocimet për çmimin e shitjes, si dhe detyrimi për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit kanë qenë të nënës së subjektit si pronare e vetme.

iii) Rezultoi se jemi përpara një marrëdhënieje të posaçme familjare prind-fëmijë, ku shuma 47.000 euro e transferuar në rrugë bankare nga babai i subjektit, përveçse specifikon autorësinë, pasqyron ekzaktësisht edhe përshkrimin e dhënies së saj në favor të blerjes së pasurisë apartament nga subjekti.

iv) Bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, më konkretisht vendimit nr. ***³⁵(JR), datë 12.10.2021, f. 21.7- 21.9, ku sipas këtij vendimi arsyetohet se: *“Për sa kohë të ardhurat e pretenduara përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe nga ana tjetër këto pasaktësi në deklaram, sikurse është vërejtur nga deklaramet e subjektit, nuk janë të lidhura me mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë... duhet të përfshihen në analizën financiare. Ky vendim ka përfshirë burime të pretenduara si të krijuara nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, ndërsa në rastin e çështjes objekt vlerësimi situata është më në favor të subjektit pasi janë në diskutim dhe pretendohen burime të personave të tjerë të lidhur, siç janë në këtë rast prindërit – në tërësi ka çmuar se kjo çështje duhet vlerësuar lidhur me kryerjen e një analize të mirëfilltë financiare mbi mundësitë e prindërve për t’i dhuruar shumë subjektit, si dhe nëse ata mund të përballonin edhe investimet apo shpenzimet e tjera familjare, sikurse arsyetohet në vijim.*

2.29 Në këtë kontekst, trupi gjykues në këtë çështje, për të krijuar një panoramë të plotë të situatës financiare të familjes së subjektit, e shtriu hetimin administrativ edhe për faktin nëse mund të ekzistonte ndonjë marrëdhënie dhurimi apo transaksione të tjera të kryera mes prindërve të subjektit dhe vëllait të këtij të fundit, si pjesë përbërëse e trungut familjar.

2.30 Nga hetimi i kryer nuk u identifikua ndonjë pasuri e paluajtshme apo e luajtshme, përveç llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”³⁶, në të cilën i kreditohej paga nga punësimi, si dhe blerja e bonove të thesarit të shtetit shqiptar në Bankën e Shqipërisë³⁷.

2.31 Në lidhje me investimin në bono thesari, rezultoi se më 28.2.2006, vëllai i subjektit kishte investuar në bono thesari shumë prej 3.000.000 lekësh³⁸, për të cilën subjektit, pasi iu kërkuan shpjegime për burimin e krijimit të kësaj shume, deklaroi se: *“Shuma e investuar nga im vëlla ka si burim kursimet e prindërve të mi. Kursimet e tyre janë të krijuara nga të gjitha burimet e të ardhurave të tyre, të cilat i kam cituar edhe gjatë hetimit dhe për të cilat kam depozituar edhe dokumentacion justifikues. Prindërit janë munduar gjithmonë të na qëndrojnë pranë, si dhe të na mbështesin financiarisht sa herë që mund të kemi pasur nevojë. Më konkretisht, për sa i përket shumës 3.000.000 lekë, nëna E.B ka tërhequr nga llogaria e saj në ‘Tirana Bank’ shumë 3.000.000 lekë, datë 13.2.2006. Kjo shumë i është dhënë tim vëllai dhe është investuar në bono thesari prej tij”.*

³⁵“...qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Ballafaqimi i deklarimeve periodike me ato të bëra në deklaratën e pasurisë Vetting në vitin 2017, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklaram i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar.

Komisioni, në përputhje me deklaramet në deklaratën e pasurisë Vetting, ka përfshirë në analizën financiare ‘Të ardhura nga klinika 1996 - 1998’ në shumë prej 448.000 lekë dhe ‘Paga si ndihmësgjyqtar *** 1996 – 1998’, në shumë prej 538.560 lekësh, por nuk ka vlerësuar deklaramin e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin e datës 18.4.2019, për të përfshirë në analizë një pjesë të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes në vitin 1998, dhe as ka vlerësuar në tërësi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga bursa e Shkollës së Magjistraturës. Pavarësisht këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson se të ardhurat e pretenduara në ankim përmbushin standardet e ligjshmërisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, dhe nga ana tjetër këto pasaktësi në deklaram nuk janë të lidhura me mungesë të burimeve financiare për të justifikuar pasuritë. Në konkluzion të analizës faktike dhe ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes, si *** për periudhën 1.1.1998 – 15.3.1998, përpjesëtimore me fitimin e vitit në shumë prej 216.667 lekësh, dhe të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës janë të ardhura nga burim i ligjshëm, që duhet të përfshihen në analizën financiare për krijimin e pasurisë me sip. 36 m², në rr. ‘{***}’, Tiranë”.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2022.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2022.

³⁸Me përgjigjet e pyetësorit datë 26.4.2022.

2.32 Trupi gjykues konstatoi se deklarimi i subjektit konfirmohej nga faktet e dala nga hetimi, pasi rezultonte se nëna e tij këtë shumë e kishte tërhequr nga llogaria e saj në “Tirana Bank” në datën 13.2.2006, llogari e çelur me të ardhurat e siguruara nga shitja e magazinës në vlerën *neto* 10.470.000 lekë.

2.33 Trupi gjykues, në kushtet kur nuk konstatoi asnjë investim tjetër nga familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit, kreu nëpërmjet Njësies së Shërbimit Ligjor për llogaritjet financiare³⁹ për të parë mundësitë e prindërve për dhurimin e bërë subjektit, duke marrë në konsideratë të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e identifikuar për periudhën 2000 – 30.6.2008. Nga dokumentacioni i administruar⁴⁰ të ardhurat e prindërve për vitet 2000 - 2008 rezultuan si vijon:

i) Nëna e subjektit E.B, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.1.2000, u ka shitur objektin magazinë nr. *** me sip. 480 m², në ***, së bashku me truallin me sip. 1345 m², në vlerën 10.800.000 lekë shtetasve K.S, V.S dhe K.N. Sipas kontratës, blerësit do të derdhin nëpërmjet bankës për llogari të shitëses deri në datën 5.2.2000 shumën prej 10.470.000 lekësh⁴¹, ndërsa diferencën prej 330.000 lekësh do ta derdhin blerësit në zyrën e tatimeve *** për llogari të shitëses si taksë që rrjedh nga kjo shitje.

ii) Të ardhurat nga interesat e depozitës në “Tirana Bank”, në emër të nënës së subjektit E.B, për periudhën maj 2000 – 2006, janë në shumën 2.704.399 lekë.

iii) Të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit në emër të nënës së subjektit E.B, për periudhën maj 2003 – qershor 2008, janë në shumën 3.598.999 lekë.

iv) Të ardhurat nga punësimi⁴² i babait të subjektit S.B për vitet 2000 – 2002, pranë Fakultetit të ***, janë në shumën 568.170 lekë. Të ardhurat nga punësimi⁴³ për periudhën maj 2005 – gusht 2008 janë në shumën 1.267.050 lekë.

v) Të ardhurat nga pensioni⁴⁴ i babait të subjektit S.B nga data 1.4.2002 kur ka filluar të trajtohet me pension pleqërie⁴⁵ deri në gusht të vitit 2008, janë në shumën 4.707.317 lekë.

vi) Të ardhurat nga interesat bankare në “Tirana Bank”, në emër të babait të subjektit S.B, për periudhën 2004 – gusht 2008, janë në shumën 318.459 lekë.

vii) Të ardhurat nga punësimi⁴⁶ i vëllait të subjektit M.B, për periudhën dhjetor 2006 – qershor 2008, janë në shumën 604.594 lekë.

viii) Gjendje në bankë janë marrë në konsideratë llogaritë bankare të prindërve dhe vëllait të subjektit, si dhe investimet në bono thesari të kryer prej tyre. Gjendja *cash* e mundshme nuk është marrë në konsideratë, pasi është e paidentifikueshme për Komisionin, për sa kohë që familjarët e subjektit të rivlerësimit nuk kanë qenë subjekt deklarues dhe, për pasojë, as edhe objekt i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

³⁹Të ardhurat janë marrë në konsideratë deri në 30 qershor sepse pas kësaj date babai i subjektit depoziton kursimet e tij në bankë për të shlyer më pas, në muajt shtator – tetor, shumën 47.000 euro për blerjen e apartamentit të subjektit të rivlerësimit.

⁴⁰Pyetësor nr.2, datë 14.9.2021, pyetësor nr.3, datë 2.11.2021.

⁴¹Kjo shumë është depozituar në datën 2.2.2000 në llogarinë e shtetasve F.M.B në “Tirana Bank”.

⁴²Vërtetim nr. *** prot., datë 1.10.2021, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i ***, depozituar me pyetësorin nr.2, datë 14.9.2021.

⁴³Statement nga “Raiffeisen Bank”, administruar me shkresën nr.*** prot., datë 16.1.2020.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, nga ISSH-ja, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 14.9.2021.

⁴⁵Babai i subjektit, përveç pensionit të pleqërisë, trajtohet edhe me pension shtetëror suplementar.

⁴⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 1.11.2021, nga RTSH, depozituar nga subjekti me pyetësorin nr. 3, datë 2.11.2021, si dhe *statement* nga “Raiffeisen Bank”, depozituar me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022.

2.34 Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, pavarësisht se në analizën financiare në fazën e rezultateve përfshiu vetëm shumën 38.000 USD, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore, si e ardhur nga shitja e pasurisë apartament, çmon se në këtë çështje duhet të mbahen në konsideratë të gjitha të dhënat e dala nga hetimi mbi origjinën e krijimit të tyre. Nga hetimi për shitjen e kësaj pasurie u identifikuan faktet provuese, të tilla si: (a) ekzistenca e kontratës premtim shitblerjeje nr. ***, datë 6.11.2007, me palë shitëse nënën e subjektit dhe palë blerëse H.B, në vlerën 90.000 euro, kundrejt një kapari prej 20.000 euro që pala blerëse i ka likuiduar me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa e mbetur prej 70.000 euro do të bëhet nëpërmjet një kredie bankare që blerësi do të marrë në një nga bankat e nivelit të dytë; (b) provohet kredia me kontratën e kredisë datë 5.12.2007, pranë “Alpha Bank”, në emër të shtetasit H.B⁴⁷, i cili ka marrë kredi shumën 63.000 euro për blerje apartamenti, duke vendosur edhe kolateral apartamentin e blerë nga nëna e subjektit; (c) provohet përmes urdhërpagesës së datës 10.12.2007 fakti që shtetasi H.B i transferon nga “Alpha Bank” nënës së subjektit vlerën 61.000 euro me përshkrimin “kaluar nga H dhe E.B te E.B, pagesë përfundimtare për blerje apartamenti” dhe se nëna e subjektit⁴⁸ e ka tërhequr shumën 61.000 euro një ditë më pas (datë 11.12.2007), veprime këto të cilat konfirmojnë marrëdhënie juridike të ligjshme. Nën këtë arsyetim dhe nivel provueshmërie, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit korrespondon *de facto* me vlerën e përfutur nga prindërit.

Tabela nr. 2

	Periudha 2000 – 30.6.2008
Total të ardhura	27,394,128
Të ardhura babai S.B (2000 – 30.6.2008)	6,542,537
Të ardhura vëllai M.B (2006 – 30.6.2008)	604,594
Të ardhura nga interesat e bonove të thesarit E.B (2003 – 30.6.2008)	3,598,999
Të ardhura nga interesat e depozitave në “Tirana Bank”, E.B (2000 – 2006)	2,704,399
Të ardhura nga interesat në “Tirana Bank”, S.B (2004 - 2008)	318,459
Të ardhura nga shitja e magazinës, E.B	10,470,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 2007 (38.000 USD)	3,155,140
Total shpenzime	22,541,395
Shpenzime jetese për 3 persona	2,680,092
Blerje apartamenti në vitin 2004 (34.000 USD)	3,215,720
Likuidite, Banka	10,856,005
Dhurimi 47.000 euro për subjektin	5,789,578
Mundësia për kursim (të ardhura - shpenzime)	4,852,733

2.35 Në përfundim, trupi gjykues, pas përllogaritjeve të kryera, konkludoi se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare⁴⁹ për dhurimin e bërë në shumën 47.000 euro, në favor të subjektit të rivlerësimit, të përballojnë investimet dhe shpenzimet e tjera familjare. Si rezultat i këtij

⁴⁷Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

⁴⁸Me *e-mail*-in e datës 22.11.2021.

⁴⁹ Referuar edhe vendimeve të KPA-së, nr. ***, ku në pikën 5.6, ndër të tjera thuhet *Kjo pasuri është përfutur nëpërmjet një burimi të ligjshëm dhe, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ky fakt duhet të prevalojë mbi pasaktësinë në deklaram, si dhe nr.*** datë 14.04.2022 (pika 25.6).*

vlerësimi, konstatohet se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të gjitha të ardhurave familjare.

2.36 Sa i përket burimit tjetër të krijimit të pasurisë, 10.000 euro, të cilat janë transferuar nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit, ashtu siç u citua edhe më sipër, burimi i kësaj shume ish dy kreditë konsumatore të cilat u morën nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për të paguar këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. Pas revokimit të kontratës, kjo shumë iu kthye subjektit dhe u përdor si burim krijimi për kontratën e re të lidhur me shoqërinë “****”.

2.37 Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me marrjen e këtyre dy kredive.

2.38 Ndërsa, sa i përket konstatimit të Komisionit dhe ILDKPKI-së se subjekti nuk i ka deklaruar shlyerjet e këtyre dy kredive në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, trupi gjykues vlerëson së për sa kohë provohet marrja e këtyre kredive dhe shlyerja e tyre brenda të njëjtit vit kalendarik, mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2008 nuk mund të kategorizohet si pasaktësi apo të evidentohet si problematikë.

2.39 Në këtë çështje, trupi gjykues ka analizuar dhe vlerësuar faktet sa i takon burimit të përdorur për shlyerjen e këtyre dy kredive, pasi subjekti ka deklaruar se ato u shlyen nga fondet e familjes së bashkëshortes, ndërkohë ky deklarim pretendohet si lapsus nga ana e tij, pasi janë shlyer nga prindërit.

2.40 Trupi gjykues, në referim të deklaramit të subjektit në vitin 2008, se prindërit i kanë dhuruar shumën 57.000 euro, i cili përputhet me deklaramin e tij gjatë procesit dhe provueshmërisë së veprimeve juridike të ndodhura në vitin 2008, arsyetuar në pikën 2.8 (i-iv) të këtij vendimi, por edhe nga analiza financiare e kryer (pasqyruar në tabelën nr.2), konkludon se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare të dhurojnë shumën totale prej 57.000 euro (47.000 + 10.000). Në këtë kontekst, lapsusi i pretenduar për shumën 10.000 euro bëhet i besueshëm, për sa kohë u provua që prindërit e subjektit në vazhdimësi janë karakterizuar me të ardhura të ligjshme dhe në nivel mbi mesataren.

2.41 Nga ana tjetër, po për këtë çështje objekt vlerësimi, nisur nga fakti se subjekti: (i) gjatë gjithë procesit i qëndron deklaramit se këto kredi janë mbyllur nga prindërit e tij; (ii) në shlyerjet e kryera për këto dy kredi nuk është cilësuar burimi as në depozitimet në bank – trupi gjykues ka vlerësuar të kryejë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit në kushte asnjane, se shlyerjet e këtyre dy kredive janë mbuluar me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes.

2.42 Pas kryerjes së përlllogaritjeve financiare në datën e mbylljes së kredive nga Njësia e Shërbimit Ligjor, sipas tabelës së mëposhtme, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të shlyejë dy kreditë e marra për të paguar këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes, e cila u revokua dhe shuma e kthyer shërbeu më pas për një nga pagesat e kontratës së re për blerje apartamenti, pasuri që subjekti e zotëron aktualisht.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	Datë 7.8.2008
1	TË ARDHURA	2,502,502
	Të ardhura nga paga, subjekti	467,846
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	922,045
	Të ardhura nga interesat bankare	3,969

	Kredia 5.000 euro (23.4.2008)	615,913
	Kredia 4.000 euro (23.4.2008)	492,730
2	SHPENZIME	1,752,328
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	182,160
	Shpenzime TIMS	140,696
	Shpenzime transporti	61,600
	Shpenzime telefonie (Vodafone)	1,315
	Shlyer kredia 5.000 euro (7.8.2008) + interesa	620,329
	Shlyer kredia 4.000 euro (7.8.2008) + interesa	523,046
	Kaluar te E.K	123,183
	Shpenzime për mjetin e vjedhur	100,000
3	PASURI	667,252
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Paguar 9.000 euro “****”	1,108,643
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(441,390)
	DIFERENCA (1-2-3)	82,922

2.43 Pas analizimit të të gjitha burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe provueshmërisë së ligjshmërisë së tyre, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën vjetore 2008 – 2009, kohë kur është investuar në këtë pasuri. Rezultati negativ i konstatuar prej 371.634 lekësh në vitin 2008 dhe 188.638 lekësh në vitin 2009, në total nuk përbën një shumë që mund të ketë peshë në këtë vendimmarrje.

2.44 Trupi gjykues, rezultatin e mësipërm e konsideron me rezervë, për shkak se në analizën e kryer nuk janë përfshirë kursimet e mundshme të bashkëjetueses së subjektit. Në të janë përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet në bankë për bashkëjetuesen e subjektit që prej vitit 2005, por jo kursimet e mundshme të saj, pasi subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë në deklaratat periodike vjetore bashkëjetuesen. Ajo është deklaruar prej tij në momentin që kanë lidhur martesën ligjore në vitin 2010. Fakti që në analizën e kryer subjekti rezulton në vitet 2005 dhe 2007 me balanca pozitive në vlera të konsiderueshme, konkretisht, 1.314.543 lekë në vitin 2005 dhe 1.134.719 lekë në vitin 2007, dukshëm rezulton se këto shuma mund të mbulojë rezultatin negativ të konstatuar.

2.45 Në konkluzion për këtë pasuri, trupi gjykues konkludon se deklaratimet e subjektit edhe në eventualitetin e çmuarjes si pasaktësi të deklaramit të tij, për sa kohë kjo e fundit nuk rezultoi e shoqëruar me mungesë financiare, pra nuk passjell asnjë pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim e tij. Në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të rezultuara, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë atij shtesë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se subjekti ka shpjeguar dhe provuar bindshëm burimet e krijimit të saj.

3.Pasuria automjet tip “**”, me targa *****, e cila rezulton edeklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting se kjo pasuri ështëblerë në tetor të vitit 2013 në shumën 420.000 lekë, nga kursimet. Blerë nga ****, me NIPT ***, nr. fature ***, nr. serie ***. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁵⁰: *dosjen e mjetit me targa ***; deklaratë shitjeje automjeti, datë 19.9.2013, tip “****”, nr. shasje ****, në vlerën 420.000 lekë, me palë shitëse

⁵⁰Aneks nr. ****në dosjen e ILDKPKI-së.

“****” sh.p.k., palë blerëse Bledar Bejko; faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 19.9.2013; faturë zhdoganimi mjeti datë 11.9.2013.

3.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Faktet e rezultuara nga hetimi

3.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, me përshkrimin “blerje autoveture ‘****’, viti 2004, targa ***, shtator 2013, dhënë kunati në Gjermani 1.000 euro. Vlera e blerjes: 400.000 lekë”.

3.3 DPSHTRR-ja⁵¹ informon se z. Bledar S Bejko ka të regjistruar automjetin me targa ***. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion dosjen e plotë të automjetit ku gjendet fatura tatimore datë 19.9.2013, me shitës “****” sh.p.k. dhe blerës Bledar Bejko, për mjetin tip “****”, në vlerën 420.000 lekë, si dhe deklaratën e shitjes datë 19.9.2013, për mjetin tip “****” mes të njëjtave palë të pasqyruara në faturën e shitjes.

3.4 Vihet re se ka një ndryshim të vogël në vlerën e automjetit të deklaruar nga subjekti në deklaratimin periodik me deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

3.5 Komisioni kreu analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e evidentuara deri në datën e investimit.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	Datë 19.9.2013
1	TË ARDHURA	1,772,692
	Të ardhura nga paga, subjekti	763,646
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	959,170
	Të ardhura nga interesat bankare	49,876
2	SHPENZIME	446,151
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	105,768
	Shpenzime <i>TIMS</i>	130,314
	Shpenzime transporti	92,400
	Kredia 4.000.000 lekë (25.2.2009)	117,669
3	PASURI	855,565
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet “****” *** (19.9.2013)	420,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	435,565
	DIFERENCA (1-2-3)	470,976

3.6 Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe se ka pasur mundësi financiare të investojë në pasurinë e luajtshme (automjet), si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

4.Gjendje në llogarinë e përbashkët në “Tirana Bank” në euro, për të cilën subjekti deklaroi: *“Kursime nga pagat ndër vite, dhuratë nga vëllai i R.B, i quajtur L.M, në shumën rreth 6.000*

⁵¹Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020.

euro, 2.025 euro dhuruar nga prindërit e mi, 1.778 euro sjellë me transfertë nga miku im kosovar në ***, Gjermani, i quajtur N.L. Vlera: 40.546,27 euro. Pjesa takuese: 50%”.

4.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar:

- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për llogarinë e deklaruar më sipër.
- Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për dhuratat në shumën rreth 9.800 euro.
- Ka pasaktësi në deklaratimet e depozitës ndër vite.

Hetimi i Komisionit

4.2 Nga korrespondenca e Komisionit me “Tirana Bank”, kjo e fundit⁵² informon se në datën 26.1.2017 gjendja në llogarinë në euro është në vlerën 40.546,27 euro. Kjo llogari është në emër të znj. R.B.B (R), ku subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtë veprimi në llogarinë e bashkëshortes të tij.

4.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e tij periodikisht, si më poshtë detajuar:

4.3.i Në deklaratën periodike të vitit 2010, bashkëshortja e subjektit deklaroi gjendjen e llogarisë në euro, në vlerën 4.268,76 euro.

4.3.ii Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e ndryshimeve të interesave private pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme “shtim pasurie gjatë vitit 2011, në valutë 3.397 euro”.

4.3.iii Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e ndryshimeve të interesave private pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

- 5.000 euro tërhequr nga llogaria e depozitës në “Tirana Bank” më 2.12.2011 dhe kthyer në llogari më 7.3.2012. Kursime nga puna në vite;
- 6.812,91 euro kursime nga pagat për vitin 2012. Depozitë me afat në llogari në “Tirana Bank”.

Gjithashtu, po në këtë deklaratë, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti deklaroi:

- 3.000 euro në llogari në “Tirana Bank” nga L.M, kunati, banor në Gjermani;
- 2.025 euro në llogari në “Tirana Bank” nga babai S.B, nga interesat e depozitës.

4.3.iv Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë:

- shtim pasurie gjatë vitit 2013, kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, derdhjet në datat 21.3.2013 dhe 7.6.2013, vlera 1.600 euro;
- tërheqje në datën 13.12.2013 në llogarinë e përbashkët, dhënë hua kunatës M.R për rregullim shtëpie. Vlera: 10.000 euro.

4.3.v Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë:

- 10.000 euro, kthim huaje nga kunata M.R në dhjetor të vitit 2014, të dhëna në dhjetor të vitit 2013;

⁵²Me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020.

- 6.600 euro, nga të cilat 2.200 dhënë nga kunati L.M, banues në ***, Gjermani, diferenca kursim nga pagat.

4.3.vi Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaron në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë “1.800 euro, nga të cilat 800 dhënë dhuratë nga kunati L.M (R) banues në ***, Gjermani, nëpërmjet Western Union, MoneyGram&RIA, ndërsa diferenca 1.000 euro kursim nga pagat”.

4.3.vii Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit deklaron në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë “4.700 euro kursim nga pagat, 1.778 euro sjellë me transfertë nga miku kosovar në ****, Gjermani, i quajtur N.L”.

4.4 Deklarimet periodike të subjektit të rivlerësimit janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme, duke u krahasuar me gjendjen në fund të çdo viti, sipas *statement*-it nga “Tirana Bank” për të verifikuar vlerën e deklaruar.

Tabela nr. 5

Viti	Deklarim në DPV	Teprica ⁵³ sipas deklaramit në fund të çdo viti	Gjendja në bankë
2010	4,268.76	4,268.76	4,268.76
2011	3,397.00	7,665.76	6,495.00
2012	5,000.00 6,812.91 3,000.00 2,025.00	24,503.67	23,577.07
2013	1,600.00 (10,000.00)	16,103.67	15,801.08
2014	6,600.00 10,000.00	32,703.67	32,387.79
2015	1,800.00	34,503.67	34,378.99
2016	4,700.00 1,778.00	40,981.67	40,546.27

Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* për vlerën e kësaj llogarie përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

4.5 Lidhur me dhurimet e kryera nga familjarët, Komisioni analizoi secilin prej tyre. Më konkretisht:

- a) L.M (kunati) për shumën rreth 6.000 euro;
- b) S.B (prindërit) për shumën 2.025 euro;
- c) N.L (mik i subjektit) për shumën 1.778 euro.

a) *Shtetasi L.M (kunati), dhuruar shumën 6.000 euro*

Subjekti i ka deklaruar dhurimet e kryera nga shtetasi L.M periodikisht dhe në deklaratën *Vetting*. Komisioni i ka kërkuar⁵⁴ subjektit gjatë hetimit administrativ që të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre dhurimeve nga shtetasi L.M, kunati i subjektit.

⁵³Është përlogaritur si shumë kumulative nga viti në vit.

⁵⁴Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

Subjekti ka depozituar dokumentacionin për llogaritjen e pagës për shtetasin L.M, përkatësisht për periudhat tetor 2012, dhjetor 2014 dhe dhjetor 2015. Dokumentacioni i depozituar është i fragmentizuar (pasqyron pagën e vetëm një muaji) dhe nuk pasqyron situatën vjetore financiare të dhuruesit.

Më konkretisht, paga e shtetasit L.M në raport me shpenzimet e jetesës nuk mund ta mbulojë dhurimin e kryer, duke pasur në vëmendje edhe faktin se familja është e përbërë nga tre anëtarë. Komisioni, në tabelën e mëposhtme, ka pasqyruar pagën mujore të këtij shtetasi, sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, të krahasuar me shpenzimet e jetesës për një person dhe mundësinë e kursimit.

Tabela nr. 6

Periudha	Paga <i>neto</i> (euro)	Shpenzime ⁵⁵ jetese/mujore për një person (euro)	Kursimi (euro)
Tetor 2012	1,839.34	979.75	859.59
Dhjetor 2014	2,050.02	986.67	1,063.35
Dhjetor 2015	1,884.70	1,033.42	851.28

Deri në këtë fazë të hetimit, Komisioni nuk ka të ardhurat vjetore për familjen dhe, për këtë arsye, nuk i ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit si të ardhura të ligjshme shumat e dhuruara prej kunatit.

b) Shtetasi S.B (prindërit), dhuruar shumën 2.025 euro

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012 dhurimin e kryer nga babai i tij. Nga hetimi⁵⁶ rezultoi se kjo shumë është transferuar në datën 7.9.2012 nga llogaria bankare në “Tirana Bank” e shtetasit S.B në llogarinë e shtetasës R.B, bashkëshortja e subjektit, me përshkrimin “transfertë nga S.B, dhuratë”.

Subjektit i është kërkuar⁵⁷ nga Komisioni të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij. Nga dokumentacioni i depozituar vihet re se të ardhurat e prindërve nga pagat, pensioni, si dhe interesat bankare (nga depozitat dhe investimi në tituj shtetëror) janë mëse të mjaftueshme për shumën e dhuruar. Më konkretisht, të ardhurat e babait të subjektit S.B nga pensioni për periudhën korrik 2011 – qershor 2012 janë në vlerën 860.053 lekë. Tërheqjet e interesave nga investimi në bono thesari në emër të znj. E.B, nëna e subjektit, për periudhën qershor 2011 – qershor 2012, janë në shumën 861.928 lekë. Totali i këtyre të ardhurave në raport me shpenzimet e jetesës për dy persona mbulojnë shumën e dhuruar ndaj subjektit.

Në të tilla kushte, Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë në burimin e krijimit të tyre dhe, për pasojë, ky dhurim është përfshirë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit si të ardhura me burim të ligjshëm krijimi.

c) Shtetasi N.L (mik i subjektit), dhuruar shumën 1.778 euro

⁵⁵<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

⁵⁶Shkresë nr. ***prot., datë 28.1.2020, nga “Tirana Bank”.

⁵⁷Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

Subjekti rivlerësimi e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016 dhurimin e kryer nga shtetasi N.L. Nga hetimi⁵⁸ rezultoi se kjo shumë është transferuar në llogarinë e shtetasës R.B, bashkëshortja e subjektit, me përshkrimin “transfertë nga N.L”.

Komisioni i ka kërkuar⁵⁹ subjektit të rivlerësimi të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtij dhurimi nga shtetasi N.L. Vihet re se dokumentacioni i depozituar, ashtu si edhe në rastin e shtetasit M, është i fragmentizuar dhe nuk pasqyron të ardhurat vjetore, në mënyrë që Komisioni të kryejë një analizë mbi mundësitë e këtij shtetasi për dhurimin e kryer.

Edhe për shtetasin N.L, deri në këtë fazë të hetimit, Komisioni, meqenëse nuk ka të ardhurat vjetore për të, nuk e ka përfshirë shumën e dhuruar në analizën financiare të subjektit të rivlerësimi si të ardhur me burime të ligjshme shumën prej 1.778 euro, të dhuruar prej shtetasit N.L, mik i subjektit.

4.6 Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit

Komisioni ka hetuar gjithashtu nëse subjekti i rivlerësimi ka trajtuar kallëzime/materiale apo çështje penale lidhur me shtetasit e përfshirë në këto dhurime. Nga dokumentacioni i administruar⁶⁰ në asnjë rast nuk konfirmohet trajtimi i ndonjë materiali hetimor nga subjekti i rivlerësimi në adresë të këtyre shtetasve apo vënë në lëvizje prej tyre nëpërmjet ndonjë kallëzimi.

Në kushte të tilla, duket se nuk konstatohen problematika ndaj subjektit të rivlerësimi për këtë komponent vlerësues.

Në përfundim, për llogarinë në “Tirana Bank”, në vlerën 40.546,27 euro, pas analizimit të lëvizjeve bankare dhe kryerjes së analizës financiare, Komisionit nuk i rezultuan problematika në krijimin e saj.

4.7 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm për dhurimet e kryera nga shtetasit N.L dhe L.M.

Qëndrimi i subjektit

4.8 Në qëndrimin e tij lidhur me burimin e ligjshëm për dhurimet e bëra nga kunati L.M, subjekti ka depozituar edhe një herë vërtetimet e pagave për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, më saktësisht, muajin dhjetor të çdo viti, ku pasqyrohen pagat *bruto* vjetore, specifikisht: për vitin 2012 në shumën 29.650 euro; paga *bruto* e muajit dhjetor në shumën 2.021 euro, ndërsa *neto* është 1.601,24 euro; për vitin 2015 paga *bruto* vjetore në shumën 31.530,61 euro; paga *bruto* e muajit dhjetor në shumën 2.387 euro, ndërsa *neto* është 1.884,70 euro. E njëta gjë pasqyrohet edhe në vitet e tjera.

4.8.1 Lidhur me përlllogaritjet e Komisionit, subjekti ka parashtruar se kunati i tij ka pasur mundësi që të kursejë shumën që i ka dhuruar. Subjekti ka sqaruar se të dhënat e Eurostat-it pasqyrojnë shpenzimet mesatare mujore për një shtetas gjerman, të cilat nuk mund të barazohen me shpenzimet e një emigranti. Kunati punon prej vitesh tek e njëjta kompani ***. Gjithashtu, bashkëshortja e tij ka realizuar të ardhura të ligjshme. Bazuar në legjislacionin gjerman, vëllai i bashkëshortes i ka shpjeguar se edhe për fëmijët shteti gjerman ju akordon 200 euro çdo muaj.

⁵⁸Shkresë nr. ***prot., datë 28.1.2020, nga “Tirana Bank”.

⁵⁹Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021 dhe pyetësor nr. 3, datë 2.11.2021.

⁶⁰Depozituar në pyetësorin nr.3, datë 2.11.2021: shkresë nr.*** prot., datë 19.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë nr.*** prot., F.N. datë 17.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit GjyqësorTiranë; shkresë nr.*** prot., A.K. datë 16.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

4.8.2 Ndërsa, lidhur me burimin e ligjshëm për dhurimet nga shtetasi N.L, subjekti ka parashtruar se ai që gjatë hetimit administrativ ka depozituar dokumentin “vërtetim i pagës nga *** (***)”, ku pasqyrohet edhe paga *bruto* vjetore në shumën 25.327,40 euro. Edhe në këtë rast, sipas subjektit, vërtetimet e pagave kanë të njëjtën kronologji dhe mënyrë llogaritjeje nga shteti gjerman, ku kanë të përfshirë edhe pagat vjetore *bruto*, të cilat vërtetojnë se edhe të ardhurat e këtij shtetasi janë mëse të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhuruar me transfertë bankare.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

4.9 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, paraprakisht ka marrë në analizë të ardhurat sipas dokumentacionit të administruar, ku për secilin dhurues ka konstatuar se:

4.9.1 Për dhuruesin L.M rezulton se pagat *bruto* vjetore për vitet 2012 - 2016 janë si në tabelën e paraqitur në vijim.

Tabela nr. 7

Viti	Paga <i>bruto</i> (euro)	Shpenzime jetese për një person (euro)	Mundësia për kursim (euro)
2012	29,650.84	11,757	17,893.84
2013	24,252.00	11,749	12,503.00
2014	5,146.24	11,840	-6,693.76
2015	31,530.61	12,401	19,129.61
2016	35,992.10	12,765	23,227.10
TOTAL	126,571.79	60,512	66,059.79

4.9.2 Trupi gjykues konkludon se ky shtetas ka pasur mundësi të kryejë dhurimet e deklaruara nga subjekti, pasi rezultoi që mundësia për kursim e shtetasit L.M, në shumën 66.060 euro është në një vlerë të tillë që në raport me shumën e dhuruar prej 6.000 euro dhe me zbritjen e taksave nga paga *bruto* dukshëm është në një shumë të konsiderueshme. Nga ana tjetër, këto dhurime, përtej nivelit deklarativ, u konfirmuan dhe u verifikuan sepse ishin kryer me transaksion bankar për secilin vit.

4.9.3 Për dhuruesin N.L rezultoi se të ardhurat *bruto* për vitin 2015 ishin në vlerën 28.529,92 euro. Trupi gjykues konkludon se ky shtetas ka pasur mundësi të kryejë dhurimin e deklaruar nga subjekti, pasi këto të ardhura, në raport me shpenzimet e jetesës dhe taksat mbi pagat *bruto*, dukshëm e mbulojnë shumën e dhuruar prej 1.778 euro dhe, për pasojë, shtetasi N.L ka pasur mundësi të bëjë dhurimin e deklaruar ndaj subjektit. Nga ana tjetër, ky dhurim, përtej nivelit deklarativ, u konfirmua dhe u verifikua sepse ishte kryer me transaksion bankar.

4.9.4 Lidhur me këto dhurime, për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues i përfshiu në analizën financiare dhurimet e kryera nga shtetasit L.M dhe N.L. Në tërësi për këtë çështje, trupi gjykues, pas konstatimit se përfshirja ose jo e këtyre dhurimeve nuk afekton analizën e tij financiare, pasi subjekti rezulton në çdo rast në balancë pozitive, konkludon se nuk evidentohen problematika që mund të ngrihen në nivelin e shkakut për penalizimin e subjektit.

5.Gjendje në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” në fund të vitit 2016, në vlerën 227.728,08 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁶¹: *nxjerrje llogarie*

⁶¹Aneks nr. ***në dosjen e ILDKPKI-së.

nga "Raiffeisen Bank", datë 19.1.2017. Balanca e llogarisë në datën 31.12.2016 në shumën 227.728 lekë.

5.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 31.12.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 26.1.2017.*

5.2 "Raiffeisen Bank", me shkresën nr. 965/1 prot., datë 16.1.2020, informon se z. Bledar Bejko ka llogari me gjendje 133.438,08 lekë, në datën 26.1.2017, ndërsa në datën 31.12.2016 gjendja është në vlerën 227.728,08 lekë.

5.3 Trupi gjykues, lidhur me këtë likuiditet, ka konstatuar se deklarimi i subjektit korrespondon me gjendjen në fund të vitit 2016 dhe jo me datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe nuk evidenton ndonjë problematikë.

6. Dhuratë nga kunati L.M dhe gruaja e tij F, nëpërmjet institucioneve financiare Ak Invest, MoneyGram, RIA, Wester Union, depozitë në llogari për motrën 6.000 euro dhe 1.000 euro për mbesën N.B. Shumat: 7.800 euro dhe 81.700 lekë.

7. Vlera 1.000 euro, dhuruar nga miku i subjektit E.K nga Gjermania me Money Gram

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Subjekti ka deklaruar dhurata në shumën 8.000 euro dhe dokumentuar në total shumën 1.800 euro + 81.698 lekë, konvertuar në shumën rreth 327.200 lekë.*

Hetimi i Komisionit

7.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurimet e kryera nga shtetasi L.M për të dhe vajzën e tij N.B, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 8

Viti	2012	2014	2015	2016
Shuma e dhuruar	3,000	2,200	1,800	1,000

Në total, këto dhurime janë në vlerën 8.000 euro.

7.3 Komisioni e ka pyetur⁶² subjektin lidhur me shumën e dhuruara, pasi kishte ndryshime në vlerat e deklaruara. Në përgjigje të tij subjekti ka sqaruar se: *"Ne kemi deklaruar dhuruar nga kunati dhe gruaja e tij F nëpërmjet instituteve financiare Ak Invest. Shumat janë 700 euro dhe 81.700 All (shkruar gabimisht shuma 800 euro) ardhur me Ak Invest⁶³ dhe nuk janë shtuar në llogarinë tonë, këto shuma janë tërhequr dhe kanë qenë për familjarët e bashkëshortes duke qënë se janë të moshuar dhe e kanë të vështirë për të lëvizur".*

Trupi gjykues, çështjen që lidhet me mundësitë financiare të shtetasit L.M, e ka trajtuar/arsyetuar në pikën nr. 4.9.2 të këtij vendimi dhe, për pasojë, vlerëson të mos bjerë në përsëritje nën të njëjtin arsyetim.

7.4 Ndërsa, për dhurimin e kryer nga shtetasi E.K, rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë dhurim në deklaraten periodike të vitit 2016. Ky dhurim deklarohet për herë të parë në deklaraten *Vetting*. Për të provuar shumën e dhuruar, subjekti ka depozituar vërtetimin nga AK Invest, ku ky

⁶²Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

⁶³Dokument nga Ak Invest, vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, ku janë të pasuruara këto shuma.

i fundit konfirmon faktin se në datën 28.5.2016 subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumën 1.000 euro nga shtetasi E.K.

7.5 Komisioni i ka kërkuar⁶⁴ subjektit të rivlerësimit të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhuruar. Subjekti ka depozituar vërtetim nga Agjencia Federale e Punësimit. Nga ky dokumentacion vihet re se shtetasi E.K, për periudhën 2.11.2015 – 1.11.2016, është në asistencë nga papunësia. Pagesa mujore që përfiton ky shtetas është në shumën 8.09,1 euro. Duke u nisur nga Eurostat-i⁶⁵ për shpenzimet mujore, rezulton se për vitin 2016 shpenzimet e jetesës për një person në shtetin gjerman janë në shumën mbi 1.000 euro. Meqënëse subjekti i rivlerësimit nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokument tjetër për të pasqyruar situatën financiare të shtetasit K, Komisioni, deri në këtë fazë të hetimit, ka arsyetuar dhe vlerësuar vetëm mbi dokumentacionin që ka vendosur në dispozicion subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit.

7.6 Për sa i përket këtij dhurimi, duket se shtetasi E.K nuk ka pasur mundësi financiare të dhurojë shumën 1.000 euro dhe, për pasojë, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë këtë dhurim.

7.7 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi mungonte dokumentacion justifikues për të provuar mundësinë financiare të shtetasit E.K për të dhuruar shumën, objekt i këtij hetimi administrativ.

7.8 Subjekti, në qëndrimin e tij, ka sqaruar se dokumentacioni i depozituar që gjatë hetimit administrativ nga Agjencia Federale e Punësimit *** për këtë shtetas, pasqyron të ardhurat e ligjshme për periudhën 2.11.2015 – 1.11.2016 me të ardhura mujore 809,10 euro. Ky shtetas ka një periudhë shumë të gjatë kohore që jeton dhe punon në Gjermani, ku paratë janë dërguar me transfertë bankare dhe në këto kushte provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave të transferuara me transfertë bankare.

7.9 Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, konstatoi se të ardhurat e pasqyruara, nuk provojnë të ardhura nga punësimi, por provojnë të ardhurat e përfituara nga asistenca sociale dhe, që për pasojë, rezultoi se në raport me shpenzimet e jetesës nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar dhurimin e kryer.

7.10 Në kushte të tilla, edhe pse nuk u përfshi në analizën financiare shuma e dhuruar, trupi gjykues konstatoi se analiza financiare për vitin 2016 rezulton në balancë pozitive.

Detyrime financiare

8. Kredi në shumën 4.000.000 lekë (ekuivalenti i 30.000 euro) në “Tirana Bank”, me kontratë kredie bankare për shtëpi nr. *, nr. ***, datë 18.2.2009, kontratë hipotekimi nr. ***, datë 18.2.2009. Afati kohor i kredisë: 30 vjet (18.2.2009 – 18.2.2039). Duke qenë se janë bërë shlyerje pjesore kredie herë pas here, kësti i kredisë mujor është i ndryshueshëm vazhdimisht. Shlyerja e kredisë prej 3.055.031 lekësh është bërë ndër vite nga data e marrjes së kredisë deri në fund të vitit, dhjetor 2016. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është 944.969,97 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁶⁶.**

⁶⁴Pyetësor nr. 2, datë 14.9.2021.

⁶⁵<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

⁶⁶Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë kredi bankare për shtëpi nr. ***, kredimarrës R.R, Bledar Bejko, kredidhënës “Tirana Bank”. Shuma e kredisë: 4.000.000 lekë, e cila do të përdoret për blerjen e një apartamenti, me afat 30-vjeçar. Pagesa e kësaj kredie do të sigurohet nga pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** (Aneks nr. ***).

8.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak se deklarimi i përket datës 31.12.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 26.1.2017.*

8.2 Trupi gjykues, këtë kredi, kohën e marrjes dhe qëllimin e saj, e ka trajtuar në pasurinë nr. *** të këtij vendimi. Për sa i përket detyrimit të mbetur për këtë kredi, vërehet se nga korrespondenca e Komisionit me “Tirana Bank”, kjo e fundit konfirmon se detyrimi i mbetur deri më 26.1.2017 është në vlerën 745.620,95 lekë. Në këto kushte, rezulton se deklarimi i subjektit korrespondon me detyrimin e mbetur në dhjetor të vitit 2016 dhe jo me datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, për rrjedhojë, nuk konstaton ndonjë problematikë.

9. Shpenzime për arsimimin e vajzës N.B, në shkollën “*”.** Data e fillimit të shkollës 13.9.2016, shuma e paguar deri në dhjetor të vitit 2016 (4 muaj) 70.000 lekë (kësti mujor i shkollës është 13.000 lekë, plus transporti 4.500). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer: 70.000 lekë.

9.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me shpenzimet për arsimimin e vajzës.*

9.2 Subjekti i rivlerësimit është pyetur⁶⁷ në lidhje me këto shpenzime dhe ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 14.1.2022, nga shkolla “***”, ku konfirmohet se nxënësjja N.B.B është e regjistruar në shkollën shqiptaro-amerikane “***” prej shtatorit të vitit 2016 deri në dhjetor të vitit 2019, si dhe pagesat përkatëse.

Këto shpenzime, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare të kryer.

10. Kredi në “Tirana Bank” me kontratë kredie bankare e siguruar me mjete monetare nr. * dhe marrëveshje siguroese në shumën 25.000 euro,** datë 30.6.2016, duke lënë si garanci depozitën në “Tirana Bank” dhe mbyllur kredia më 31.8.2016. Kjo kredi nuk u përdor (u mor për realizim targeti, pasi znj. R.B është *** në bankën e nivelit të dytë “Tirana Bank”). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁶⁸.

10.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me mbylljen e kredisë në vitin 2016 në vlerën 25.000 euro.*

10.2 Trupi gjykues, lidhur me këtë kredi, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë kredi në deklaratën periodike të vitit 2016 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*. Rezulton se⁶⁹ kjo kredi është disbursuar më 30.6.2016, në shumën 25.000 euro, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shumë e cila nuk është tërhequr apo transferuar, por ka qëndruar në llogari deri në datën e shlyerjes (kthimit të kësaj kredie), më 31.8.2016. Mbi këto fakte, trupi gjykues konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga “Tirana Bank”.

Deklarimet e subjektit në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”

⁶⁷Pyetësor nr. 5, datë 11.1.2022.

⁶⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë kredi bankare e siguruar me mjete monetare nr. ***, datë 29.6.2016. Kredimarrës R.R (B), Bledar Bejko. Shuma: 25.000 euro me afat deri në datën 13.9.2016. Qëllimi “mbulimi i nevojave financiare”. Marrëveshje siguroese datë 29.6.2016, ku barrëdhënësi i jep barrëmarrësmarrësit një barrë siguroese mbi shumën e parave prej 38.181,99 euro të barrëdhënësit me nr. bazë llogarie ***, si dhe të gjitha shumat e parave të fituara nga barrëdhënësi pas lidhjes së kësaj marrëveshjeje në formën e interesave bankare, të ardhurave dhe përfitimeve monetare që rrjedhin nga ruajtja dhe mbajtja e shumës së parave të përcaktuara ne pikën më sipër.

⁶⁹Shkresë nr. ***prot., datë 28.1.2020, nga “Tirana Bank”.

11. Llogari e përbashkët në “Tirana Bank” e N.B.B, e bija e subjektit, me R.B (e ëma), pasi është minorene (të ardhurat e N.B në llogaritë e saj burojnë nga dhurata për ditëlindje në vite nga gjyshërit, teza, xhaxhai, daja, nuna dhe prindërit). Shumat: 63.000,09 lekë, 324,96 USD dhe 3.490,12 euro.

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor në lidhje me llogaritë e deklaruara më sipër.*

11.2 Trupi gjykues, lidhur me këtë llogari, ka konstatuar se “Tirana Bank”⁷⁰ konfirmon faktin se N.B.B ka llogari në “Tirana Bank” në monedhat lekë, euro dhe USD, çelur në vitin 2011, në të cilën ka të drejtë veprimi shtetësja R.B.B (R).

11.3 Nga analizimi i *statement*-it vihet re se të gjitha depozitimet në llogaritë e vajzës së subjektit janë dhurata për ditëlindje nga familjarët dhe prindërit. Gjendja në datën 26.1.2017 për secilën llogari është në vlerat, si vijon:

- llogari në lekë në vlerat 54.390,39 lekë dhe 8.609,7 lekë;
- llogari në dollarë në vlerat 100 USD dhe 224,96 USD;
- llogari në euro në vlerat 3.199,77 euro dhe 290,35 euro.

11.4 Në përfundim, trupi gjykues, për këtë çështje objekt vlerësimi, pas analizimit të të dhënave të konfirmuara sa më sipër, ku rezulton se totali për secilën monedhë është në shumat 63.000,09 lekë, 324,96 USD dhe 3.490,12 euro, konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. R.B

12. Apartament me sip. 96.5 m², në *, ***, Tiranë, blerë në vlerën 87.000 euro** me kontratë shitjeje nr. ***, datë 30.10.2008. *Transferuar nëpërmjet “Tirana Bank” shuma 47.000 euro nga prindërit S.B, nga shitja e një apartamenti nr. ***, datë 6.11.2007, në shumën 90.000 euro (blerë 34.000 USD, nr. ***, datë 26.4.2004), kontratat bashkëlidhur. Ndërsa shuma 10.000 euro është transferuar nga llogaria e z. Bledar Bejko në “Tirana Bank”. Kjo shumë ka ardhur nga kredi konsumatore e marrë në emër të z. Bledar Bejko me kontratë kredie bankare konsumatore nr. ***, në shumën 4.000 euro, mbyllur para afatit në datën 7.8.2008, si dhe kredi konsumatore në emër të znj. R.R me kontratë kredie konsumatore nr. *** në shumën 5.000 euro, shlyer para afatit në datën 7.8.2008. Këto dy kredi u shlyen nga fondet e familjes së znj. R.R Bejko. Diferenca prej 30.000 euro është marrë kredi tek “Tirana Bank” për blerje apartamenti. Mobilimi: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50%, pjesa tjetër e bashkëshortit.*

13. Gjendje në llogarinë e përbashkët në “Tirana Bank” në euro - kursime nga pagat ndër vite, dhuratë nga vëllai i znj. R.B, L.M, në shumat rreth 6.000 euro dhe 2.025 euro, dhuruar nga prindërit 1.778 euro, sjellë me transfertë nga z. N.L në Gjermani. Vlera: 40.546,27 euro. Pjesa takuese: 50%.

13.1 Trupi gjykues, në kushtet që këto pasuri janë të njëjta me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të trajtuara/arsyetuara më sipër në këtë vendim, çmon të mos bjerë në përsëritje nën të njëjtin arsyetim.

14. Gjendja në llogarinë në USD në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortes, në vlerën 2.338,14 USD. Pjesa takuese: 100%.

⁷⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020.

14.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me llogarinë e deklaruar më sipër.*

14.2 Trupi gjykues, lidhur me këtë llogari, kreu hetimin administrativ, administroi dokumentacionin bankar nga “Tirana Bank”⁷¹, ku pas analizimit të saj rezulton se konfirmohet fakti se znj. R.B.B (R) ka llogari në “Tirana Bank” në monedhat lekë, euro dhe dollarë, çelur në vitin 2001. Nga analizimi i *statement-it*, gjendja në datën 26.1.2017 për llogaritë në monedhën dollarë janë në vlerat 2.039,9 USD dhe 300,01 USD. Në total: 2.339,91 USD. Subjekti, në deklarimin e tij, nuk ka përfshirë interesin e përfituar gjatë muajit janar në vlerën 1,77 dollarë, duke konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

15. Automjet “**” tipi ***, me targa ***, prodhim i vitit 2000**, blerë me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 25.5.2010, në shumën e dhuruar nga e motra M.R prej 3.500 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës⁷².

15.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e shumës 3.500 euro dhuratë nga motra e bashkëshortes, M.R.*

Faktet e rezultuara nga hetimi

15.2 Bashkëshortja e subjektit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, me përshkrimin “*Automjet tip ‘****’, vit prodhimi 2000, ***, blerë në datën 26.5.2010, me vlerë 3.500 euro, me burim dhuratë nga motra ime M.R*”.

15.3 DPSHTRR-ja⁷³ konfirmon automjetin me targa *** në emër të znj. R.B. Në dosjen e depozituar nga kjo drejtori për automjetin, rezulton se është blerë nga znj. R.R në datën 25.5.2010 nga shtetasi M.A, në vlerën 3.500 euro, me kontratën nr. ****.

15.4 Meqenëse si në deklaratën periodike, ashtu edhe në atë *Vetting*, burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar i njëjtë, dhuratë nga motra e bashkëshortes së subjektit M.R, Komisioni i ka kërkuar⁷⁴ subjektit të depozitojë dokumentacionin justifikues mbi të ardhurat e ligjshme të dhurueses. Subjekti ka depozituar vërtetimin e punësimit datë 17.11.2021 nga “**** Bank”, ku janë pasqyruar të ardhurat e shtetasës M.R për periudhën shkurt 2007 – maj 2013.

15.5 Trupi gjykues, në analizë të të ardhurave të dokumentuara, konstaton se vetëm për vitet 2007 - 2009 rezulton se shtetasja M.R ka përfituar shumën 3.615.209 lekë. Kjo shumë, në raport me shpenzimet e jetesës, është mëse e mjaftueshme për të mbuluar dhurimin në vlerën 3.500 euro. Në këto kushte, trupi gjykues konkludon se provohet burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

Detyrime financiare

Në vijim, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar:

16. Kredi në shumën 4.000.000 lekë (ekuivalent me 30.000 euro) në “Tirana Bank”, me kontratë kredie bankare për shtëpi nr. **, nr. ****, datë 18.2.2009, kontratë hipotekimi nr. ****,**

⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020.

⁷²Aneks nr. ***. Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 25.5.2010. Palë shitëse M.A, palë blerëse R.R. Automjet tip “****”, me nr.shasie ****, në vlerën 3.500 euro. Bashkëlidhur dokumentacioni i mjetit.

⁷³Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2018. Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁴Pyetësor nr.3, datë 2.11.2021.

datë 18.2.2009. Afati kohor i kredisë është për 30 vjet (18.2.2009 – 18.2.2039). Duke qenë se janë bërë shlyerje pjesore kredie herë pas here, kësti i kredisë mujor është i ndryshueshëm vazhdimisht. Shlyerja e kredisë prej 3.055.031 lekësh është bërë ndër vite nga data e marrjes së kredisë deri në fund të vitit, dhjetor 2016. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është 944.969,97 lekë.

17. Shpenzime për arsimimin e vajzës N.B në shkollën “*”.** Data e fillimit të shkollës 13.9.2016. Shuma e paguar deri në dhjetor të vitit 2016 (4 muaj), 70.000 lekë (kësti mujor i shkollës është 13.000 lekë, plus transporti 4.500). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 70.000 lekë.

18. Kredi e marrë në “Tirana Bank”, me kontrate kredie bankare e siguruar me mjete monetare *** dhe marrëveshje siguroese në shumën 25.000 euro, datë 30.6.2016, duke lënë si garanci depozitën pranë “Tirana Bank” dhe mbyllur kredia më 31.8.2016. Kjo kredi nuk u përdor (u mor për realizim targeti pasi znj. R.B është *** dege në bankën e nivelit të dytë “Tirana Bank”).

Trupi gjykues, në kushtet kur këto detyrime janë deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit dhe janë trajtuar/arsyetuar më sipër në këtë vendim, çmon të mos bjerë në përsëritje.

GJETJE TË TJERA

19. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se bashkëshortja e subjektit, znj. R.B (R), kishte kryer depozitime dhe tërheqje të vazhdueshme në llogaritë e saj bankare në “Tirana Bank”, në monedhat lekë dhe euro.

Komisioni e ka pyetur⁷⁵ subjektin për një pjesë të transaksioneve të evidentuara, duke i kërkuar të japë shpjegime për to dhe të specifikojë burimin e krijimit të këtyre të ardhurave.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje, deklaroi se: *“Veprimet janë të gjitha në llogaritë e saj. Duke qenë se ka punuar në bankë i ka pasur të lehta veprimet e depozitimeve dhe tërheqjeve. Në llogaritë e saj ka kryer veprime si për vete dhe për anëtarët e familjes, duke lehtësuar ata për veprimet e tyre në bankë. Burimi i krijimit të arkëtimeve të kryera janë nga pagat dhe të ardhurat e familjarëve të saj. Në periudha të caktuara kohore, llogaria ka qenë e përbashkët me prindërit dhe motrën e saj. Theksoj se znj. R është bërë person i lidhur me mua pas lidhjes së martesës në datën 26.1.2010. Vlerësoj se përpara kësaj date, ajo nuk ka detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të lëvizjeve në llogarinë e saj. Për veprimet në llogari të bashkëshortes nga viti 2010 deri në vitin 2016 ne i kemi raportuar në deklaratimet vjetore.*

Gjatë ushtrimit të funksionit tim, nuk kam hetuar, regjistruar, mosfilluar, vendosur apo dërguar për gjykim çështje në ngarkim të shtetasve (që kanë vepruar në llogarinë e bashkëshortes time, apo për personat që bashkëshortja ka kryer transferta) apo të kallëzuar ndaj tyre”.

19.1 Subjekti këtë qëndrim ka mbajtur edhe në ILDKPKI, në procesverbalin⁷⁶ e mbajtur në datën 27.4.2016 ku, ndër të tjera, ka shtuar se: *“Dua të qartësoj se te llogaria e bashkëshortes sime në ‘Tirana Bank’, që prej hapjes së kësaj depozite kur bashkëshortja ime ka qenë vajzë e në vitet në vijim edhe pas martese, në llogarinë e saj janë kryer veprime nga prindërit për efekt të moshës dhe të praktikitetit, por edhe nga vëllai edhe motra e saj ashtu si ju del edhe juve nga verifikimi i kryer. Pra, kanë qenë veprime praktikiteti për familjen e saj”.*

⁷⁵Pyetësor nr.3, datë 2.11.2021.

⁷⁶Depozituar me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020, nga ILDKPKI-ja.

19.2 Meqenëse subjekti ka deklaruar në pyetësoin standard se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshorten prej vitit 2005, Komisioni e ka kategorizuar këtë të fundit person të lidhur që prej kësaj periudhe, pavarësisht se subjekti është martuar në vitin 2010. Për këtë arsye, pas analizimit dhe hetimit të disa transaksioneve, Komisioni e shtriu hetimin edhe më tej përgjatë procesit⁷⁷, duke i kërkuar subjektit të deklarojë lidhur me burimin e krijimit të çdo derdhjeje bankare të kryer nga bashkëshortja R.B në llogarinë/të e saj bankare për periudhën 2005 – 2010.

19.3 Subjekti, paraprakisht, ka parashtruar se bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 9049/2003, Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, si dhe Jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Institucioneve të Rivlerësimit, znj. R.R nuk ka qenë person i lidhur me të përpara datës së lidhjes së martesës dhe, për këtë arsye, ai nuk ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e parave të depozituara prej saj në llogarinë bankare, duke referuar edhe vendimin⁷⁸ e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

19.4 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar: *“... siç kam shpjeguar edhe gjatë hetimit administrativ dhe siç rezulton qartësisht nga statementi bankar, shumat janë depozituar dhe janë tërhequr. Ka parashtruar se llogaritë bankare kanë qenë edhe në emër të familjarëve dhe në to janë kryer veprime edhe nga familjarët me burim të ardhurat e tyre të përbashkëta. Motra e bashkëshortes ka punuar edhe ajo në sistemin bankar (Banka *** dhe Banka ***) edhe ka realizuar të ardhura të mira, sipas dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit administrativ. Përveç dokumentacionit të paraqitur, motra e bashkëshortes, ka marrë të ardhura të mira edhe në Bankën ***, por për shkak se kjo bankë është blerë nga ‘ABI Bank’”.*

19.5 Subjekti ka depozituar tabelën në formatin excel, me sqarimet përkatëse për secilin transaksion në mënyrë analitike nga bashkëshortja e tij, me përshkrimin përkatës, si dhe vërtetimin nr. ***, datë 20.4.2022, të “ABI Bank”, për të provuar faktin që motra e bashkëshortes së subjektit, shtetasja M.R, ka qenë punonjëse e NBG-së në periudhën 2001 – 2006, si dhe realizimin e të ardhurave *neto* nga punësimi i saj në këto vite.

19.6 Subjekti sqaron se: *“Përtej argumenteve të sipërcituara bazuar në deklaratimet e znj. R (tashmë bashkëshortja ime) sqaroj se: znj. R ka filluar punë në Bankën *** (***) në datën 1.10.2000 – 30.6.2001, periudhë për të cilën nuk kemi mundur të sigurojmë dokumentacion për të ardhurat e realizuara, për shkak se kjo bankë është blerë nga ‘Union Bank’. Nga data 2.7.2001 e në vazhdim ajo është e punësuar në ‘Tirana Bank’. Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe vërtetohen sipas vërtetimit të datës 16.1.2017, të lëshuar nga ‘Tirana Bank’ të depozituar gjatë hetimit administrativ. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se nga viti 2001 deri në muajin maj të vitit 2007 (muaj në të cilën gjendet shuma më e madhe gjendje në llogarinë bankare të saj) ajo ka realizuar të ardhura në total në shumën 4.869.506 lekë. Veprimet janë kryer në llogarinë e përbashkët bankare me familjarët e saj dhe kursimet e vendosura në këtë llogari janë kursime të përbashkëta familjare. Bashkëshortja ka pasur mundësi që të kursejë deri në fund të vitit 2007 një shumë të konsiderueshme të ardhurash”.*

Sipas subjektit, bashkëshortja e tij, për shkak se ishte punonjëse banke, kryente veprime të ndryshme në llogarinë e saj me qëllim që të përfitonte shuma të vogla nga kurset e këmbimit valutor si jashtë edhe brenda bankës, por edhe për shkak të realizimit të disa objektivave të vendosura nga banka, të cilat ajo i quan target. Subjekti shprehet se: *“Në momentin që ne jemi martuar bashkëshortja ka bërë deklarinë e pasurisë dhe sipas të dhënave që pasqyrohen në*

⁷⁷Edhe me riçeljen e hetimit administrativ.

⁷⁸Vendim nr.***, datë 25.6.2020.

statementin bankar dhe në analizën e kryer nga Komisioni gjendja në llogaritë e saj bankare të vitit 2010 ka qenë në shumën totale 830.658 lekë, gjendje e mbuluar nga të ardhurat e ligjshme”.

Arsyetimi në raport me faktet e konstatuara dhe ligjin

19.7 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, ka vërejtur se subjekti ka qenë konsistent në shpjegimet e dhëna prej tij, si në ILDKPKI kur është pyetur, por edhe gjatë gjithë procesit rivlerësues, pavarësisht se ato janë dhënë në periudha të ndryshme. Më konkretisht:

a) Subjekti ka sqaruar në ILDKPKI se: *“Llogaria e bashkëshortes në ‘Tirana Bank’, që prej hapjes kur bashkëshortja ime ka qenë vajzë e në vitet në vijim edhe pas martesë, në llogarinë e saj janë kryer veprime nga prindërit për efekt të moshës dhe të praktikitetit, por edhe nga vëllai edhe motra e saj ashtu si ju del juve nga verifikimi i kryer. Pra, kanë qenë veprime praktikiteti për familjen e saj”.*

Subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja ka pasur një periudhë 8-9 vjeçare të punësuar në “Tirana Bank” në pozita drejtuese dhe se ka pasur të ardhura nga puna në Bankën *** edhe më pas në “Tirana Bank”. Gjithashtu, babai i saj ka përfituar të ardhura nga shitja e një ndërmarrjeje shtetërore ***, motra e vet ka qenë e punësuar në sistemin bankar në Shqipëri si Banka ***, ***, “*** Bank”, gjithashtu babai i saj ka punuar emigrant edhe në Greqi dhe Gjermani ku ndodhet edhe vëllai i bashkëshortes, i cili ka ikur prej viteve 1991.

b) Gjatë hetimit të Komisionit, subjekti ka qartësuar se veprimet janë të gjitha në llogaritë e saj, pasi duke qenë se ka punuar në bankë e ka pasur të lehtë të kryejë veprimet e depozitimeve dhe tërheqjeve. Në llogaritë e saj ka kryer veprime si për vete dhe për anëtarët e familjes, duke i lehtësuar ata për veprimet e tyre në bankë.

Burimi i krijimit të arkëtimeve të kryera janë nga pagat dhe të ardhurat e familjarëve të saj. Në periudha të caktuara kohore, llogaria ka qenë e përbashkët me prindërit dhe motrën e saj.

c) Në shpjegimet e dhëna, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar përsëri se veprimet janë kryer në llogarinë e përbashkët bankare me familjarët e saj dhe kursimet e vendosura në këtë llogari janë kursime të përbashkëta familjare.

Trupi gjykues konstatoi se veprimet e kryera nga bashkëjetuesja e subjektit konsistojnë në depozitime, tërheqje, hapje dhe mbyllje depozitash, kredi të marra etj., për të cilat subjekti sqaroi se kanë qenë jo vetëm për efekt praktikiteti apo përfitimi nga kurset e këmbimit, por edhe për efekt të realizimit të targeteve të vendosura nga banka.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë matematikore rezultoi se shuma e depozitimeve dhe tërheqjeve brenda vitit pothuajse është e njëjtë, pra është e njëjta shumë që depozitohet, këmbëhet sipas kursit të volitshëm të kohës dhe më pas tërhiqet.

Duke iu referuar *statement*-it bankar, Komisionit i rezultoi se gjendja në bankë e bashkëjetueses së subjektit, në çdo fundvit ka qenë si në vijim.

Tabela nr. 9

Viti	Gjendja në bankë
2005	200,152
2006	20
2007	(48,862)

2008	13,436
2009	(34,764)
2010	830,658

Në kushte të tilla vërtetohet se diferenca mes depozitimeve dhe tërheqjeve është pothuajse e njëjtë, ndërsa balanca e rezultuar në bankë në çdo fundvit vjen si rezultat i kursimeve të bashkëshortes, për të cilat pas martese subjekti i ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike, kursimet e krijuara apo dhurimet që i janë bërë familjes së tij.

Trupi gjykues, pavarësisht deklarimeve konsistente të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave pretendohet për të ardhura të siguruara nga familjarët e bashkëjetueses së tij, në mungesë të dokumentacionit, vlerësoi të kryejë përlllogaritjet financiare lidhur me këto depozitime, vetëm me të ardhurat e bashkëjetueses.

Sa më sipër rezultoi se të ardhurat nga paga të bashkëjetueses për vitet 2001 – 2009 janë në shumën 8.913.723 lekë. Bashkëjetuesja e subjektit nuk rezultoi të ketë kryer asnjë lloj investimi, pra duket se ka pasur mundësi të kryejë këto depozitime. Komisioni nuk mund të identifikojë me saktësi se sa mund të ketë përfituar ajo apo familjarët e saj nga kurset e këmbimit dhe, në këto kushte, ky përfitim nuk është përfshirë në këto llogaritje.

Po ashtu, edhe mbi përlllogaritjet e kryera për të ardhurat e ligjshme të siguruara nga bashkëjetuesja përgjatë viteve 2001 – 2005, rezultoi se ato kanë qenë në shumën 3.167.411 lekë, çka tregon se kjo shumë është e mjaftueshme për të mbuluar edhe vlerën më të lartë të depozituar në një shumë të vetme, duke mos konstatuar problematika.

20. Komisioni⁷⁹ vlerësoi të shtrijë hetimin, si dhe të kryejë një analizë financiare lidhur me depozitimet e kryera nga bashkëjetuesja e subjektit në llogarinë e babait të subjektit të rivlerësimit.

20.1 Për këto depozitime, Komisioni e ka pyetur⁸⁰ subjektin, pasi rezultonte se bashkëjetuesja e tij, për periudhën 2004 – 2006, kishte depozituar në llogaritë bankare të babait të tij në “Tirana Bank” (ALL, USD, EURO) shumat totale:

- 1.905.068 lekë;
- 29.910 euro;
- 3.002,28 USD.

20.2 Subjekti, në përgjigje, ka sqaruar: *“R.R (B) ka vepruar me tagrin ‘depozitime në të tretë’. Nuk ka të drejta në llogaritë e tij, vetëm ka kryer depozitime për të lehtësuar veprimin bankar, për shkak të punës së saj (punonjëse banke). Burimi i krijimit të shumave të depozituara janë të ardhurat e babait tim dhe familjes së tij ndër vite. Duke qenë se këto veprime kanë qenë thjesht për të lehtësuar veprimet bankare të babait tim, pra nuk janë as hua dhe as dhurim, çmoj se nuk kam detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të këtyre shumave. Pavarësisht këtij fakti, gjatë hetimit administrativ unë kam depozituar dokumentacionin mbi të ardhurat e ligjshme të babait tim. Përveç këtyre dokumenteve (të pyetësorit nr. 2) bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe disa dokumente shpesh mbi të ardhurat e ligjshme të familjes së z. S.B”.*

⁷⁹Me vendimin e riçeljes.

⁸⁰Me pyetësorin nr.3, datë 2.11.2021.

20.3 Në mënyrë të përmbledhur, për secilin vit dhe secilën valutë, shumat totale të depozituara nga bashkëjetuesja në llogarinë e babait të subjektit, rezultuan si në vijim:

Tabela nr. 10

	2004	2005	2006
ALL	250,000	605,068	1,050,000
EUR		29,410 ⁸¹	500
USD		3,002	
TOTAL (në lekë)	250,000	4,519,195	1,111,852

20.4 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të shpjeguar e provuar bindshëm burimin e krijimit të këtyre likuiditeteve që depozitoheshin në mënyrë periodike nga bashkëjetuesja e tij, pasi ngriheshin dyshime për lidhje të subjektit me këto transaksione.

20.5 Në qëndrimin e tij, subjekti ka parashtuar se: *“Shtetasja R.R (B) ka vepruar me tagrin ‘depozitime në të tretë’. Ajo nuk ka të drejta në llogarinë e babait tim, por vetëm ka kryer depozitime për të lehtësuar veprimin bankar, për shkak të punës së saj (si punonjëse banke). Këto arkëtime nuk janë as hua, as dhurim. Burimi i krijimit të shumave të depozituara janë të ardhurat e babait tim dhe familjes së tij ndër vite”*.

Subjekti ka paraqitur/listuar⁸²dokumentacionin e punësimit të babait të tij dhe familjes për periudhën 1994 – 2005, duke i materializuar me paraqitjen e një analize financiare për të provuar burimin e ligjshëm të arkëtimeve të kryera për periudhën 2004 – 2006 në llogari të babait të tij, që sipas tij nuk ka asnjë *indicie* që këto transaksione (depozitime) të jenë pasuri e fshehur nga ana e tij.

20.6 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nga analiza e kryer rezulton qartësisht se me të ardhurat e realizuara, prindërit e tij kanë pasur mundësi për të kursyer shumën e 9.895.197 lekë, shumë e cila është më e madhe se arkëtimi i kryer në llogari të babait të tij, në total shuma 5.881.047 lekë në periudhën 2004 – 2006.

20.7 Në funksion të mbrojtjes së tij, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, Durrës, me datë 19.5.2022 të babait tij, ku ky i fundit deklaroi se: *“... shtetasja R.R ka bërë depozita në llogarinë time të ardhurat e mia, por nuk ka pasur asnjë të drejtë në këtë llogari. Këto veprime janë kryer nga ajo si drejtuese e një dege të ‘Tirana Bank’ mbi kërkesën time me qëllim lehtësimin e veprimeve bankare të mia, pasi, puna si ***, detyrimet si ish ***, krijimtaria artistike, lëvizjet e shpeshta jashtë Tiranës, por edhe radha në sportelet e bankës, jo në çdo rast më jepnin komoditetin për të qenë prezent në bankë”*.

Bashkëngjitur deklaratës ka dërguar kopertina të disa librave të botuar në atë periudhë, të cilat janë poezi, studime letrare, ese, kritika, parathënie etj.

⁸¹Me 14 transaksione, që totali përbën shumën 29.410 euro.

⁸²Vërtetim nga Kuvendi i Shqipërisë për periudhën 1994 – 1996; vërtetim nr.*** prot., datë 1.10.2021, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i ***, për periudhën 1.1.1997 – 28.2.2002; vërtetim nr.*** prot., datë 4.10.202, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tirana 1, pension pleqërie nga data 1.4.2002 e në vazhdim; vërtetim nr.***, datë 25.3.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,Drejtoria Rajonale Tatimore ***,pagesat e bëra sipas vitit 1996(janar - dhjetor 1996),viti 1997(janar – dhjetor 1997); kontrate qiraje nr.***,datë 28.5.1999, për periudhën 28.5.1999 – 31.12.1999, shuma 110.000 lekë/muaj; nxjerrje llogarie E.B nga “Tirana Bank”, vitet 2000 – 2005; nxjerrje llogarie E ose S.B nga Banka e Shqipërisë,për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2005; nxjerrje llogarie E.B nga Banka e Shqipërisë, për periudhën 1.1.2006 – 16.1.2015; vërtetim pagash e datës 1.11.2016, për Bledar Bejko, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Arsyetimi në raport me faktet e konstatuara dhe ligjin e zbatueshëm

20.8 Trupi gjykues, për këtë çështje, vlerëson se provat, rrethanat e konstatuara, dokumentacioni i depozituar, si dhe shpjegimet e subjektit duhen parë dhe konsideruar në harmoni me njëra-tjetrën.

Më konkretisht, u vërejt se dokumentacioni i depozituar nga subjekti, si gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës vërteton përfitimin e të ardhurave të ligjshme të familjes së tij, në një masë të konsiderueshme, çka arrin të mbulojë shumën e depozituar nga ana e bashkëjetueses së tij. Në këtë drejtim, trupi gjykues ka konstatuar se analiza financiare e familjes së origjinës së subjektit, e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, në çdo alternativë të mundshme, rezultojnë pozitive.

Nga ana tjetër vlen të evidentohet fakti se në asnjë rast nuk u konstatua ndonjë tërheqje apo veprim/transaksion tjetër nga bashkëjetuesja e subjektit në llogarinë e babait të tij, çka tregon se ajo nuk ka pasur asnjë të drejtë tjetër në llogarinë e tij, përveçse depozitimit. Po ashtu konstatohet se depozitimet e kryera përputhen me periudhat më impenjative të babait të subjektit si ***, konkretisht, shkurt, mars, qershor, shtator, periudhë kjo që korrespondon me sezon provimesh në universitet, hartim tezash, etj.

Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të këtyre transaksioneve.

21. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 27.4.2016, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitin 2007 kam blerë një automjet tip ‘***’, në Gjermani, të cilin e kam sjellë në Shqipëri. Por sqaroj se të gjitha shpenzimet i ka mbuluar shtetasi I.V, sepse automjeti ishte i destinuar për të. Automjeti ka hyrë nga *** dhe zhdoganimi është bërë nga ana ime sepse isha personi që e kisha blerë në Gjermani, pasi është bërë zhdoganimi është bërë edhe kontrata e shitjes me shtetasin I.V. Pra, në të gjithë këtë transaksion unë nuk kam pasur asnjë përfitim dhe nuk kam shpenzuar asnjë të ardhur pasi të gjitha veprimet janë kryer për interes të shtetasit I.V dhe normalisht të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga ai”.*

Subjekti ka depozituar:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.5.2007, ku ai deklaroi se ka marrë në datën 2.4.2007 nga z. I.V shumën 2.000.000 lekë, si vlerë për blerjen e një automjeti tip “****” në Gjermani. Me këtë deklaratë është dakord edhe z. I.V. Deklarata është firmosur nga të dy shtetasit;
- kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 11.5.2007, ku shtetasi Bledar Bejko i shtetasit I.V automjetin tip “****”, me targa ***, në vlerën 500.000 lekë.

21.1 Nga verifikimi i sistemit *TIMS*⁸³ konfirmohet fakti se subjekti i rivlerësimit ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë më 9.4.2007 nga pika kufitare Rinas dhe ka hyrë më 15.4.2007 nga pika kufitare *** me automjetin me targa ***.

21.2 Komisioni hetoi lidhur me këtë automjet dhe nga korrespondenca me DPSHTRR-në⁸⁴ i rezultoi se është zhdoganuar më 11.5.2007 dhe shuma e paguar në doganë për zhdoganimin e tij ka qenë në vlerën 458.052 lekë. Nga dokumentacioni i depozituar nga kjo drejtori, rezultoi se automjeti është blerë prej subjektit të rivlerësimit në Gjermani, më 13.4.2007, në vlerën 11.950

⁸³Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, nga Drejtoriae Përgjithshme e Policisë.

⁸⁴Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2021.

euro. Vlera totale e shpenzuar për këtë automjet (blerja + zhdoganimi) është 1.969.608 lekë (1.511.556 + 458.052).

21.3 Në analizë të fakteve të dala, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektivit pasi: (i) dukej se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes midis subjektivit të rivlerësimit dhe shtetasit I.V nuk përputhej me vlerën reale të shpenzuar për blerjen e automjetit në shtetin gjerman që, për rrjedhojë, dukej se pasqyronte një veprim fiktiv; (ii) dukej se shuma 2.000.000 lekë, dhënë nga shtetasi I.V, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.5.2007, për blerjen e këtij automjeti, e tejkalonte limitin e lejuar për t'u kaluar përtej territorit shqiptar, pa u deklaruar.

21.4 Subjekti ka parashtruar se, sikurse rezulton, ka dhënë deklarime në ILDKPKI sipas procesverbalit të mbajtur me këtë institucion, në datën 27 prill, duke shpjeguar se e ka blerë këtë automjet vetëm për të ndihmuar shokun e tij I.V dhe përveç mundimeve dhe kohës së shpenzuar nuk ka pasur asnjë përfitim. Automjetin ia ka këtij shtetasi sapo është kthyer nga Gjermania.

21.5 Subjekti ka parashtruar se: *“Siç rezulton nga dokumentacioni, automjeti është zhdoganuar në datën 11.5.2007 dhe shuma e paguar në doganë për zhdoganimin e tij ka qenë në vlerën 458.052 lekë. Automjeti është blerë nga unë në Gjermani, në datën 13.4.2007, në vlerën 11.950 euro. Vlera totale e shpenzuar për këtë mjet është ajo e konstatuar nga Komisioni (blerja + zhdoganimi) 1.969.608 lekë (1.511.556 + 458.052), pra afërsisht 2.000.000 lekë po t'i shtohen edhe shpenzimet e udhëtimit (nafta dhe taksa e rrugës). Kontrata e shitblerjes u përpilua përpara noterit ditën që u bë zhdoganimi, disa ditë më pas, pasi mjetin e solla në Shqipëri nga pika e kalimit kufitar ***. Në të njëjtin moment, te noteri u përpilua edhe deklarata noteriale, në të cilën z. I.V deklaroi se: ‘Për të blerë dhe sjellë automjetin nga Gjermania i kam dhënë z. Bledar Bejko shumën 2.000.000 lekë, shumë e cila ishte shpenzuar tërësisht prej tij për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit’.*

Shënimi i vlerës 500.000 lekë në kontratën e shitblerjes së këtij automjeti është lapsus i noterit dhe pakujdesi e jona për ta korrigjuar këtë shifër në momentin e nënshkrimit. Theksoj se vlera e automjetit së bashku me zhdoganimin ishte afërsisht 2.000.000 lekë. Kontrata dhe deklarata noteriale u përpiluan njëra pas tjetrës dhe ashtu si kontrata edhe deklarata noteriale janë akte publike. Pra, është e qartë jo vetëm nga deklarata noteriale, por edhe nga dokumentacioni i automjetit se kostoja e blerjes dhe zhdoganimit të automjetit ishte 2.000.000 lekë dhe në kushtet kur është përpiluar deklarata noteriale pranë noterit, si autoritet publik, vërtetohet tej çdo dyshimi se shuma 500.000 lekë në kontratë është gabim material. Pra, kjo vlerë duhet të jetë lapsus i ngelur nga një kontratë e mëparshme. Duke qenë se unë nuk kisha asnjë interes në këtë transaksion nuk kam qenë i vëmendshëm në leximin e kontratës së shitjes.

*Lidhur me konstatimin e Komisionit se shuma 2.000.000 lekë, dhënë nga shtetasi I.V, për blerjen e këtij automjeti, tejkalonte limitin e lejuar për t'u kaluar përtej territorit shqiptar, pa u deklaruar, kam shpjeguar se siç rezulton nga sistemi TIMS, kam udhëtuar së bashku me bashkëjetuesen, znj. R.R, më 9.4.2007, duke kaluar pikën e kalimit kufitar për në Gjermani, nga aeroporti i Rinasit dhe kemi hyrë të dy së bashku në datën 15.4.2007 nga pika kufitare ***. Shtetasi I.V më kishte dhënë shumën 2.000.000 lekë tek e cila përfshihej edhe vlera e zhdoganimit. Sa kujtoj, kemi marrë me vete secili shumën 7.000 euro, shumë e cila nuk kalon*

kufirin e deklarimit të përcaktuar në nenin 10, të ligjit nr. 8610, datë 17.5.2000, 'Për parandalimin e pastrimit të parave'⁸⁵ ndryshuar sipas ligjit nr. 9084, datë 19.6.2003''.

21.6 Subjekti ka vijuar të shpjegojë se *me sa kujton ai dhe bashkëshortja e tij kanë marrë me vete secili shumën rreth 7.000 euro*, shumë e cila nuk e kalon kufirin e deklarimit të përcaktuar në nenin 10, të ligjit nr. 8610, datë 17.5.2000, "Për parandalimin e pastrimit të parave", ndryshuar sipas ligjit nr. 9084, datë 19.6.2003. Siç rezulton nga dokumentacioni, vlerën e zhdoganimit e ka paguar subjekti nga pjesa e mbetur e shumës 2.000.000 lekë, një pjesë të së cilës gjatë kohës që ka qenë në Gjermani e ka ruajtur në banesën e tij. Subjekti ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.3.2022, të shtetasit I.V, në të cilën deklaroi edhe një herë faktet e ndodhura realisht në vitin 2007.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

21.7 Trupi gjykues, mbi konstatimet e rezultuara gjatë hetimit për këtë çështje, në raport me parashtrimet e subjektit në prapësime, por edhe në analizë të provave të depozituara në funksion të barrës së provës, konstatoi si vijon:

Nga aktet konfirmohet se automjeti është blerë në shumën 11.950 euro dhe mbi këtë vlerë është kryer edhe zhdoganimi i tij. Ky automjet nuk është përdorur prej subjektit pasi rezultoi që në të njëjtën kohë me hyrjen e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë është kryer edhe zhdoganimi dhe është realizuar kontrata e shitjes.

Nga verifikimi i sistemit *TIMS* u konfirmua fakti se subjekti ka udhëtuar për në shtetin gjerman së bashku me bashkëshorten, në atë kohë bashkëjetuesja e tij, çka tregon se deklarimi i subjektit për mundësinë e ndarjes së shumës mes tyre qëndron edhe në mungesë të ndonjë të dhëne ndryshe, vlerësohet gjithashtu bindës.

Në konkluzion, trupi gjykues, nën çmuarjen e fakteve të tilla se: (i) nga hetimi administrativ nuk rezultoi që subjekti të ketë përdorur apo përfiturar të ardhura nga shitja e këtij automjeti; (ii) vlera e blerjes së automjetit, së bashku me të gjitha taksat dhe detyrimet doganore mbi çmimin e blerjes së tij, përbëjnë shumën totale të dhëna nga shtetasi I.V sipas deklaratës noteriale; (iii) konfirmohet fakti se i njëjti noter ka hartuar dhe nënshkruar aktet noteriale, përfshirë edhe deklaratën për dhënien e shumës 2.000.000 lekë subjektit për blerjen e automjetit, kontratën e shitjes në favor të shtetasit I.V për shumën 500.000 lekë dhe se kjo vlerë e shënuar në kontratën e shitjes duket se nuk ka ndikuar në shmangien e ndonjë takse apo detyrimi doganor, pasi DPSHTRR-ja ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të shtetasit I.V dhe njëkohësisht deklarata e këtij të fundit konfirmon marrëveshjet e bëra dhe në asnjë rast nuk rezulton të kenë lindur pretendime mes palëve, konkludon se në gjendjen faktike të kësaj çështjeje përjashtohet çdo rrethanë përfituese nga subjekti si shmangia nga ndonjë detyrim tatimor, për sa kohë pronari real i këtij automjeti është shtetasi I.V. Në të tilla kushte nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të passillnin një vlerësim ndryshe për penalizimin e subjektit.

22. Komisioni hetoi gjithashtu edhe në lidhje me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard (nr.1) për përdorimin e automjetit me targa belge. Në analizë të shpjegimeve të subjektit⁸⁶, dokumentacionit të depozituar prej tij⁸⁷, si dhe dokumentacionit të administruar

⁸⁵Në të cilin parashikohet se: "Individët, rezidentë ose jorezidentë, kur hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë shumën në të holla çdo lloj çeku bankar, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1.000.000 (një milion) lekë ose kundërvlera e kësaj shume në monedha të tjera".

⁸⁶Me pyetësorin nr. 2, me të cilin ka depozituar edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 17.9.2021, marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe me pyetësorin nr. 6, datë 14.1.2022.

nga agjencitë ligjzbatuese⁸⁸, Komisioni vërejtë se provat e administruara nuk nxorën në pah ndonjë të dhënë që mund të cenonte ndonjë nga komponentët e kriterëve të vlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

25.Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *papërshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko, duke konkluduar, ndër të tjera, se *në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.*

26.Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Bledar S Bejko.

Hetimi i kryer nga Komisioni

27.Komisioni, pasi u njoh me raportin e DSIK-së, kërkoi dhe administroi fashikujt penalë të hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Verifikimi dhe analizimi i këtyre çështjeve është parashtruar në këtë vendimmarrje në kontrollin e kriterit të vlerësimit profesional nën titullin “Gjetje të tjera”.

28.Subjekti, në parashtrimet e tij mbi konstatimin e raportit të DSIK-së, ka shpjeguar se ky i fundit ka arritur në konkluzion jologjik dhe jo të drejtë dhe se ndryshimi i konstatimit nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri përvijimin e ushtrimit të detyrës është i pabazuar.

29.Konkludimi për këtë kriter lidhet me veprimtarinë e subjektit në çështjet e integruara te kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale, duke përfshirë në analizë çdo të dhënë të veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit në hetimin e secilës çështje.

30.Trupi gjykues, lidhur me këtë kriter, ka vlerësuar se kontrolli për figurën, sipas pikave 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, bazohet në dy komponentë komplementarë të njeri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të

⁸⁷Informacionin e dhënë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr.*** prot., datë 19.1.2022, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën datë 17.1.2022 dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2022.

⁸⁸Përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2021, nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2022, si dhe nga SPAK-u.

papërshtatshëm, si dhe në elementin formal, që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklaratimit.

31.Në këtë drejtim, trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer nga Komisioni: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave në këtë deklaratë nga subjekti i rivlerësimit; (ii) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë përfshirë në veprimtari të paligjshme apo të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (iii) pas analizimit të çështjes së trajtuar në drejtim të aspektit profesional si më poshtë arsyetohet, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime që bien në kundërshtim me ligjin procedural dhe material; (iv) bazuar në hetimin e Komisionit, por edhe në faktin se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka kryer hetim të thelluar mbi këto dyshime ndaj veprimtarisë së punës së subjektit ku nuk u provua⁸⁹ fakti i kryerjes së veprës penale “korrupsion” –arrin në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

32.Nën këto konstatime, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, konfirmohet *përshatshmëria* për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

33.Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve⁹⁰ ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve⁹¹ penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe

⁸⁹Për këtë çështje, organi i akuzës ka theksuar pikërisht faktin se në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka dërguar çështjen për gjykim dhe se nga informacioni paraprak për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme shtetasit e dyshuar nuk kanë pasur asnjë komunikim telefonik me njëri tjetrin, provuar kjo nga tabulatet telefonike.

⁹⁰1. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.***, me të pandehur B.P dhe F.S, akuzuar për kryerjen e veprës penale “keqtrajtimit të miturit kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 124/b/2-25 i Kodit Penal; 2. kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.***, me të pandehur L.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal dhe me të pandehur E.D, akuzuar për kryerjen e veprës penale “ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal; 3. kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.***, me të pandehur O.P, akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal dhe me të pandehur M.M, akuzuar për kryerjen e veprës penale “deklaratë e rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal.

⁹¹Dosja 1/kallëzimi penal nr.***, datë regjistrimi 29.2.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.Objekti i shortit: dokumenti ligjor - *vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”*, për kallëzimin penal nr.***.

Dosja2/procedimi penal nr.***, datë regjistrimi 27.1.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.Objekti i shortit: dokumenti ligjor - *vendim “Për pushimin e procedimit penal”*, datë 24.2.2016.

Dosja 3/procedimi penal nr.***, datë regjistrimi 27.1.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.Objekti i shortit: dokumenti ligjor - *vendim “Për pushimin e procedimit penal”*, datë 17.6.2015, për procedimin penal nr.***.

rastësor; si dhe të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit të administruar që i përket tri dokumenteve të përzgjedhura dhe pesë dosjeve, mbi të cilin është prodhuar raporti i vlerësimit profesional, në tërësi nuk evidentoi problematika që ndikojnë në këtë kriter.

34.Në lidhje me të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime, sipas raportit të KLP-së, nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme ka rezultuar seprokurori Bledar Bejko ka një masë disiplinore.

34.1 Nga verifikimi në arshivën e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se me urdhrin nr.***, datë 26.7.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorit Bledar Bejko i është vendosur masa disiplinore “vërejte”. Masa është vendosur duke u bazuar nga informacioni i Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit. Nga kontrolli janë evidentuar shkelje të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit Bledar Bejko dhe, konkretisht, në hetimin dhe gjykimin e 11 procedimeve penale.

34.2 Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2019, ka bërë me dije se për shtetasin Bledar Bejko, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton të jetë regjistruar kallëzim penal, përkatësisht, nr.***, viti 2008, për të cilin është vendosur mosfillim si procedim penal në datën 27.3.2008.

Sa më lart, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar kallëzimin penal mbi bazën e akteve, përcjellë për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Konkretisht, kallëzuesi B.G është proceduar nga Prokuroria e Rrethit Fier për veprën penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal, pasi në banesën e tij është gjetur dhe sekuestruar një sasi bimësh narkotike. Pas veprimeve hetimore, prokurori i çështjes, në këtë rast Bledar Bejko, ka vendosur dërgimin në gjyq me të pandehur shtetasin B.G. Veprimet procedurale të prokurorit, të cilat janë finalizuar me dërgimin në gjyq kanë qenë objekt i kallëzimit të shtetasit B.G, ku ky i fundit pretendon se prokurori ka falsifikuar disa akte hetimore, ka urdhëruar ndalimin e tij në mënyrë të paligjshme, gjithashtu, ka pretendime dhe sa i përket provueshmërisë dhe kualifikimit të veprës penale që i është atribuar. Në funksion të kallëzimit të shtetasit B.G, prokurori ka kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se për sa kohë çështja ka qenë objekt gjykimi (procedimi penal në ngarkim të shtetasit B.G është dërguar për gjykim) pretendimet lidhur me pavlefshmërinë e akteve nga pikëpamja formale - juridike i drejtohen gjykatës, e cila ka në shqyrtim çështjen. Në këto rrethana, në datën

Dosja 4/procedimi penal nr.***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 6.5.2016, për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit L.G. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr.***, të vitit 2016”, datë 8.5.2016, hartuar nga prokurori Bledar Bejko, subjekt rivlerësimi.

Dosja 5/procedimi penal nr.***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 23.6.2016, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit F.S. Objekti i shortit: dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr.*** të vitit 2016”, hartuar nga prokurori Bledar Bejko, subjekt rivlerësimi.

27.3.2008, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, bazuar në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

34.3 Mbi bazën e kërkesës për informacion nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2020, është përcjellë praktika që ka të bëjë me kallëzimin penal, bërë ndaj shtetasit Bledar Bejko, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Durrës.

Për sa më lart u konstatua se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, viti 2017, pas materialit kallëzues përcjellë për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme. Kallëzimi në fjalë është depozituar nga shtetasja V.A, e cila pretendon se nga prokurori Bledar Bejko është konsumuar vepra penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ë i Kodit Penal.

Shtetasja V.A në kallëzimin e saj evidenton se në datën 11.4.2017 bashkëshorti i saj ka gjetur vdekjen si pasojë e vrasjes në bashkëpunim nga tre persona. Çështja në fjalë iu ngarkua prokurorit Bledar Bejko. Ankuesja pretendon se si pasojë e hetimeve të paplota dhe joobjektive nga ana e prokurorit, dy prej personave janë lënë të lirë pasi është vendosur pushimi i hetimit, ndërsa të tretit i është ndryshuar kualifikimi i veprës penale. Ndër të tjera, shtetasja pretendon se prokurori Bledar Bejko dhe gjyqtari i çështjes kanë favorizuar autorët e ngjarjes duke u lehtësuar akuzat, si dhe duke lënë të lirë dy prej tyre. Shtetasja pretendon në kallëzim se prokurori dhe gjyqtari i çështjes kundrejt veprimeve korruptive kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm, këtë e mbështet në faktin se “i gjithë Durrësi flet se është hedhur lekë i madh me qëllim që autorët t’i shpëtojnë drejtësisë”. Në funksion të kallëzimit të shtetasës V.A, prokurori ka kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Prokurori argumenton se Prokuroria për Krime të Rënda nuk ka juridiksionin dhe kompetencën që të verifikojë dhe kontrollojë vendimmarrjen e prokurorit për një çështje penale konkrete. Këtë kompetencë, sipas kuadrit ligjor, e ka gjykata e cila kontrollon vendimmarrjen e prokurorit e nëse ekzistojnë kushtet shfuqizon vendimin e pushimit (në këtë rast të njërit prej të dyshuarve) apo sa dhe i përket kualifikimit ligjor për akuzën. Gjithashtu, prokurori vijon se në mungesën e *indicieve* të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, që minimalisht do të krijonin të dhëna të mjaftueshme se janë konsumuar elementët e veprës penale, organi procedues nuk mund të kryejë veprime të tjera hetimore. Në përfundim, ndjekja penale për këtë kallëzim penal nuk mundet të fillojë pasi pretendimet e paraqitura në kallëzim nuk përmbajnë elementët e veprës penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ë i Kodit Penal.

Në këto rrethana, në datën 7.12.2017 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, bazuar në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale.

34.4 Mbi bazën e kërkesës për informacion Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. ***, prot., datë 1.12.2020, bën me dije se ndaj shtetasit Bledar Bejko nuk rezultoi të jetë regjistruar procedim penal, konfirmuar kjo nga verifikimi i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe SPAK-ut. Në vijim të informacionit është përcjellë praktika (në formë elektronike) që ka të bëjë me kallëzimin penal, bërë ndaj shtetasit Bledar Bejko, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Durrës, për të cilin është vendosur mosfillimi si procedim penal. Materiali ka të bëjë me kallëzimin nr. ***, viti 2017, sa më lartpërshkruar.

34.5 Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën viti 2006 – 2019, rezulton se ka 6 ankesa sa vijon:

34.5.1 Praktika nr. ***, regjistruar pas ankesës së shtetasit I.G drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj prokurorit Bledar Bejko

Shtetasi I.G, babai i të dëmtuarit nga vepra penale “plagosje e lehtë me dashje”, ka paraqitur ankesë, duke pretenduar se prokurori Bledar Bejko, në mënyrë të qëllimtë, ka zvarritur procesin gjyqësor duke mos u paraqitur në 5 seanca rresht. Ankuesi pretendon se mosparaqitja e prokurorit ka sjellë si pasojë zvarritjen e procesit gjyqësor. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga sa vërehet pas kontrollit të ushtruar nga kjo drejtori, rezultoi se prokurori Bledar Bejko ka munguar vetëm në dy seanca gjyqësore pasi ka qenë i angazhuar në gjykime të tjera.

34.5.2 Praktika nr. ***, regjistruar pas ankesës së shtetasit N.P drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ndaj prokurorit Bledar Bejko

Shtetasi N.P ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Ankuesi pretendon se nga ana e prokurorit nuk janë kryer të plota veprimet hetimore në lidhje me kallëzimin e bërë prej tij. Për pasojë, vendimmarrja e prokurorit ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe, në këto kushte, duhej shfuqizuar. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit, Ndjekjes Penale, në Prokurorinë e Përgjithshme. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2012, ankuesit N.P i është kthyer përgjigje se pas kontrollit të ushtruar nga drejtoria është arritur në konkluzionin se nuk ka shkaqe ligjore për shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer nga ana e zyrës përkatëse pranë Prokurorisë së Rrethit Fier, ka rezultuar se shtetasi N.P nuk kishte ushtruar ankim kundër këtij vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

34.5.3 Praktika nr.***, regjistruar pas ankesës së shtetasës R.LL drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ndaj prokurorit Bledar Bejko

Shtetasja R.LL, me cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, ka paraqitur një kërkesë me objekt zëvendësimin e prokurorit Bledar Bejko me një prokuror tjetër. Konkretisht, ndaj shtetasës R.LL Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier kishte regjistruar një procedim penal për veprën penale “fyerja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal. Me drejtimin e hetimit në këtë procedim ishte ngarkuar prokurori Bledar Bejko. Shtetasja R.LL ka pretenduar se prokurori Bledar Bejko nuk mund të drejtonte hetimin ku kallëzues ishte një prokuror i Prokurorisë së Rrethit Vlorë (S.D), pasi kjo prokurori kishte në proces hetimi një ngjarje ku i përfshirë ishte edhe prokurori Bledar Bejko. Në këto rrethana, shtetasja R.LL, duke pretenduar se ekzistonin elementët e një konflikti interesi, është drejtuar me kërkesën sa më lart u përmend. Nga praktika e administruar vërehet se kërkesa e shtetasës nuk është pranuar, pasi hetimet janë drejtuar nga prokurori Bledar Bejko dhe, në përfundim të tyre, ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, viti 2011, në ngarkim të shtetasës R.LL. Sa i përket kërkesës drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme konstatohet se ajo është arshivuar.

34.5.4 Praktika nr. ***, regjistruar pas ankesës së shtetasit N.M drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj prokurorit Bledar Bejko

Shtetasi N.M evidenton në ankesën e tij se në datën 20.7.2015, në qytetin e Durrësit, pas një aksidenti rrugor ka pësuar dëmtime serioze bashkëshortja e tij M.M. Me drejtimin e hetimit të kësaj ngjarjeje ka qenë ngarkuar prokurori Bledar Bejko. Pretendimi i ankuesit konsiston sa i përket zvarritjes së hetimeve dhe mbi mënyrën se si ka vepruar proceduralisht prokurori.

Ankesa në fjalë, pasi është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 18.12.2015, i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Procedimi objekt ka qenë një prej çështjeve të zgjedhura⁹² nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Bledar Bejko. Nga sa rezulton, prokurori ka vendosur dërgimin e kësaj çështjeje për t'u gjykuar me të pandehur O.P, akuzuar për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/2 dhe M.M, akuzuar për veprën penale “deklarim i rremë para oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal. Të pandehurit janë dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

34.5.5 Praktika nr. ***, regjistruar pas ankesës së shtetasit A.SH, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj prokurorit Bledar Bejko.

Shtetasi A.SH, në vitin 2017, ka bërë kallëzim penal ndaj disa shtetasve me funksione publike duke pretenduar se prej tyre ishin konsumuar disa vepra penale. Me verifikimin e rrethanave të kallëzimit ka qenë ngarkuar prokurori Bledar Bejko. Pas veprimeve hetimore prokurori ka disponuar me vendim mosfillimi, i cili është lënë në fuqi nga gjykata e shkallës së parë, por është prishur nga ajo e apelit. Më tej, pasi është regjistruar si procedim penal është pushuar nga prokurori Bledar Bejko, vendimi i të cilit është prishur nga gjykata. Shtetasi A.SH në ankesën e tij, ndër të tjera, pretendon se nga prokurori nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për të vënë para përgjegjësisë penale personat e kallëzuar, si dhe ka mbajtur qëndrim joetik ndaj kallëzuesit dhe, në këto rrethana, ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit Bledar Bejko me një prokuror tjetër. Këto pretendime, sa konfirmon shtetasi, i ka ngritur edhe më parë, por nuk i janë pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë në atë kohë. Ankesa në fjalë është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Prokurorinë e Përgjithshme.

34.5.6 Praktika nr. ***, regjistruar pas ankesës së shtetasës V.A, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj prokurorit Bledar Bejko.

Edhe në këtë praktikë ripërsëritet ankesa e shtetasës V.A ndaj subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar edhe për mosnjohje të vendimit të pushimit.

Në ankesën e saj shtetasja evidenton faktin se çështja ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit. Ankesa në fjalë është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 30.3.2018, drejtuar shtetasës, e ka bërë me dije se në kushtet kur çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe praktikën e konsoliduar gjyqësore, është kjo gjykatë që do të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve kryer nga gjykatat. Në lidhje me pretendimet për shpërdorim detyre apo falsifikim që shtetasja ka pretenduar në drejtim të veprimtarisë së prokurorit Bledar Bejko, e orientojnë shtetasen për t'i paraqitur me shkrim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁹²kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, me të pandehur O.P.

34.6 Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë administruar të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2. 2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve” dhe, konkretisht, për vitet 2012 – 2014 është vlerësuar “mirë” dhe për vitin 2016 “shumë mirë”.

Analiza e gjetjeve⁹³

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) burimet arkivore të sektorit të protokoll arkivit, në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Bledar Bejko, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Bledar Bejko për vitet 2013 dhe 2014, (viti 2015 nuk rezulton të jetë kryer) të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit është vlerësuar “mirë” ndërsa në vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsytimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8 tetor 2013 - dhjetor 2013 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe prej dhjetorit 2013 deri më 8 tetor 2016 detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga të dhënat statistikore rezulton se prokurori Bledar Bejko, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 675 materiale. Kjo dokumentohet me tabelat statistikore të vëna në dispozicion

⁹³Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

nga Zyra e Regjistrisë, si dhe me vërtetimin nr. *** prot., datë 20.11.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikën 2 dhe 2.1 të urdhrës nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë. Subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve⁹⁴, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Bledar Bejko, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

⁹⁴Konkretisht, kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që i korrespondon dosjeve 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht: dosja nr.1-materiali kallëzues nr.***, regjistruar si kallëzim në datën 29.2.2016 dhe mosfilluar në datën 8.3.2016, kohëzgjatja 8 ditë; dosja nr. 2 - procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 27.1.2015, pushuar në datën 24.2.2016, kohëzgjatja 1 vit e 27 ditë; dosja nr.3 - procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 27.1.2015, pushuar në datën 17.6.2015, kohëzgjatja 4 muaj e 20 ditë; dosja nr.4 – procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 6.5.2016, dërguar për gjykim në datën 7.5.2016; dosja nr.5-procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 23.6.2014, dërguar për gjykim në datën 30.6.2014, kohëzgjatja 7 ditë.

c) *Paanësia*

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Bledar Bejko. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) *Aftësitë e komunikimit*

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti Bledar Bejko rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

C/I. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

35. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja mbi të cilin edhe është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt, ka konstatuar si vijon:

a. Në tri dokumentet ligjore të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e shortuara nuk u konstatuan problematika, të cilat ndikojnë në rivlerësimin e aftësive profesionale.

b. Sa i përket trajtimit të ankesave, duke iu referuar përmbajtjes së praktikës nr. ***, viti 2018 (referuar në pikën 34.5.5), u vërejt se shtetasi A.SH ka depozituar edhe denoncim⁹⁵ në Komision, po me të njëjtit objekt ankimi-

Për këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit **i.** të shpjegojë lidhur me pretendimet e shtetasit A.SH në çështjen e kallëzuar prej tij, sa i përket moskryerjes së disa veprimeve hetimore ku më konkretisht⁹⁶, prej tij pretendohet se nuk janë marrë në administrim dokumente origjinale lidhur me çështjen dhe nuk është bërë ballafaqim palësh dhe, për pasojë, çështja është kthyer e rikthyer për hetime të tjera. Gjithashtu, ai ripërsërit se prokuroria nuk ka administruar formularin origjinal të performancës, por një dokument të rifalsifikuar. Njëkohësisht, subjektit i është kërkuar të vërtetojë shpjegimet e tij me dokumentacion justifikues nga fashikulli penal.

b/i. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kërkimit të Komisionit, ka shpjeguar se shtetasi A.SH ka bërë kallëzim ndaj drejtuesve të OSHEE-së, pasi e kanë larguar nga puna, sipas tij pa të drejtë. Nga aktet rezultoi se më 1.11.2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës është depozituar

⁹⁵Denoncim nr.*** prot., datë 29.1.2019.

⁹⁶Sikurse shtetasi Sh referon edhe në denoncimin e tij të trajtuar në rubrikën e denoncimeve.

kallëzimi i shtetasit A.SH, regjistruar me nr. *** për elemente të dyshuar të veprës penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Subjekti ka qartësuar mbi profesionin e këtij shtetasi si *** i punësuar në Degën Rajonale të OSHEE-së *** si ***, si dhe mbi kallëzimin e bërë prej tij ku pretendohet se drejtuesit e OSHEE-së po përgatisnin largimin e tij nga puna, gjithnjësisht në një procedurë në kundërshtim me ligjin.

Subjekti ka sqaruar se sipas kallëzuesit kjo procedurë mbështetej në disa akte, të supozuara prej tij si fiktive lidhur me plotësimin e një formulari mbi vlerësimin e performancës së tij në punë, dokument i cili nuk është plotësuar prej tij, pasi sipas rregullores së funksionimit të OSHEE-së, plotësimi bëhet në prani të drejtuesit dhe kallëzuesi nuk e ka një të tillë. Subjekti ka sqaruar se kallëzuesi ka pranuar se më 26.9.2017 nga zyra e burimeve njerëzore i është kërkuar plotësimi i këtij formulari, por ai ka refuzuar ta plotësojë, duke argumentuar se ky formular duhej bërë më përpara, procedurë e cila përfundon sipas tij në dhjetëditëshin e parë të vitit të ri. Subjekti ka vijuar të sqarojë mbi pretendimet e kallëzuesit se ai në datën 27.9.2017 ishte paraqitur në zyrat qendrore në Tiranë, ku mëson se formulari ishte dërguar aty i paplotësuar dhe njoftohet për nisjen e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës aty me argumentimin: *“Performancë e ulët gjatë ushtrimit të detyrave funksionale, e cila nuk përmbush dhe bie ndesh me objektivat e shoqërisë”*. Ka pasqyruar pretendimet e kallëzuesit për mënyrën e gabuar dhe tendencioze të ndjekur nga drejtuesit e shoqërisë ku ushtronte detyrën me qëllim ndërprerjen e marrëdhënies së punës në kundërshtim me ligjin. Ka cituar se, *pasi është njohur me këtë material kallëzues kavendosur mosfillimin e procedimit penal me argumentin se faktet e parashtruara nuk përbejnë vepër penale*. Ka konfirmuar se kundër vendimit është ushtruar ankim nga kallëzuesi dhe gjykata e shkallës së Parë Durrës e ka rrëzuar kërkesën e tij si të pabazuar.

Më tej ka konfirmuar se ky vendim është ankuar nga shtetasi A.SH dhe me vendimin nr. *** Gjykata e Apelit Durrës ka prishur vendimin e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka kthyer dosjen për plotësim hetimesh.

Subjekti ka shpjeguar se pas regjistrimit janë kryer detyrat e lëna dhe konkretisht janë pyetur persona, është bërë këqyrje dhe marrje dokumentacioni, etj. Dosja është dërguar përsëri me kërkesën për pushim, por është rrëzuar nga gjykata duke lënë detyra të tjera. Mbi pretendimin e kallëzuesit është kryer ekspertim shkrimi dhe nënshkrimi duke marrë firma dhe modele eksperimentale shtetasish. Nga aktekspertimi nuk rezulton të kishte ndërhyrje falsifikimi, siç pretendohet nga ky shtetas. Në kushtet që detyrat ishin realizuar, është përsëritur kërkesa për pushim të çështjes penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 26.10.2020, ka pranuar kërkesën për pushim të çështjes penale. Ky vendim është ankuar nga shtetasi A.SH. Vendimi i gjykatës është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, ku gjykata vlerëson se *veprimet hetimore të prokurorit të urdhëruara nga gjykata e shkallës së parë sa herë prokurori e ka dërguar për pushim aq herë është refuzuar, këto urdhërime të gjykatës, kanë qenë të pakuptimta, të paaftha... është e paqartë dhe e pakuptimtë se çfarë ka ndryshuar në këtë procedim nga viti 2018 deri në fund të fitit 2020... gjykata vlerëson se që nga momenti i verifikimeve të prokurorit nga aktet e fashikullit të hetimit ka qenë e qartë se shkeljet e ligjit nuk kalonin shkeljet e dispozitave të Kodit të Punës. Për rrjedhojë, pjesa tjetër e hetimit të detyruar për prokurorin vetëm sa ka zvarritur hetimin dhe nuk ka qenë aspak produktive në mënyrën se si është ushtruar ndjekja penale*. Subjekti ka depozituar vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për sa më sipër, subjekti është shprehur: *“Vlerësoj se bazuar në vendimin përfundimtar të Gjykatës së Apelit, vendimmarrjet e mia në lidhje me këtë material kallëzues kanë qenë*

gjithmonë të drejta bazuar në aktet e administruara, bazuar në legjislacionin penal dhe procedural penal. Pavarësisht bindjes sime kam zbatuar gjithmonë vendimin e gjykatës dhe kam bazuar vendimmarrjen time në rezultatet e veprimeve të kryera”.

b/ii. Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, fakteve e rrethanave të dala përgjatë trajtimit të çështjes, vërejtë se hetimi penal i referohet një çështjeje civile me objekt marrëdhënie punësimi. Nga aktet e administruara vërehet se subjekti ka këmbëngulur në veprimet e tij duke e trajtuar çështjen jashtë kontekstit penal, për të cilën gjykata ka ndarë mendim ndryshe duke e kthyer dhe lënë detyra. Trupi gjykues vlerëson veprimet e ndërmarra nga subjekti në mënyrë të njëpasnjëshme, ashtu sikundër i ka adresuar gjykata, pavarësisht bindjes dhe logjikës së tij të përdorur në hetimin e rastit. Nga ana tjetër, në proporcionalitet të plotë mes veprimeve të subjektit, vendimmarrjeve të gjykatës për vijimin e hetimeve merr peshë dhe duket se mbështet subjektin në veprimtarinë e punës së tij në çështjen në fjalë, pikërisht, arsyetimi i Gjykatës së Apelit Durrës në vendimmarrjen⁹⁷ e saj ku shprehet: “... se veprimet hetimore të prokurorit të urdhëruara nga gjykata e shkallës së parë sa herë prokurori e ka dërguar për pushim aq herë është refuzuar, këto urdhërime të gjykatës, kanë qenë të pakuptimta, të paaftha ... është e paqartë dhe e pakuptimtë se çfarë ka ndryshuar në këtë procedim nga viti 2018 deri në fund të fitit 2020 ... gjykata vlerëson se që nga momenti i verifikimeve të prokurorit nga aktet e fashikullit të hetimit ka qenë e qartë se shkeljet e ligjit nuk kalonin shkeljet e dispozitave të Kodit të Punës... Për rrjedhojë, pjesa tjetër e hetimit të detyruar për prokurorin vetëm sa ka zvarritur hetimin dhe nuk ka qenë aspak produktive në mënyrën se si është ushtruar ndjekja penale”. Kontrolli i vendimmarrjeve nga një gjykatë më e lartë, në këtë rast duket të ketë qenë më i ashpër në drejtim të paraqitjes së argumenteve në favor të punës së subjektit, çka tregon se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk konkludohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të tij.

c. Sa i përket trajtimit të praktikës nr. ***, viti 2017, përshkruar më sipër në rubrikën e trajtimit të ankesave në kuadër të vlerësimit profesional.

Komisioni e hetoi dhe e trajtoi gjerësisht këtë çështje në kuadër të vlerësimit të kontrollit të figurës, nga ku u vërejt se çështja e shpërdorimit të detyrës, pretenduar nga ankuesja V.A, ndaj subjektit, nën pretendimin se nga ana e këtij të fundit nuk ishin kryer veprimet hetimore dhe se ishin falsifikuar dokumentet, është ezauruar gjyqësisht me vendim mosfillimi. Me administrimin e fashikullit penal⁹⁸ që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 12.4.2017 (arsyetuar në vijim nën titullin *Gjetje të tjera*) u konstatua se çështja penale në ngarkim të shtetasve E ka ndjekur rrugët gjyqësore dhe, për pasojë, janë gjykatat, institucionet që kontrollojnë dhe ligjërojnë vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

ç. Në lidhje me praktikën nr. ***, viti 2011 (renditur më sipër në pikën 34.5.3), regjistruar pas ankesës së shtetasve R.LL, Komisioni vlerësoi të administrojë⁹⁹ dosjen që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, ndaj kësaj shtetaseje, akuzuar për “fyerje të gjyqtarit”, për të qartësuar ndër të tjera pretendimet e shtruara, por edhe statusin e kërkesës së dërguar për gjykim nga subjekti, pas kryerjes së hetimeve të çështjes, etj.

Nga aktet e administruara rezultoi si vijon:

⁹⁷Nr.***.

⁹⁸Ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁹⁹Përcjellë me shkresën nr.*** prot., datë 15.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Shtetasja R.LL është akuzuar nga prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, z. S.D, për “fyerje të gjyqtarit”, sipas nenit 318 të Kodit Penal. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se kjo shtetase ka fyer në telefonin e tij, prokurorin që po ndiqte hetimet e bashkëshortit të saj. Ofezat janë dëgjuar gjithashtu nga drejtuesi i prokurorisë. Pas hetimit të kryer nga subjekti për këtë shtetase, këqyrjes së telefonatave të bëra, ka rezultuar e provuar fyerja për shkak të detyrës dhe, për këtë shkak, kjo kundërvajtje administrative është dërguar për gjykim. Në gjykimin e çështjes, prokurori ka hequr dorë nga ankimi dhe, për këtë shkak, çështja është pushuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 24.10.2012.

Gjithashtu, Komisioni administroi¹⁰⁰ dosjen që i përket procedimit penal, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi pretendohet nga shtetasja R.LL se në këtë prokurori po hetohej prokurori Bledar Bejko dhe se ky i fundit kishte konflikt interesi në hetimin e kësaj shtetaseje, pasi kjo ishte akuzuar nga një prokuror i Vlorës.

Nga aktet e administruara rezultoi:

Procedimi penal nr. *** është regjistruar në ngarkim të shtetasit E.T, akuzuar për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1/2 i Kodit Penal.

Çështja është vënë në lëvizje nga shtetasi D.S, i cili ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale në ngarkim të këtij shtetasi me profesion ***, si dhe të shtetasit P.D, *** në Komisariatin e Policisë ***, për marrjen e një sasive parash për nxjerrjen e tij nga paraburgimi.

Shtetasi S ka pretenduar se duke qenë i pafajshëm paratë janë marrë te familjarët e tij duke i mashtruar.

Në kërkesën e organit të akuzës, bërë nga prokurori M.S, kjo çështje është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në ngarkim të shtetasit E.T për akuzën e lartpërmendur, pasi nga përgjimet e kryera ka rezultuar e provuar se është marrë shuma e kërkuar për të nxjerrë shtetasin D.S nga paraburgimi.

Trupi gjykues, në analizë dhe vlerësim të provave të administruara, nuk konkludoi në *indicie* për ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit në hetimin e shtetases R.LL, për sa kohë çështja e hetuar në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të shtetasit E.T, ku ka qenë përfshirë edhe subjekti nuk është hetuar nga prokurori S.D, i cili kishte kallëzuar shtetasen R.LL.

d. Në tërësi, nga njohja dhe studimi i raportit të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, përfshirë analizën e të gjithë komponentëve duket se nuk vërehen problematika. Po ashtu, në tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe në pesë dosjet e shortuara, rezultoi përgjithësisht se palët nuk kanë ushtruar ankime ndaj vendimeve të subjektit. Vendimet kanë qenë të mirëstrukturuara në formë dhe përmbajtje.

Gjetje të tjera

dh. Komisioni administroi fashikullin penal¹⁰¹ që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 12.4.2017, në ngarkim të të pandehurit K.K, akuzuar për veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal. Nga aktet e administruara rezultoi si vijon:

¹⁰⁰Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁰¹Ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, por edhe denoncimin e përsëritur të shtetases A, me nr. *** prot., datë 7.12.2017, përsëritur me nr. *** prot., datë 18.1.2018, dhe sërish përsëritur me nr. *** prot., datë 26.3.2018.

Me kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. *** dhe vendimin datë 11.7.2017, për dërgimin e çështjes në gjyq, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i kërkuar, bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, gjykimin e këtij të pandehuri.

Me urdhrin datë 12.4.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “vrasje e kryer me dashje dhe në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 76-25 të Kodit Penal, në emër të shtetasve K dhe K.E.

Në datën 12.4.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (OPGJ i seksionit për hetimin e krimeve të rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës) ka bërë referimin e veprës penale.

- *Mbi referimin¹⁰² e OPGJ-së në ngjarjen e ndodhur dhe veprimet që janë kryer*

Në datën 11.4.2017 është njoftuar se brenda ambienteve të një dyqani me artikuj të përzierë, ndodhur në një prej lagjeve të qytetit të Durrësit, ka pasur një sherr mes disa personave dhe, për pasojë, një shtetas ka mbetur i dëmtuar, i identifikuar si shtetasi A.A, i transportuar në spitalin rajonal të këtij qyteti, ku si pasojë e dëmtimeve ka gjetur vdekjen. Pas shkuarjes në vendngjarje ka rezultuar se autorë të kësaj ngjarjeje kanë qenë shtetasit K dhe K.E, të cilët janë përfshirë në konflikt me mjete të forta me shtetasit A dhe V.A, vepër kjo e parashikuar nga neni 76-25 i Kodit Penal.

Është përpiluar procesverbali mbi këqyrjen dhe marrjen e provave, janë përpiluar vendimet e ekspertimit biologjik, vlerësues të provës materiale, vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik të thikës¹⁰³, vendimi për kryerjen e ekspertimit daktiloskopik vlerësues të provës.

Në referim cilësohet se është përpiluar vendimi për sekuestrimin e provës, njësia e kamerave të një lokali, procesverbali mbi këqyrjen e kufomës së viktimës A.A, vendimi i ekspertimit toksikologjik, etj.

Janë pyetur si persona që tregojnë rrethanat e hetimit disa shtetas, mes tyre edhe shtetasit D.A.A dhe V.B.A. Referohen shkaqet e ardhjes së konfliktit. Referohet kryerja e disa veprimeve hetimore për të dy shtetasit E, përfshirë ekspertimet biologjike të provës së sekuestruar, si dhe procesverbalet për arrestimin në flagrancë të këtyre shtetasve.

Në datën 17.4.2022 subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGJ-ja brenda datës 30.5.2022.

Në procesverbalin e datës 12.5.2017, për këqyrjen e pamjeve filmike të një subjekti privat ka rezultuar se aparatura nuk ka të regjistruar asnjë pamje filmike të këtij subjekti privat dhe se nga këqyrja e DVR-së nuk është fiksuar ndonjë fakt në interes të hetimit.

Në dosje janë administruar vendimet gjyqësore të masës “arrest me burg”, sikurse është kërkuar nga organi i akuzës, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit.

Me vendimin datë 11.7.2017, për pushimin e hetimeve dhe lirimin e të dyshuarit K.E, subjekti ka kërkuar pushimin e hetimeve në ngarkim të këtij shtetasi, si dhe shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg”.

¹⁰²Datë 12.4.2017, shihni informacionin për referimin e veprës penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, numërtuar në fashikull nr.*** e në vijim.

¹⁰³Me aktin e ekspertimit teknik datë 13.4.2017, administruar në fashikull, numërtuar me nr.***, është konkluduar se thika nuk i plotëson kushtet teknike të armëve të ftohta me teh (prerëse).

Në datën 11.7.2017 OPGJ-të kanë përfunduar hetimin e procedimit penal dhe kanë përgatitur relacionin përkatës, ku arsyetojnë dhe cilësojnë se në këtë rast është konsumuar vepra penale “vrasje nga pakujdesia” me pasojë vdekjen, e kryer nga shtetasi K.E, duke përjashtuar shtetasin K.E, për të cilin thuhet se nuk provohet që prej tij të jetë konsumuar figura e veprës penale për të cilën dyshohet dhe për këtë shkak kanë sugjeruar pushimin e ndjekjes penale ndaj tij.

Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet e tij, datë 5.12.2017, ka kërkuar deklarinim fajtor të shtetasit K.E dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim¹⁰⁴.

Në vendimin gjyqësor të shtetasit K.E, ndër të tjera, konstatohet se kundër vendimit të pushimit për shtetasin K.E nuk është ushtruar ankim, vendim ky i barazuar me atë të pafajësisë¹⁰⁵.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 28.12.2017, ka vendosur deklarinim fajtor të shtetasit K.E për veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në tërësi, duket se janë kryer të gjitha veprimet hetimore në këtë çështje.

Nga verifikimi në dosje, sikurse u citua më sipër, nuk administrohen akte që provojnë se vendimi i pushimit datë 11.7.2017 (në dispozitivin e të cilit është pasqyruar e drejta e ushtrimit të ankimit palëve të interesuara) t'i jetë komunikuar personave të interesuar (trashëgimtares së viktimës) në përputhje me dispozitat procedurale penale, duke i mohuar palëve të drejtën thelbësore për ushtrimin e ankimit.

- Si pasojë e mosushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi, vendimi i pushimit ka marrë formë të prerë, duke u barazuar me vendimin e pafajësisë ndaj shtetasit K.E.
- Si pasojë e vendimit të formës së prerë të pafajësisë, gjykata më tej nuk ka pasur kompetencë për të marrë të pandehur shtetasin K.E dhe, për pasojë, ka rënë akuza e bashkëpunimit.

Po për këtë çështje, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹⁰⁶ ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. ***, viti 2019, nga ish Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë dhe se pas kryerjes së verifikimeve lidhur me këtë kallëzim është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”. Informacioni, gjithashtu, konfirmon se pas kryerjes së hetimeve të këtij procedimi është vendosur dërgimi për kompetencë në SPAK, duke u regjistruar kështu procedimi nr. ***, datë 18.12.2019. Me vendimin nr. ***, datë 20.10.2020, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur *pushimin e çështjes*.

Në vendimin e arsyetuar qartësohet se lidhur me dyshimin ndaj veprimtarisë së punës së subjektit për këtë çështje, organi i akuzës ka theksuar pikërisht faktin se në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka dërguar çështjen për gjykim dhe se nga informacioni paraprak për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme shtetasit e dyshuar nuk kanë pasur asnjë komunikim telefonik me njëri-tjetrin, provuar kjo nga tabulatet telefonike.

Në tërësi argumentohet se nga veprimet e kryera nuk është provuar fakti i kryerjes së veprës penale “korrupsion”.

¹⁰⁴Sipas nenit 85 të Kodit Penal, *Vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*

¹⁰⁵Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, sipas vendimit nr. ***, datë 22.6.2016, të kësaj gjykate.

¹⁰⁶Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2021.

Në këto kushte duket se çështja e adresuar ndaj subjektit të rivlerësimit për përfshirje në korrupsion është bërë objekt i punës së prokurorisë dhe gjykatës, nga ku kanë rezultuar edhe vendimmarrjet e pushimit.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimin e denoncuesit¹⁰⁷ dhe konstatimin e Komisionit (gjithnjë sipas akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ) për mosnjoftimin e vendimit të pushimit të çështjes për të akuzuarin K.E, trashëgimtarëve të viktimës, si dhe të depozitave të dokumentacionit mbështetës nga fashikulli i çështjes. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të qartësojë statusin aktual të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 28.12.2017.

Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kërkimit të Komisionit, ka shpjeguar si vijon:

Në kallëzimin e paraqitur shtetasja V.A ka pretenduar se: “Si rezultat i mosnjoftimit të vendimit të pushimit të hetimeve të shtetasit K.E, vendimi i pushimit ka marrë formë të prerë, duke u barazuar me vendimin e pafajësisë ndaj shtetasit K.E. Si pasojë e këtij vendimi pafajësie të formës së prerë, gjykata nuk ka pasur kompetencë për të marrë të pandehur shtetasin K.K (për pasojë ka rënë akuza e bashkëpunimit).

Ky pretendim i bërë nga kjo shtetase është i pavërtetë, i pabazuar dhe jologjik. Kjo shtetase, gjatë gjithë hetimit, ka ndryshuar disa avokatë kryesisht ka pasur avokat z. F.A, të cilin e kam njohur me të gjitha aktet që ka kërkuar duke i komunikuar edhe vendimin e pushimit personalisht.

Bazuar në nenet 328 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale (përpara ndryshimeve të këtij kodi me ligjin nr. 35/2017) prokurori kishte të drejtë të pushonte çështjen ose akuzën. Në ligj nuk parashikohet si subjekt procedural trashëgimtari i viktimës.

Në kushtet kur çështja është regjistruar kryesisht (pra, nuk kishte kallëzues), ligji nuk parashikonte detyrimin e prokurorit të njoftonte trashëgimtarët e viktimës.

Pavarësisht sa më sipër rezulton e provuar se kallëzuesja ka marrë gjithë aktet e dosjes. Jo vetëm kaq po ajo ka publikuar fakte dhe prova të procedimit penal, si foto të viktimës, aktin mjeko-ligjor etj., pra akte që i ka dikush që është njohur me dosjen.

E drejta e ankimit sipas ligjit lind kur personi merr dijeni personalisht. Kodi i Procedurës Penale (përpara se sa të kryheshin ndryshimet me ligjin nr. 35/2017) nuk parashikonte afat për ankimin. Pra, ankim mund të kryhej në çdo moment, pavarësisht ditës kur kishte marrë dijeni.

Kjo shtetase ka paraqitur disa ankime ndaj vendimit të pushimit në Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtuesit të Prokurorisë, ka marrë pjesë në gjykim me avokat S.N, është pyetur si dëshmitare etj. Pra, provohet tej çdo dyshimi se ajo ka marrë dijeni për vendimin e pushimit dhe asnjëherë nuk ka paraqitur ankim procedural ndaj vendimit të pushimit të ndjekjes penale ndaj shtetasit K.E.

Kjo shtetase pretendon se i është mohuar e drejta e ankimit, të drejtë të cilën ajo nuk e ka ushtruar asnjëherë. Theksojmë edhe një herë që ajo ka pasur të drejtë në çdo moment të paraqiste ankim ndaj vendimit të pushimit, e palimituar në kohë nga momenti që ka marrë dijeni e në vazhdim dhe është marrë me ankesa pa kryer një ankim të mirëfilltë procedural.

¹⁰⁷pasi çështja u trajtua edhe në këndvështrim të denoncimeve me të njëjtin objekt ankimi

*Lidhur me zgjidhjen përfundimtare, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. *** ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke aplikuar nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale duke e dënuar me 3.4 vjet burgim shtetasin K.E. Cilësimi juridik i veprës penale nga gjykata është i njëjtë me cilësimin e bëra nga unë në njoftimin e akuzës ndaj këtej shtetasi. Pra, gjykata përfundimisht ka dënuar shtetasin K.E për veprën penale ‘vrasje me pakujdesi’. Bazuar në vendimet gjyqësore bie poshtë çdo pretendim se vrasja është kryer në bashkëpunim për shkak se nuk mund të ketë bashkëpunim për veprat penale të kryera nga pakujdesia. Për sa më sipër, vlerësoj se pretendimet e ngritura nga ankuesja janë të pabazuara”.*

Subjekti ka depozituar vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues arsyeton në këtë çështje duke mbajtur në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e konstatuara, ankesat, kallëzimet dhe denoncimin e shtetasës V.A, e cila parashtroi të njëjtin objekt ankimi. Në raport me ligjin e aplikueshëm në kohën kur dhe ka ndodhur veprimi, konstatohet se çështja penale ka nisur hetimin e saj përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale në gusht të vitit 2017. Sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale¹⁰⁸ në nenin 328 nuk njihej si palë trashëgimtari ligjor i viktimës, sikurse parashikohet sot në nenin 328/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe, për pasojë, edhe njoftimi nuk ishte i parashikuar në mënyrë eksplicite. Gjithashtu, duke iu referuar nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale (i pandryshuar) ku thuhet: *i dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e dëgjimit*, nuk rezultoi një përgjigje refuzuese me qëllim ushtrimin e mëtejshëm të ankimit në gjykatë. Në relacionin/letrën e përfaqësuesit ligjor drejtuar subjektit në cilësinë e prokurorit, duket se është disponuar vendimi i pushimit dhënë ndaj të dyshuarit K.E, ndërkohë që ky komunikim daton gjithashtu më parë vendimit të dënimit të shtetasit K.E. Duke iu referuar Analizës së Sistemit të Drejtësisë¹⁰⁹ në Shqipëri, thuhet se si mangësi janë konsideruar mungesa e parashikimit të mekanizmave për mbrojtjen fizike të viktimave dhe familjeve të tyre, ndërsa ndryshimet që pasuan në gusht të vitit 2017 Kodin e Procedurës Penale përfshinë në mënyrë eksplicite edhe njoftimet edhe ankimet e trashëgimtarëve të viktimës.

Një tjetër *indicie* që vërehet nga provat e administruara për marrjen e dëgjimit të vendimit të pushimit nga shtetasja V.A është edhe citimi i bërë në arsyetimin e gjykatës në vendimin gjyqësor të dënimit të shtetasit K.E ku thuhet se vendimi i pushimit të shtetasit K.E ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Po në këtë vendim, në pjesën hyrëse të tij, citohet edhe prezenca e palëve, më konkretisht, prania e trashëgimtares së viktimës penale V.A dhe përfaqësuesit të saj ligjor.

Nga aktet e depozituara në seancë rezultoi se subjekti ka depozituar një *e-mail* ku shtetasja V.A i është drejtuar Kryeministrit të vendit ku, ndër të tjera, përveçse i tregon lidhur me ngjarjen e ndodhur bashkëshortit të saj i bën prezent edhe faktin e marrjes e dëgjimit pikërisht ditën e dërgimit të këtij *e-mail*-i (16 apo 17.7.2017) se ishte njoftuar prej avokatit të saj se ishte liruar shtetas K.E. Duket se kjo, gjithashtu, është një tjetër mënyrë e të provuarit qoftë edhe indirekt mbi marrjen e dëgjimit të vendimmarrjes, me pasojë ushtrimin e të drejtës ankimore. Në tërësi nga të dhënat e rezultuara, nga komunikimet, si dhe nga vendimet e gjykatave, duket se ankuesja ka marrë dëgjimit për vendimin e pushimit.

¹⁰⁸Referuar kohës kur ka ndodhur veprimi.

¹⁰⁹Detaje (magjistatura.edu.al)

Në lidhje me ecurinë e gjykimit të çështjes së të pandehurit K.E, u konstatua se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ka ulur dënimin e të pandehurit në 3 vjet e 4 muaj burgim, krahasimisht me kërkimin e subjektit të rivlerësimit për dënimin e këtij shtetasi me 4 vjet burgim.

Në të tilla kushte, trupi gjykues, pas një hetimi të zgjeruar, në raport me legjislacionin, veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, vendimet e dhëna nga gjykatat ndaj subjektit lidhur me kallëzimet e bëra nga shtetasja V.A, përfshirë edhe statusin ligjor të vendimmarrjes i kontrolluar nga një gjykatë më e lartë, duket se nuk konstaton problematika që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

e. Komisioni administroi fashikullin/jt që i/u përket/asin procedimit penal nr. ***, regjistruar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të punonjësve të policisë të dyshuar, komisar K.XH, me detyrë *** i stacionit të Policisë *** dhe nënkomisar GJ.A, me detyrë ***.

Nga aktet e administruara, subjekti i rivlerësimit, në datën 28.3.2018, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***.

- *Mbi historikun e procedimit penal*

Dy shtetasit janë akuzuar për shpërdorim detyre nën akuzën se kanë përpiluar vërtetimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë për shtetasin G.N (për dhënie të armës së zjarrit për në banesë), ndërkohë që SHÇBA ka pasur informacione se ky shtetas ka qenë person kontigjent.

- Subjekti, pas regjistrimit të procedimit penal, në datën 18.10.2017, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg” ndaj shtetasit GJ.A. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 20.10.2017, ka vendosur vlefhtësimin e ligjshëm të ndalimit të këtij shtetasi dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” (sipas vendimit gjyqësor, masa e sigurimit personal përkon me atë që ka kërkuar organi i akuzës në seancë gjyqësore).

Në relacionin përfundimtar të OPGJ-së (datë 4.2.2018) për këtë çështje, ndër të tjera, është referuar se në vlerësim të të gjithë dinamikës, veprimeve dhe mosveprimeve të kryera nga dy punonjësit e policisë, gjendet përpara shkeljes së rëndë administrative, e cila është e parashikuar në pikat 1 dhe 7, të nenit 209, të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015, si dhe veprimet e kryera apo mosveprimet kanë shkaktuar shkelje të rëndë disiplinore, gjë e cila është ndëshkuar sipas kërkesave të neneve 196 dhe 237 të Rregullores. Nga Ministria e Brendshme (në datën 9.10.2017) është konstatuar shkelja e rëndë disiplinore për nënkomisar GJ.A me arsyen se vërtetimi i besueshmërisë dhe përshtatshmërisë dhënë shtetasit N nuk është përpiluar sipas urdhrit nr. ***¹¹⁰, datë 28.1.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ka nisur hetimi disiplinor. Në datën 10.10.2017, me vendimin nr. ***, Ministria e Brendshme/Drejtoria e Standardeve profesionale ka vendosur pezullimin disiplinor nga detyra të shtetasit GJ.A, si dhe heqjen e të drejtës për të hyrë në ambientet e punës i pashoqëruar.

Subjekti ka arsyetuar veprimet hetimore të kryera dhe në përfundim, në datën 28.3.2018, ka kërkuar pushimin e hetimeve të këtij procedimi (p. sh., ndër të tjera ka cilësuar se nga verifikimi

¹¹⁰Pika 6, Specialisti për krimet në komisaratin e policisë, për përpilimin e vërtetimit shfrytëzon të gjithë burimet e ligjshme të informacionit, kartotekën kriminale, sistemet elektronike në përdorim të policisë si dhe verifikon të dhënat e personit në raport me regjistrat fizikë dhe elektronik në të gjitha institucionet shtetërore.

në sistemin *TIMS* nuk pasqyrohet ndryshimi i emrit të shtetasit G.N dhe as rekordet e hedhura në sistem për ngjarjet, nga verifikimi në sekretari ky shtetas/G dhe E.N rezultojnë të padënuar, nga verifikimi në kartotekë siç ka deklaruar shtetasi GJ.A nuk kanë rezultuar të dhëna mbi shtetasin N si person me precedent penal, për marrëdhënie konfliktuale në shoqëri apo familje, nuk është vepruar në kundërshtim me udhëzimin përkatës për përfitimin e vërtetimit të besueshmërisë dhe nuk janë anashkaluar kërkesat kumulative, etj.).

Në datën 13.1.2018 subjekti ka vendosur zgjatjen e hetimeve deri në datën 13.4.2018.

Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Durrës/subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 13.10.2017 dhe datë 31.10.2017, duke regjistruar përkatësisht emrat e shtetasve GJ.A dhe K.XH, nën akuzën “shpërdorim detyre”, mbi informacionin e përcjellë nga SHÇBA-ja se në kundërshtim me ligjin kanë përgatitur vërtetimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë. Ky informacion është përpiluar pas kapjes në flagrancë me armë zjarri shtetasin N, më 3.10.2017, i cili është gjendur i pajisur me autorizim për mbajtjen e armës.

Në zgjatjen e afateve është kërkuar marrja e dosjes penale e vitit 2011 për shtetasin N, pyetja e OPGJ-së që ka kryer hetimet me këtë dosje, administrimi i dëshmisë së penaltetit për shtetasin Nderjaku, si dhe veprime të tjera dinamike.

Në datën 28.2.2018, Drejtuesja e Prokurorisë ka udhëzuar kryerjen e disa detyrave ndaj këtyre dy personave si: (i) kërkimin e dokumentacionit për të verifikuar nëse qëndronte pretendimi i shtetasit K.XH si epror, se nuk kishte nënshkruar vërtetimin e besueshmërisë për shkak se në periudhën e lëshimit kishte qenë në trajnim; (ii) ballafaqimin midis dy shtetasve, K.XH dhe GJ.A nën pretendimin e shtetasit K.XH se vërtetimin mund ta ketë nënshkruar shtetasi GJ.A; (iii) verifikimin e faktit se shtetasi N ka ndryshuar emrin e tij dy herë përkatësisht, në vitet 2009 dhe 2010 dhe përse nuk është administruar certifikata në lidhje me ndryshimet e emrit dhe për këtë të ripyetet shtetasi GJ.A, ky i fundit të ripyetet në lidhje me pretendimin për nënshkrimin në emër të shtetasit K.XH, si dhe të kryhet aktekspertimi teknik-grafik i shkrimit nëse nënshkrimi në praktikë është i shtetasit K.XH ose jo, si dhe të kryhet verifikimi se si është caktuar shtetasi GJ.A për ndjekjen e kësaj praktike kur në kartelën shoqëruese është sigluar nga komisar K.XH një tjetër punonjës.

Konkretisht duket se janë kryer veprimet hetimore, lidhur me: (i) kryerjen e aktekspertimit; (ii) administrimin e dokumentacionit/praktikës sa i përket ndjekjes së dhënies së vërtetimit të besueshmërisë për blerjen e armës së zjarrit. Në dosje është administruar edhe aktekspertimi datë 23.3.2018, ku në konkluzion citohet se nënshkrimet nuk janë të shtetasit GJ.A.

- Ndërsa, në gjendjen që ishin aktet deri aktualisht dukej se nuk ishin kryer hetimet e tjera, si ripyetja e shtetasit GJ.A për caktimin e tij për ndjekjen e praktikës për vërtetimin e besueshmërisë për mosadministrimin e certifikatës së gjendjes civile me pasqyrimin e ndryshimit të emrit të shtetasit Nderjaku, si dhe ballafaqimi mes dy punonjësve, epror/specialist.

Ndërsa në lidhje me procesin gjyqësor të kësaj çështje, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjiqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 14.5.2018, ka vendosur (sipas kërkesës së organit të akuzës) pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të këtyre shtetasve, të akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, vendim ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me arsyet e ndryshimit të kërkimit të masës së sigurimit personal ndaj shtetasit GJ.A, bërë në seancë gjyqësore, nga “arrest me burg” në “arrest në shtëpi”, si dhe të vërtetojë shpjegimet me dokumentacion nga fashikulli i

dosjes. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të depozitohet vendimin (e plotë) nr. ***, datë 20.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në vijim, subjektit iu kërkua të japë shpjegime pasi dukej se nuk kishte kryer veprimet hetimore të lëna detyrë nga eprori (gjithnjë sipas dokumentacionit të administruar deri në rezultatet e hetimit), si dhe të depozitonte dokumentacionin mbështetës nga fashikulli i çështjes.

Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kërimit të Komisionit, ka shpjeguar: *“Sqaroj Komisionin se në seancën e vlerësimit të masës së sigurimit kam kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit nga ‘arrest në burg’ në ‘arrest në shtëpi’, pasi masa ‘arrest në burg’ nuk i përgjigjej më nevojave të sigurimit. Mbi bazë të informacioneve verifikuese që u disponuan në mënyrë të shpejtë, në momentin që gjykata mori në shqyrtim kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, ra niveli i provueshmërisë së dyshimit të arsyeshem mbi ekzistencën e faktit penal. Në këto kushte çmova të ndryshoj qëndrimin duke kërkuar një masë sigurimi më të butë, kur si rrethana të tjera shërbyen edhe disa fakte të tjera të paraqitura në seancë siç janë: ky shtetas ishte kryefamiljar, me fëmijë të sëmurë, bashkëshortja ishte e papunë, si dhe u paraqitën dokumente që provonin gjendjen e vështirë ekonomike. Vendimi im për të zbutur masën e sigurimit rezultoi i drejtë për shkak se në përfundim të hetimit nuk u provua kryerja e ndonjë vepr penale dhe, për këtë arsye, kërkoja në gjykatë pushimin e çështjes, kërkesë e cila u pranua nga gjykata. Lidhur me detyrat e lëna nga eprori, si ripyetje e shtetasit G dhe ballafaqim i dy punonjësve të policisë, kryerja e tyre është parë si e panevojshme. Bazuar në ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale, udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë nuk janë detyruese. Është në vlerësim të prokurorit të çështjes të çmoj përfundimisht kryerjen ose jo të këtyre detyrave. Kam vlerësuar se nga aktet e administruara rrethanat e faktit ishin të qarta dhe ripyetja apo ballafaqimi i personave ishte i panevojshëm, për shkak se të gjitha faktet ishin sqaruar. Vlerësimi im në lidhje me moskryerjen e veprimeve hetimore nga Drejtuesi i Prokurorisë rezultoi i drejtë, pasi gjykata pranoi kërkesën për pushimin e çështjes dhe nuk e çmoi të nevojshme kryerjen e veprimeve të udhëzuara nga Drejtuesi i Prokurorisë (udhëzimi i drejtuesit ishte pjesë e fashikullit të dërguar për gjykim). Vlerësoj se edhe kryerja e veprimeve të panevojshme dëmton qëllimin e ndjekjes penale dhe punën e Prokurorisë, njësoj si në rastet kur nuk kryen veprimet e domosdoshme”.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave konkrete të pasqyruara përgjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, duke konsideruar gjithashtu edhe shpjegimet e subjektit, arsyetoi si vijon:

Argumentet e parashtruara nga subjekti lidhur me kërkimin e ndryshimit të masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit GJ.A, të cilat kishin nxjerrë në pah problematikat shëndetësore, familjare dhe ekonomike të tij, duken të pranueshme në raport me të dhënat e para të cilat nuk mund të jenë gjithnjë prezent në kushtet e ngutshmërisë që kërkohet për të vendosur mbi caktimin e një mase sigurimi personal ndaj një personi. Referuar dokumentacionit të administruar, ndër të tjera, pasqyrohet një epikrizë e fëmijës së të dyshuarit A me titull *epikrizë përcjellëse për invalidë* dhe disa dokumente të tjera shëndetësore, çka përkon me vlerësimin dhe veprimet justifikuese për një ndryshim të mundshëm të një mase sigurimi, sikurse është edhe rasti në fjalë. Gjithashtu, si një rrethanë tjetër e rëndësishme nga aktet e administruara në dosjen objekt i këtij hetimi administrativ u identifikua edhe pezullimi i tij nga detyra, si dhe nisja e procedimit disiplinor nga institucioni punëdhënës, Drejtoria e Policisë. Pra, paralelisht me ndërmarrjen e masave administrative dhe konfirmimin e disa të dhënave në favor të shtetasit të dyshuar A, për të bërë të mundur zëvendësimin e masës së sigurimit sikurse e parasheh neni 260

i Kodit të Procedurës Penale, u ndërmorën edhe veprimet hetimore, të cilat duket se janë ndjekur profesionalisht nga subjekti. Në të tilla kushte duket se janë grumbulluar disa prova të cilat pa mënjeluar edhe vlerësimin e bindjes së brendshme të subjektit përpos edhe logjikës së përdorur në arsyetimin e kërimit të tij ndaj organeve gjyqësore, e cila nuk mund të zëvendësohet dhe as interpretohet, përfshirë këtu edhe vendimmarrjet¹¹¹ e gjykatave, së bashku krijojnë një panoramë të plotë e të qartë për të cilën trupi gjykues duket se nuk konstaton problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

ë. Komisioni ka administruar¹¹² fashikullin penal që i përket procedimit nr. ***, në ngarkim të shtetasit D.S, akuzuar për veprën penale “vjedhje” (hetuar nën masën “detyrim paraqitje”, sipas vendimit nr. ***, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier).

- *Rrethanat e çështjes*

Kjo çështje i referohet vjedhjes së kampionave të aluminit në një kabinë elektrike në ndërmarrjen elektrike të shoqërisë “***”, konstatuar nga shefi i sektorit, i cili ka bërë edhe kallëzimin përkatës. Për këtë kallëzim është marrë nën akuzën e vjedhjes shtetasi D.S me detyrë roje në këtë shoqëri, për shkak se vjedhja kishte ndodhur gjatë natës teksa kryente shërbimin e rojës ky shtetas. Shtetasi D.S ka mohuar akuzën e adresuar. Sipas vendimit të pushimit të çështjes thuhet se për shkak të kohës së kaluar nga momenti i vjedhjes deri në momentin e kallëzimit nuk është bërë e mundur gjetja e materialeve që të vërtetoheshin dyshimet ndaj këtij të hetuari. Është provuar ekzistenca e faktit penal, pra vjedhja, por jo autori i kryerjes së saj. Këto kanë qenë shkaqet e pushimit të çështjes.

Në datën 9.9.2011 subjekti i rivlerësimit, pas disa veprimeve hetimore, ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit D.S dhe pezullimin e procedimit penal për moszbulim të autorit.

Pas shfuqizimit të vendimit nga Drejtuesi i Prokurorisë për kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, subjekti ka depozituar kërkesë për heqje dorë nga hetimi i çështjes nën shpjegimin se Prokuroria e Rrethit Vlorë kishte në hetim një çështje penale të iniciuar nga shtetasi D.S ndaj subjektit, nën akuzën e veprës penale, parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal dhe që lidhej pikërisht me këtë procedim (procedimin e vjedhjes nr. ***). Kjo kërkesë rezulton e pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Fier me datë 10.11.2011. Në datën 10.2.2012, një tjetër subjekt rivlerësimi (V.SH) pas kryerjes së hetimeve të lëna sipas vendimit të shfuqizimit, ka vendosur po njëjtë si subjekti i rivlerësimit më parë, pushimin e procedimit penal në ngarkim të këtij shtetasi, si dhe e ka pezulluar atë për moszbulim autori të veprës penale duke i dërguar aktet Komisarariatit të Policisë.

Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të pasqyruara më sipër, nuk konstatoi problematika të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

f. Komisioni administroi¹¹³ fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***.

Nga aktet rezultoi si vijon:

¹¹¹Gjykata e Apelit Durrës ka ndryshuar masën e sigurimit personal në detyrim për paraqitje në polici. Në vendimin e formës së prerë që i përket themelit të çështjes është arsyetuar se personat në hetim kanë vepruar në përputhje me urdhrat dhe udhëzimet e Drejtorisë së Policisë së Shtetit.

¹¹²Me shkresën nr.*** prot., datë 2.3.2021, të Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Procedimi penal është regjistruar ndaj shtetasit E.D, akuzuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të zjarrit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.

Për këtë shtetas, pas ndalimit të bërë automjetit që drejtohe nga ku ka rezultuar se mbante një armë pistoletë dhe fishekë gjithashtu, është përpiluar raport shërbimi dhe kapja e tij në flagrancë. Është konstatuar se shtetasi E.D nuk dispononte leje për mbajtjen e armës dhe se ka deklaruar se armën e ka gjetur një ditë më parë në kanal.

Subjekti, pas kryerjes së veprimeve hetimore, ka përfunduar hetimet në datën 11.4.2018, duke u komunikuar të dyshuarve edhe akuzën, si dhe njohjen me aktet e dosjes. Më tej, subjekti, në datën 13.4.2018 ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, së bashku me dokumentacionin hetimor. Subjekti ka kërkuar dënimin e këtij shtetas me 7 vjet burgim duke u aplikuar gjithashtu edhe neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale, duke u dënuar me 4 vjet e 6 muaj.

Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 13.9.2018, ka vendosur dënimin e këtij shtetas me 2 vite burgim, vendim ndaj të cilit subjekti ka ushtruar ankim.

Trupi gjykues, në tërësi të hetimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje, nuk identifikoi *indicie*, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Rastet e trajtuara më sipër në këtë rubrikë, si dhe konkluzionet e arritura në secilin prej tyre duket se nuk provuan konkludimin e raportit të kontrollit të figurës.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit Bledar Bejko, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si vijon:

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të denoncuesve, si dhe dokumentacionit të administruar vërejt se disa prej denoncuesve janë ankuar në mënyrë të përsëritur për të njëjtin objekt ankimi. Në tërësi të denoncimeve të depozituara, Komisioni për tetë¹¹⁴ prej tyre nuk vlerësoi fakte apo rrethana, të cilat ndikojnë në rivlerësimin e subjektit. Gjithashtu, për denoncimet e shtetasve A.SH¹¹⁵ dhe V.A¹¹⁶, të cilët ankojnë për të njëjtin objekt ankimi, sikurse i janë drejtuar me ankesat e tyre edhe organit të akuzës, Komisioni arsyetoi dhe konkludoi më sipër në këtë vendimmarrje.

Në vijim, për të konkluduar në lidhje me denoncimet e shtetasve të cituar në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mbi disa paqartësi të evidentuara dhe sipas rastit të depozitohë edhe dokumentacionin mbi shpjegimet e dhëna apo statusin aktual të ndonjëres prej çështjeve.

1. Denoncim¹¹⁷ i shtetasit F.GJ

Në denoncimin e tij (ardhur në format elektronik me *e-mail*) ky shtetas i drejtohet Drejtueses në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (znj. J) lidhur me trajtimin e një denoncimi që ka bërë në Policinë e Durrësit (datë 8.1.2021) dhe kallëzimit të bërë tek oficeri i

¹¹⁴Nr.*** prot., datë 4.4.2019; nr. *** prot., datë 20.3.2018; nr. *** prot., datë 7.3.2018, përsëritur me nr. *** prot., datë 24.5.2018; nr. *** prot., datë 5.5.2021; nr. *** prot., datë 2.2.2022, përcjellë nga Kolegji me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2022; nr. *** prot., datë 23.11.2021, përcjellë për trajtim nga Kolegji me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2021, përsëritur me nr.*** prot., datë 19.1.2022, përcjellë nga Kolegji me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2022, përsëritur me *e-mail* në Komision në datën 14.1.2022; ardhur me *e-mail* në datën 10.7.2020; nr. *** prot., datë 17.12.2021.

¹¹⁵Denoncim nr. ***prot, datë 29.1.2019.

¹¹⁶Denoncim nr. *** prot., datë 7.12.2017, përsëritur me nr. *** prot., datë 18.1.2018 dhe përsëritur sërish me *** prot., datë 26.3.2018. Së bashku me denoncimin znj. A ka bashkëlidhur disa foto, letër të përfaqësuesit të saj ligjor drejtuar prokurorit të çështjes (subjekt i rivlerësimit), datë 7.10.2017, “*****” drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹¹⁷Denoncim nr. *** prot., datë 20.1.2021.

policisë gjyqësore, z. K.D (datë 18.1.2021), por fillimisht pa cituar në adresë të kujt është bërë kallëzimi dhe denoncimi.

Subjekti, në lidhje me këtë denoncim, ka shpjeguar se prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurve F.GJ dhe A.GJ (bashkëshortë) për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga nenet 130/a/1 dhe 25 të Kodit Penal, kryer në bashkëpunim, si dhe ndaj të pandehurës Y.GJ (bashkëshortja e vëllait të denoncuesit), për veprën penale “dhunë në familje”.

Subjekti ka përshkruar ngjarjen e ndodhur në gusht të vitit 2020 në Lagjen *** Durrës, duke sqaruar se në sherrin fizik të ndodhur mes dy zonjave ka ndërhyrë shtetasi GJ, i cili ka rrahur shtetasen Y.GJ. Subjekti ka shpjeguar se janë kryer veprimet hetimore nga policia gjyqësore, janë këqyrur dhe marrë në cilësinë e provës materiale regjistrimet e kamerave të sigurisë të vendosura në banesën e shtetasit G.GJ, janë këqyrur e printuar edhe fotografi nga këto pamje, ku evidentohet dhuna e ushtruar. Në përfundim, të pandehurit janë njohur me faktet objekt akuze, si dhe të drejtat e tyre procedurale duke nënshkruar edhe vendimin për përfundimin e hetimeve. Pas marrjes së kopjeve të plota të akteve çështja është dërguar për gjykim. Gjatë gjykimit është vendosur ndarja e procedimit penal për të pandehurit F dhe A.GJ, pasi kanë zgjedhur të gjykohen me ritin e gjykimit të zakonshëm ndërsa shtetasja A është larguar jashtë shtetit në kohën që çështja ishte në gjykim. Gjykimi ndaj shtetasës Y përfundoi dhe gjykata e dënoi atë me 4 muaj burgim, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit dhe vendosur atë në provë për një afat 8-mujor. Edhe shtetasi F.GJ 71-vjeçar, megjithëse ishte në gjykim u largua jashtë shtetit dhe në kushtet e mosnjohimit me vendim gjykate çështja penale ndaj tij u pezullua sipas nenit 352/1 të Kodit të Procedurës Penale për të dy të pandehurit.

Subjekti është shprehur se *nuk ka njohje dhe as konflikt interesi me asnjë nga këta të pandehur, se ndjekjen penale e ka bazuar vetëm në provat e administruara, ka zbatuar ligjin penal dhe atë procedural penal. Pretendimi i denoncuesit është i paqartë ose ia kanë shkruar të tillë. Në seancat gjyqësore ai ka qenë i pranishëm dhe nuk ka pasur pretendime për mosnjohje të akteve. Vlerësoj se pretendimet e tij janë të pabaza.* Subjekti ka depozituar:

- kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq;
- vendimin për njoftimin e akuzës datë 29.12.2020, për procedimin penal nr. ***;
- njoftimin për përfundimin e hetimeve;
- dëftesën e komunikimit nr. regj. *** nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës vendimi nr. ***, datë 23.7.2021;
- vendimin nr. ***, datë 15.7.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me të pandehur z. F.GJ.

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti si dhe provave të administruara të cilat pasqyrojnë veprimet hetimore dhe ato gjyqësore, nuk konstatoi fakte apo rrethana që ndikojnë në rivlerësimin e kriterit profesional të subjektit.

2. Denoncim¹¹⁸ i shtetasit E.M

Denoncuesi, në rolin e avokatit (me prokurë përfaqësimi e vitit 2017) të shtetasit H.B, deklaroi se në momentin e denoncimit ky i fundit ka ndërruar jetë. Kërkesës nuk i është bashkëlidhur dokumentacion provues. Çështja së cilës i referohet përfaqësuesi ka të bëjë me një aksident të ndodhur te “***” në vitin 2009, ku mbeti i plagosur rëndë shtetasi H.B. Në vijim, denoncuesi

¹¹⁸Denoncim nr.*** prot., datë 13.11.2019, dhe nr. *** prot., datë 18.11.2019.

pretendon se provat e kësaj ngjarjeje janë falsifikuar nga oficeri i policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Durrës, z. I.B. Ai pretendon se ky i fundit së bashku me prokurorin e çështjes Bledar Bejko kanë shpërdoruar detyrën. Konkretisht pretendon se nga ana e OPGJ-së, z. I.B, janë falsifikuar të gjitha dëshmitë e dhëna nga shtetasi i aksidentuar, z. H.B, vërtetuar kjo nga Instituti i Policisë Shkencore. Gjithashtu, citon se në vitet 2017 – 2019 (datën kur është bërë denoncimi) ka disa vendime gjyqësore që kanë rrëzuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e prokurorit Bledar Bejko për pushimin e çështjes penale nr. *** viti 2009 dhe gjykata i ka lënë disa herë detyra, por që nuk janë zbatuar apo plotësuar prej tij. Denoncuesi pretendon se ka kërkuar disa herë përjashtimin e prokurorit Bledar Bejko nga kjo çështje, por kërkesat nuk janë pranuar (citon vendimin e fundit nr. *** prot., datë 21.5.2019, të Drejtueses së Prokurorisë). Denoncuesi pretendon se kjo çështje ka mbi 10 vjet në dyert e prokurorisë dhe prokurori Bledar Bejko e ka vonuar këtë çështje me pengesa të shumta.

2.1 Komisioni administroi¹¹⁹ fashikullin penal që i përket procedimit nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga aktet e administruara rezultoi si vijon:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 6.3.2020, mbi kërkesën e organit të prokurorisë, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, për pushimin e çështjes penale kundër personit nën hetim I.B (në seancë paraprake) ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e akteve të këtij procedimi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për vazhdimin e hetimeve të tjera dhe përfundimin e tyre brenda katër muajve.

Nga përfaqësuesi i kallëzuesit pretendohet se nuk janë kryer hetime të plota si lidhur me rrethanat e çështjes së aksidentit automobilistik, por edhe me personin nën hetim I.B, i cili akuzohet se ka falsifikuar dokumentet hetimore duke qenë me detyrën e OPGJ-së në Komisariatin e Policisë Durrës.

Procedimi penal është regjistruar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, në bazë të nenit 290 të Kodit Penal, për shkak se shtetasi A.P, pasi ka humbur kontrollin, ka goditur me automjetin e tij disa automjete dhe ndër to edhe motoçikletën e tipit “Honda” që drejtonte shtetasi (i dëmtuari) H.B.

Nga ekspertiza ka rezultuar se shtetasi H.B ka pësuar dëmtime të rënda dhe pas kryerjes së hetimeve subjekti ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal.

Me vendimin nr. ***, datë 4.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pranimi i kërkesës së ankuesit H.B, prishja e vendimit “Për pushimin e procedimit penal” datë 7.9.2009 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, lidhur me kallëzimin penal nr. ***¹²⁰, kthimi i akteve për hetime të mëtejshme për rifillimin e procedimit penal, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 14.6.2016. Pushimi i çështjes, i vendosur fillimisht nga organi i akuzës në vitin 2009, ka ardhur si rezultat i arsytimit se fakti nuk përbën vepër penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Ndër të tjera, në vendim thuhet se nga aktekspektimi si shkak determinant i dëmtimit të rëndë të shtetasit H.B ka qenë mosrespektimi prej tij i rregullave të qarkullimit rrugor. Detyrat e lëna në këtë vendim kanë cilësuar ballafaqimin e shtetasit H.B me shtetasin A.P për të konkluduar se kush ka qenë në drejtim të

¹¹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nr. *** prot., datë 5.1.2022, të Gjykatës së Lartë.

¹²⁰I hetuar e pushuar në vitin 2008 nga një tjetër subjekt rivlerësimi (A.N.).

automjetit, pyetjen e të dëmtuarit dhe nëse shihej e nevojshme të kryhej edhe një ekspertim me grup ekspertësh të fushës.

I dëmtuari, pasi është pyetur në datën 20.7.2016, ka theksuar se deri në atë kohë nuk ishte pyetur, ndërsa OPGJ A.SH e ka vënë në dijeni se administrohej deklarimi i këtij shtetasi në datën 24.2.2009, ku dhe kishte nënshkruar duke ia vendosur njëkohësisht në dispozicion edhe dokumentin për njohje.

I dëmtuari ka deklaruar se nuk ishte nënshkrimi i tij dhe se në kohën që kishte ndodhur aksidenti pas katër muajve në shtëpinë e tij kishte shkruar OPGJ I.B, por ai nuk kishte qenë në gjendje të jepte deklarime.

Edhe bashkëshortja e shtetasit H.B, S.B, ka deklaruar se ka qëndruar fillimisht pranë bashkëshortit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe se ajo nuk ishte marrë në pyetje nga OPGJ I.B.

Prokuroria, në datën 31.2.2017, ka regjistruar emrin e personit të dyshuar të OPGJ-së si autor i mundshëm i falsifikimit, bazuar në nenin 186/3 të Kodit Penal, duke vijuar kështu hetimet.

Aktekspertimi, datë 11.7.2017, ka konkluduar se nënshkrimet në deklaratimet e marra nga shtetasi H.B nuk janë të tijat dhe as të bashkëshortes së tij. Po ashtu, edhe aktekspertimi, datë 22.12.2018, i Institutit të Policisë Shkencore Tiranë ka konkluduar se shkrimet dhe nënshkrimet e deklaruesit H.B nuk janë shkruar e nënshkruar nga personi nën hetim I.B.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 30.5.2018, mbi kërkesën e organit të akuzës për miratimin e kërkesës për pushimin e çështjes ndaj personit nën hetim I.B për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, ka vendosur (me vendim të formës së prerë) mospranimin e kërkesës dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e hetimeve. Në datën 9.12.2018, sipas certifikatës përkatëse, rezulton se ka ndërruar jetë shtetasi H.B. Më tej është dërguar sërish kërkesa për pushimin e çështjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 25.6.2019 (të formës së prerë), ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale ndaj personit nën hetim I.B dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve. Në detyrat e lëna, ndër të tjera, cilësohet se duhet të vazhdojnë hetimet për të përcaktuar autorin që ka përpiluar dokumentet që rezultojnë se janë të falsifikuara, duhet vlerësuar në hetim edhe aktekspertimi i realizuar privatisht nga bashkëshortja e shtetasit H.B, të hetohet nëse janë angazhuar edhe OPGJ të tjerë dhe, më tej, nëse nuk arrihet gjetja e autorit duhet konkluduar për pezullimin e çështjes penale deri në identifikimin e tij për shkak të falsifikimit të dokumenteve.

Ndërkohë, në datën 22.10.2019, subjekti ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. *** për shkak se te të dyja veprat penale zbatohet neni 66 i Kodit Penal, pra ato janë parashkruar dhe se ndjekja penale për to nuk mund të vazhdojë.

Ndërsa në vendimin e gjykatës datë 6.3.2020, përsëri thuhet se duhet të ishin kryer hetime të zgjeruara për të përcaktuar autorin që ka përpiluar dokumentin, duhej pyetur eksperti që kishte përpiluar aktekspertimin të marrë privatisht nga bashkëshortja e të ndjerit dhe nëse nuk arrihet përcaktimi i autorit, atëherë duhet parë nëse ndodhet përpara kritereve të nenit 66 (parashkrimi të veprës penale) apo duhet vepruar sipas rregullave procedurale për identifikimin e autorit që ka kryer falsifikimin, vepër penale e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ky vendim rezulton të jetë ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime pasi dukej se nuk kishte kryer veprimet hetimore sa i përket identifikimit të autorit,

nuk kishte pyetur ekspertin (e marrë nga bashkëshortja e të dëmtuarit/i ndjeri B) për të rakorduar thëniet e tij më tej me provat në tërësi, si dhe nuk kishte konkluduar lidhur me vijimësinë e pezullimit për moszbulimin e autorit, si dhe të depozitonte prova mbështetëse nga fashikulli i çështjes.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Ankimi i shtetases S.B i referohet aksidentit të ndodhur në datën 23.2.2009, në vendin e quajtur “***”, ku është aksidentuar shtetasi H.B, drejtues motoçiklete nga i dyshuari A.P. Kjo çështje është pushuar¹²¹ nga prokuroria, por mbi bazë të kallëzimit të shtetasit H.B, me vendimin nr. ***, datë 4.3.2015, është rifilluar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Rifillimi është bërë me qëllim një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, si ripyetje të të dëmtuarit, ballafaqim dhe veprime të tjera dinamike.

Ankuesi ka pasur pretendime për aktekspertimet autoteknike dhe ka kërkuar një riekspertim, pasi pretendonte se shtetasi A.P nuk ishte në drejtim të mjetit. Gjithashtu, ankuesi kërkonte të pyetej dhe ndryshe nga sa referonin aktekspertimet teknike, ai nuk ishte fajtor për aksidentin e ndodhur.

Në momentin që gjykata pranoi të prishte vendimin e pushimit, neni 290 i Kodit Penal parashikonte dënim me burgim deri në 5 vjet (ndryshe nga parashikimet ligjore të nenit 290 në momentin e ndodhjes së veprës penale).

Duke pasur parasysh parimi i rëndësishëm penal i aplikimit të ligjit penal favorizues për të pandehurin, hetimi në këtë çështje nuk mund të vazhdonte për shkak të parashikimit të ndjekjes penale. Pra, sido që të ishte rezultati i hetimeve, prokurori, në rastin konkret, nuk mund të ushtronte ndjekjen penale për shkak të parashkrimit të saj, sipas parashikimit të nenit 66 të Kodit Penal.

Jam caktuar si prokuror i kësaj çështjeje penale, pasi kishte kaluar afati i parashkrimit.

Lidhur me orientimin e hetimit ndaj oficerit të policisë gjyqësore I.B, për element të falsifikimit sipas paragrafit të nenit 186/3 të Kodit Penal, rezultoj se regjistrimi i emrit i shtetasit I.B për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, është bërë kryesisht nga prokurori, bazuar mbi një aktekspertim privat dhe nuk lidhej me kërkesën e palës, që në thelb ishte ndryshimi i konkluzionit të shkakut determinant të aksidentit që do të ishin veprimet e kundërligjshme të shtetasit A.P. Kjo kërkesë nuk lidhej as me faktet dhe provat, po bazohej mbi një provë të vetme si aktekspertimin pa mostra të lira ose eksperimentale të shtetasit H.B, i cili kishte ndërruar jetë, ndërkohë që nënshkrimi i tij ishte hedhur në kushtet e dëmtimit të rëndë në spital. Theksoj se në procesverbal nuk kishte as një të dhënë për hetimin sepse i dëmtuari në atë moment nuk kishte pasur mundësi për të shpjeguar ngjarjen, për shkak të dëmtimeve shëndetësore.

Bazuar në faktet e sipërcituara kam kërkuar pushimin e çështjes penale. Kërkesa për pushim nuk është pranuar nga gjykata duke lënë detyra të panevojshme.

Vendimi nr. ***, datë 6.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 25.6.2020, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës duke vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹²¹ “Sqaroj se në këtë moment unë nuk kam qenë prokuror i kësaj çështjeje”.

Gjykata e Apelit Durrës ka theksuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material dhe duhet ndryshuar duke u pranuar kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes në bazë të nenit 428/1/b të Kodit të Procedurës Penale.

Më konkretisht, gjykata arsyeton se: ‘Pretendimi në ankim i prokurorit se faktet penale për të cilat është regjistruar procedimi penal tashmë nuk mund të vazhdojnë të hetohen, pasi është parashkruar ndjekja penale është i drejtë dhe duhet pranuar. Gjykata e shkallës së parë ka marrë një vendim të gabuar, kur ka vendosur vazhdimin e hetimeve ndërkohë që faktet penale për të cilat është regjistruar çështja nuk mund të vazhdojë ndjekja penale pasi janë parashkruar. Tashmë gjykata nuk mund të detyrojë organin e akuzës të kryejë dhe disa veprime të tjera hetimore. Veprimet hetimore janë të nevojshme për të konkluduar nëse fakti penal ka ndodhur dhe zbuluar autorin e veprës penale dhe dërgimi në gjyq i tij me qëllim deklarimin fajtor nga gjykata. Bazuar në nenin 328/1/d të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 66/c të Kodit Penal me kalimin e afateve, e drejta e viktimës për të kërkuar ndjekjen penale të autorit, por dhe e organit procedues për të ushtruar ndjekjen penale bie në dekadencë çka do të thotë se për asnjë lloj shkaku edhe sikur të ketë prova tej çdo dyshimi që personi e ka kryer veprën penale ai nuk mund të ndiqet më penalisht dhe as të gjykohet për faktin penal. Kjo lidhet me parimin e sigurisë juridike dhe me procesin e rregullt si dy shtylla mbi të cilat vepron sistemi i drejtësisë.

Në vendim arsyetohet gjithashtu se: ‘Nga ana tjetër Prokuroria ka regjistruar emrin në regjistër të personit nën hetim I.B në datën 31.7.2017 për veprën penale ‘falsifikim të dokumenteve’, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal për dyshimin se ka falsifikuar deklarimin e viktimës H.B të datës 24.2.2009. Ky fakt penal nuk ka një datë se kur mund të ketë ndodhur, por ka kufijtë e përcaktuar siç është data e regjistrimit të çështjes penale të aksidentit, pra data 23.2.2009, si datë më e largët dhe data më e afërt e mundshme e falsifikimit është data e vendimit të pushimit që është 7.9.2009. Edhe për këtë fakt penal për të cilin është regjistruar çështja penale dhe emri i dyshuar, rezulton se është parashkruar ndjekja penale. Pra, data e fillimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale fillon në datën e ndodhjes së falsifikimit datë 7.9.2009 (rasti më i favorshëm për viktimën). Sipas nenit 66 të Kodit Penal ndjekja penale nuk mund të vazhdojë më shumë se 10 vjet për veprën penale ‘falsifikim dokumenteve’ të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, pasi kjo vepër ka të parashikuar dënim deri në 7 vjet burgim. Nga hetimi paraprak rezulton se për këtë çështje penale nuk është marrë i pandehur askush dhe në këto kushte afati i parashkrimit të ndjekjes penale është plotësuar në datën 6.9.2019. Afati i parashkrimit do të ishte ndërprerë nëse para datës 6.9.2019 autori i dyshuar do të ishte marrë i pandehur. Në këto kushte, lënia e detyrave nga gjykata për kryerje të veprimeve hetimore është e panevojshme dhe në bazë të neneve 329/a dhe 328/1/d të Kodit të Procedurës Penale vendimi i gjykatës duhet ndryshuar dhe çështja penale të pushohet për të dy faktet penale për të cilën është regjistruar. Si konkluzion edhe në këtë rast vendimmarrja ime është e drejtë sipas dispozitave procedurale penale’.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, provave të administruara, tërësisë së fakteve dhe rrethanave të konkluduara përgjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, vërejtji se nga subjekti i rivlerësimit janë kryer disa veprimeve hetimore për zbardhjen e çështjes. Gjithashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë këmbëngulës në kërkimin e tij për të pushuar çështjen ndaj OPGJ-së, për sa kohë nga aktekspertimet nuk ishin provuar elementë të veprës penale ndaj tij. Ndërkohë, nga dokumentacioni i depozituar u konstatua se vendimmarrjet janë kontrolluar nga gjykatat më të larta dhe se është përfshirë në analizimin e çështjes edhe

instituti i parashkrimit. Gjykata e shkallës së parë, pas kërkesës së subjektit, ka vendosur kthimin e çështjes për hetime të tjera, ndërsa Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke arsyetuar se nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar në mënyrë të gabuar ligji procedural dhe material. Në tërësi, trupi gjykues nuk konstatoi problematika që ndikojnë në rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim¹²² i shtetasit A.A

3.1 Në denoncimin e tij ky shtetas pretendon se subjekti ka vendosur në mënyrë të padrejtë mosfillimin e procedimit penal të iniciuar mbi bazën e kallëzimit të denoncuesit (lidhur me problematikat e shfaqura nga një kontratë huaje lidhur mes shtetasve A.A dhe Z.K, për vlerën 2.200 euro, për të cilën është pretenduar se nuk është kthyer, duke vijuar kështu me pretendimet e më tej deri në kallëzim për kanosje me qëllim përfitimin e tyre), duke shtuar gjithashtu se vendimi i mosfillimit është rrëzuar nga gjykatat në të dyja shkallët e gjykimit. Gjithashtu, pretendon se edhe pse gjykata ka vendosur rifillimin e hetimeve, subjekti ka afërsisht një vit që nuk kryen asnjë hetim.

3.2 Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit disa dokumente¹²³:

3.3 Referuar dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit rezulton se vendimi i mosfillimit është ankimuar nga denoncuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të mosfillimit datë 7.9.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (ka kërkuar të ripyetet kallëzuesi, të merren dorëshkrimet e shtetasit F.K, të kryhet aktekspertim për të, të kryhen veprime hetimore lidhur me telefonatat e pretenduara, të pyetet noteri tek i cili është nënshkruar kontrata e huasë, etj.). Gjithashtu, në përmbajtje të këtij vendimi evidentohen nga gjykata edhe veprimet procedurale hetimore që duhet të kryheshin nga prokuroria.

Në vijim, ndaj këtij vendimi rezulton të jetë bërë ankim nga subjekti në Gjykatën e Apelit Durrës. Kundër këtij ankimi ka bërë apel kundërshtues denoncuesi A.A, duke kërkuar mospranimin e tij dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka evidentuar faktin se *kallëzimi nga ankuesi/denoncuesi A.A është regjistruar në prokurori në datën 6.7.2017 dhe në referim të nenit 290/1 të Kodit të Procedurës Penale prokurori duhet të kishte vendosur mosfillimin e procedimit*

¹²²Denoncim nr. *** prot., datë 23.8.2018.

¹²³kopje e kallëzimit penal (pa specifikuar datën); dy deklarata me shkrim dore të denoncuesit drejtuar Komisionit;shkresë nr.*** prot., datë 2.9.2017, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për dërgimin e kopjes së vendimit të mosfillimit të hetimeve për kallëzimin penal nr. ***, viti 2017, drejtuar shtetasit A.A;kopje e vendimit të mosfillimit të hetimeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 7.9.2017, nënshkruar nga subjekti;vendim nr. ***, datë 31.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;apel kundër vendimit nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nënshkruar nga subjekti datë 6.11.2017;apel kundërshtues i kallëzuesit/denoncuesit A.A kundër ankimit të datës 6.11.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ndaj vendimit nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;kërkesë e denoncuesit për zëvendësimin e prokurorit të çështjes (z. Bledar Bejko) drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; kërkesë e denoncuesit drejtuar z. H.K (ekspert kriminalist, Tiranë) për kryerjen e ekspertimit grafik, datë 9.11.2017, bashkëlidhur për ekspertim shkresat e plotësuar nga shtetasi F.K (i biri i huadhënësit, z. Z.K);vendim nr. *** regj. Them., nr. *** datë 19.12.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës;procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dëjani për veprën penale datë 7.9.2017, ora 10:30, i shtetasit Z.K, marrë nga oficeri i policisë gjyqësore, z. A.V; deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.9.2017, nënshkruar nga denoncuesi në prani të noterit A.V.D;kontratë huaje e siguruar me barrë siguruese hipoteke nr. ***, midis denoncuesit në cilësinë e huamarrësit dhe shtetasit Z.K, në cilësinë e huadhënësit (me pëlqimin e shtetasit A.A, bashkëshorte e huamarrësit), noter F.H;kujtesë noteriale nr. ***, datë 23.6.2017, nënshkruar nga denoncuesi dhe noter A.V.D.

*brenda datës 15.8.2017 (ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 35/2017, kanë hyrë në fuqi më 1.8.2017). Më tej, gjykata shprehet se: “Kryerja e veprimeve të mësipërme procedurale presupozon se kjo çështje de facto ka filluar dhe nga ana e prokurorisë nuk duhej që të vendosej mosfillimi i procedimit, por pushimi i këtij procedimi penal konform nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale”. Gjykata e Apelit ka caktuar kryerjen e disa veprimeve të domosdoshme procedurale. Në përfundim, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se vendimmarrja për mosfillimin e procedimit penal nuk është arritur brenda afatit ligjor sipas parashikimit të bërë në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar apo edhe bazuar në nenin 290/1 të ligjit nr. 35/2017, hyrë në fuqi në datën 1.8.2017, si dhe të qartësonte statusin aktual të kësaj çështjeje në përmbushje të detyrave të lëna nga gjykata duke depozituar edhe dokumentacionin provues.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në lidhje me sa konstaton Komisioni, shpjegoj se në datën 15.8.20017 (apo datë 6.8.2017) si data limit brenda të cilin duhet të kisha marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, përfshihen në ditët e muajit gusht ku prokuroria dhe gjykata ka të planifikuar lejet vjetore. Vendimin e mosfillimit e kam marrë bazuar në bindjen time të brendshme menjëherë sapo jam kthyer nga leja vjetore.*

Bazuar në vendimin gjyqësor kam filluar hetimet dhe bazuar në hetimet shtesë të kryera kam konkluduar në datën 28.9.2020 se shtetasit F.K duhet t'i njoftohej akuza për veprën penale ‘mashttrim’, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në datën 23.10.2020 çështja është dërguar për gjykim dhe vazhdon gjykimi me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Gjatë gjykimit është vendosur të kryhet një riekspertim, pasi akti i parë i ekspertimit grafik nuk e bindi gjykatën se në dokumentet e dorëzuara nga kallëzuesi ndodhej shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasit F.K”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, konstatoi se periudha për dhënien e vendimit të mosfillimit i përkiste kohës në të cilën kryhet leje vjetore. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në hetimin e çështjes ka vlerësuar sipas bindjes së tij të brendshme, argument ky që në çdo rast individualizon situatën, është një arsye legjitime dhe, për pasojë, nuk mund të cenohet apo vlerësohet ndryshe. Në tërësi, u vërejt se çështja ka pasur në thelb marrëdhënie juridiko – civile (referuar një marrëdhënieje kontraktore huaje me të drejta dhe detyrime mes palëve, shkelja e të cilave, po sipas klauzolave kontraktuale, është parashikuar të zgjidhet në rrugë gjyqësore).

Trupi gjykues ka vërejtur gjithashtu se përtej kryerjes së veprimeve të para, por edhe bindjes së brendshme, subjekti ka zbatuar detyrat e lëna pas kthimit nga gjykata dhe, për pasojë, ka konkluduar në ngritjen e akuzës “mashttrim” ndaj shtetasit F.K, duke i njoftuar edhe akuzën. Po ashtu trupi gjykues ka vërejtur se gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit të saj nga njëra anë orienton se duhej të ishte vendosur pushimi i çështjes dhe jo mosfillimii saj por, nga ana tjetër vijon të lërë detyra të tjera për hetim. Aktualisht, sipas procesverbaleve gjyqësore të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se çështja vijon të jetë nën gjykim.

Për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit dhe për sa kohë çështja vijon të jetë në proces gjyqësor, Komisioni nuk ka kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit.

4. Denoncim¹²⁴ i shtetasit S.M

4.1 Denoncuesi pretendon se kallëzimi i bërë prej tij me nr. ****, datë 15.5.2008, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk është ndjekur dhe trajtuar, duke fajësuar disa subjekte, ndër të cilët edhe subjektin e rivlerësimit.

Denoncimi i referohet, ndër të tjera, një aksidenti automobilistik të ndodhur në datën 4.10.2007, rreth orës 14:00, në rrugën ***, të qarkut Fier, ku një automjet ka aksidentuar për vdekje motoçiklistin B.C. Ai pretendon se policia dhe prokuroria kanë fshehur dhe zhdukur provat, nuk kanë vepruar, dhe prokurori i çështjes (subjekt tjetër) nuk e ka marrë në ndjekje penale autorin.

Gjithashtu, denoncuesi i referohet një gjyqi civil për largim të padrejtë të tij nga puna në Spitalin e Fierit dhe pretendon shkelje për vendime gjyqësore të padrejta, duke përmendur disa gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Komisioni ka administruar¹²⁵ fashikullin penal që i përket kësaj çështjeje.

Nga aktet e administruara në dosje konstatohet se çështja penale ka nisur mbi kallëzimin e shtetasit S.M.

Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, me arsyetimin se mungon lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimeve të kundërligjshme të drejtuesit të mjetit dhe pasojës së ardhur, meqenëse nuk është bërë e mundur të këqyrej vendi i ngjarjes, pasi është prishur dhe njëkohësisht nga marrëveshja e lidhur mes palëve për ta zgjidhur çështjen privatisht nuk mund të vërtetohet se pasojat kanë ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, por edhe të identifikohet subjekti penal.

Ky vendim është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin datë 27.4.2010 (bazuar në ankimin e shtetasit S.M), duke u cituar edhe veprimet hetimore të cilat duheshin kryer.

Më tej, çështja penale i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë (për shkak të ngritjes së seksionit të të miturve në këtë rreth), e cila ka regjistruar procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit O.D, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, duke dërguar në gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale, për arsye se është provuar që shkak determinant i aksidentit të ndodhur ka qenë parakalimi i gabuar dhe qarkullimi pa patentë i shtetasit O.D dhe se nga hetimet është vërejtur që janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale prej të pandehurit, dhe në këto rrethana, ky i pandehur mbetet i dyshuar për kryerjen e veprës penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, bazuar në nenin 290/1 të Kodit Penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në konkluzionet përfundimtare të datës 22.12.2011, ka kërkuar deklarinimin “fajtor” të të pandehurit O.D, për kryerjen e veprës penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 600.000 lekë gjobë (mbahet në vëmendje fakti se në kohën e kryerjes së veprimit, pra të aksidentit, shtetasi O.D ka qenë minorene dhe se kompetente ka qenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila dispononte seksionin e të miturve për hetimet e kësaj grupmoshe).

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se në këtë çështje nuk ishin kryer hetime të plota për identifikimin e autorit, sipas nenit 73¹²⁶ të ligjit nr. 96/2016, si dhe të depozitonte dokumentacionin mbështetës.

¹²⁴Denoncim nr. *** prot., datë, 29.7.2019, dhe nr.*** prot., datë 18.9.2019, depozituar pranë ONM-së.

¹²⁵Me shkresën nr.*** prot., datë 28.12.2021.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar sevendimin e pushimit të procedimit penal e ka marrë bazuar në bindjen e tij të brendshme mbi bazën e provave të administruara. Ai është shprehur se: *“Pavarësisht vendimmarrjes së ndryshme të Prokurorisë së Rrethit Vlorë, kam çmuar se në kushtet kur nuk kishte këqyrje të vendit të ngjarjes ishte e pamundur të vërtetohej akuza e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Vendimin e pushimit ia kam njoftuar palëve, të cilët kanë ushtruar të drejtën e ankimit. Përveç faktit se kjo dosje është jashtë periudhës së rivlerësimit, dua të theksoj për Komisionin se kjo është e vetmja çështje e njoftuar nga Komisioni, ku në përfundim është vendosur ndryshe nga vendimmarrja ime. Në këto kushte, në përfundim të analizës së sipërcituar, Komisioni duhet të arrijë në konkluzionin se kam arritur nivel të mirë të vlerësimit profesional”*.

Trupi gjykues, në analizë të hetimit administrativ të kryer për këtë çështje, shpjegimeve të subjektit, çdo dokumentacioni të administruar, vëren se, edhe pse kemi të bëjmë me një çështje të vitit 2008, kontrolli i vendimmarrjes së subjektit nga ana e drejtuesit më të lartë të institucionit, i vlerësuar në një tjetër mënyrë, duhet parë në proporcionalitet me pretendimin e subjektit se në vendimmarrje ka vendosur jo vetëm sipas bindjes së tij të brendshme por edhe provave të administruara. Kjo çështje duket se nuk mund të ndikojë si një shkak determinant në rivlerësimin e subjektit. Trupi gjykues nuk mund të marrëtribute për të vlerësuar lidhur me themelin¹²⁷ e çështjes apo lidhur me arsyet që kanë çuar subjektin në vendimmarrjen e tij në këtë çështje.

5. Denoncim¹²⁸ i shtetasit E.G

Denoncuesi ankohet për disa prokurorë dhe gjyqtarë, ndër të tjerë edhe për subjektin e rivlerësimit, nën kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tyre për kryerjen e veprave penale “falsifikim”, “shpërdorim detyre”, dhe “ushtrim të ndikimit të paligjshëm”. Në bazë të ankimit duket se qëndrojnë problematika të marrëdhënies së punës midis këtij shtetasi dhe DRTT-së ***, ku ka qenë i punësuar. Denoncuesi synon të parashtrojë mjaft detaje mbi mosekzekutimin e një vendimi civilo-administrativ, por në një lexim të kujdesshëm duket se nuk paraqet problematika konkrete për subjektin e rivlerësimit, por thjesht dhe vetëm citon vendimin nr. ***, datë 25.4.2021, të subjektit për “mosfillimin e procedimit penal”, si dhe vendimin nr. ***, datë 10.1.2022, po të subjektit, duke pretenduar se janë të njëjtë në arsyetim me vendimin e një tjetër subjekti. Denoncuesi nuk ka depozituar ndonjë dokument ku të identifikohet roli dhe puna e subjektit.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të qartësojë pozitën e tij në çështjen e pretenduar nga denoncuesi, si dhe të depozitojë edhe dokumentacion justifikues në mbështetje të shpjegimeve (gjithnjë nëse kishte/ka hetuar çështje me këtë shtetas).

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendimin e mosfillimit të çështjes penale, si dhe vendimin nr. ***, datë 22.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilin ka sqaruar se ky vendim ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të marrë nga një prokuror tjetër, ku objekti i

¹²⁶Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikiht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

¹²⁷Në mënyrë të detajuar vlerësimi i aftësive profesionale parashikohet nga ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 72 të këtij ligji nën titullin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” parashikohet se: 4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

¹²⁸Denoncim nr. *** prot., datë 23.11.2021, përcjellë për trajtim nga Kolegji me shkresat nr. *** prot., datë 23.11.2021 dhe nr.*** prot., datë 19.1.2022, përcjellë nga Kolegji me shkresën nr. *** prot, datë 19.1.2022, si dhe me e-mail në Komision në datën 14.1.2022.

kallëzimit është i njëjtë me faktet e kallëzuara nga denoncuesi, për të cilin tashmë prej subjektit është vendosur mosfillimi.

Trupi gjykues, pasi u njoh me aktin e depozituar nga subjekti, nuk konstaton fakte apo rrethana që ndikojnë në rivlerësimin e tij. Vërehet se subjekti është shprehur në vendimmarrjen e tij ndaj këtij shtetasi bazuar në faktet, provat e administruara dhe bindjen e brendshme.

6. Denoncim¹²⁹ i shtetases A.C

Denoncuesja ankohet se akuzohet me pa të drejtë për zvarritje të procesit hetimor, si dhe për fyerje nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë denoncim, si dhe të qartësojë statusin aktual të çështjes së parashtruar dhe pretenduar nga denoncuesja.

Subjekti¹³⁰, në shpjegimet e tij, ka parashtruar se ka kryer veprimet e duhura hetimore dhe në përfundim ka dërguar çështjen¹³¹ për gjykim në ngarkim të të pandehurës A.C, e akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Subjekti ka qartësuar se kjo çështje është ende në fazën e seancës paraprake, referuar shkresës nr. *** prot., datë 29.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilën ka depozituar një kopje të saj, ku rezulton i provuar ky fakt.

Komisioni hetoi lidhur me këtë çështje, ku nga verifikimi i akteve të fashikullit penal të administruar¹³², ka rezultuar se fillimisht procedimi penal është regjistruar pa autor. Më tej, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, është regjistruar në këtë procedim penal në datën 10.9.2020 emri i shtetases A.C, duke iu ngarkuar OPGJ-së edhe kryerja e veprimeve hetimore. Ndërkohë, në të njëjtën datë i është njoftuar të kallëzuarës akuza, duke u marrë si e pandehur për veprën penale “vjedhje”, për të cilën rezulton të ketë marrë dijëni, pasi ajo dhe mbrojtësi rezultojnë të kenë nënshkruar aktakuzën. Rezulton se janë kryer disa veprime hetimore, përfshirë edhe pyetjen e disa personave që kanë dijëni për veprën penale, akte ekspertimi kontabël për humbjen e kallëzuar, etj. Hetimet janë shtrirë edhe në drejtim të kërkimit të të dhënave nga kompania e punësimit, si dhe në institucione të tjera, si banka, hipotekë, DPSHTRR, etj., përfshirë edhe kërkimin e një eksperti IT për të nxjerrë të dhëna nga serveri i kompanisë. Gjithashtu janë nxjerrë vendime për sekuestrim dokumentacioni në cilësinë e provës materiale, si p.sh. për çështje pasurie në ASHK-në Durrës, etj. Në korrespondencat institucionale janë administruar edhe informacione që pasqyrojnë pamundësinë e vënies në dispozicion dhe përmbushjen e kërkesave të organit të akuzës (p.sh. siç është shprehur nga Instituti i Policisë Shkencore¹³³ pamundësia e caktimit të ekspertit IT, për shkak të ngarkesës në punë/çka duket se ka ndikuar në afatin e hetimit).

Aktualisht çështja rezulton të jetë në proces gjyqësor. Në të tilla kushte, Komisioni nuk ka kompetencën të konkludojë mbi të dhe, për pasojë, as të vlerësojë ndikimin e saj në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një hetimi të thelluar, ka vlerësuar se në tërësi nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të

¹²⁹Denoncim nr. *** prot., datë 4.4.2022, përsëritur me *e-mail* në datën 6.5.2022.

¹³⁰Me *e-mail*-in e datës 6.5.2022.

¹³¹Që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2018.

¹³² Me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës

¹³³Referuar shkresës së administruar me nr. rendor *** në fashikullin penal.

përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku, ndër të tjera, në vendimmarrjet e tyre, citohet: “...i) ndryshim i vendimit nuk do të mund të jetë kriteri matës determinant¹³⁴ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit; apo edhe se ii) vlerësimi i aftësive profesionale të magistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqesore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit...”

Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

VLERËSIM TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesve ndërkombëtarë, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Bejko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

¹³⁴Sikurse shprehet Kolegji në vendimin e saj nr. ***, datë 23.10.2020, konkretisht në pikën 12.5, dhe në vendimin nr. ***, datë 23.10.2020, pika 10/8.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka